CyanMagentaYellowBlack

KOHA

për Gratë





PËRGATITUR NGA

Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Center for Gender Studies

AUTOR I POSTERËVE: TABI AZIRI

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Gruaja pa shtëpi

Vlora iu dorëzua fuqisë së dashurisë. Tinëz, në mal, rioshja shijoi puthjen e parë. Deri atëherë nuk i kishte besuar dashurisë në shikim të parë. Madje, vihej në siklet kur shoqet e pyesnin për dashurinë e ëndrrave. Nuk u besonte as skenarëve të filmave me dashuri romantike. Mundohej t'i merrte gjërat shtruar. Në shoqëri nuk jepej fort. Vlora ishte e ndrojtur për nga karakteri. Vështirë t'ia çelnin zemrën edhe shoqet e ngushta. Ato tashmë po mbanin leksikone dashurie në kohën kur po vërenin ndryshime më të theksuara.

Leksikoni i dashurisë

"Të kam shti në zemër/të kam mbyll me dry/çelësi më ka humbur/ti ke mbet aty", kujton me qeshje Vlora njërën prej strofave të shoqeve. Vargjet ishin shkruar brenda një zemre të kuqe në njërën prej faqeve të mbushura me dedikime të ngjashme nga fletorja që bartej tinëz prej shoqes te shoqja. Kushedi kujt i mbeti në fund. Ishin nxënëse të klasës së tetë. Ngacmonin padjallëzisht njëra-tjetrën.

Kosova porsa ishte çliruar. Një kapitull i ri po niste për të gjithë. Rinia përfaqësonte forcën e ndryshimit. Dashuri në kohë lirie. Vlora nuk kishte menduar fort pse nuk e regjistroi fare shkollën e mesme. Madje, u prish me familjen për burrin. "Ika se e doja me zemër", kujton ajo.

Sot burri ia ka kthyer shpinën. Ajo me fëmijë është kthyer te familja e babait. Tri palët bëhen bashkë vetëm në gjykatë. Në mes janë tre fëmijët. Nuk janë pa strehë. Ligjërisht, pa shtëpi. Sikurse edhe ish-burri i Vlorës. Para se procesi i ndarjes të niste në gjykatë, ai hoqi dorë nga krejt pasuria që asgjë të mos i ndahej Vlorës dhe fëmijëve nga gjykata. Para se rasti të kalonte në gjykatë, me ndihmën e avokatëve shfrytëzoi boshllëkun ligjor. U shtir se donte kthimin e gruas dhe fëmijëve me ndërmjetësim burrash. Paralelisht, ligjërisht hoqi dorë nga pasuria. Pastaj, procesin e shkurorëzimit e kaloi në gjykatë. Vlora dhe fëmijët ia panë sherrin forcës së zakonit.

"Si burrat ..."

Krejt ndryshe do të ishte jeta e Vlorës dhe e fëmijëve nëse në shtetin e "Europianëve të Rinj" do të mbisundonte ligji. Kosova aspiron Bashkimin Europian. Jo edhe me vepra. Burrërinë ia kallxon edhe Brukselit kur i dërgon delegacion burrash edhe kur flitet për liberalizimin e vizave që bie në sektorin e një ministrie e cila drejtohet prej një gruaje. Burrat në postet më të larta shtetërore mblidhen nëpër oda dhe zbrazin qorrazi armët prej dritareve pas pazareve të ujdisura për hiset e pushtetit. Model i stërkequr për një shoqëri patriarkale që përditë dëgjon prej gojës së tyre fjalime për demokracinë dhe vlerat europiane. "Si burrat" merren vesh për hesapet e tyre në kurriz të popullit më të varfër në Europë. Me thirrje telefonike në gjuhën e "Prontos" i emërojnë edhe njerëzit që vendosin në sistemin e drejtësisë. Aty përcaktohet fati i grave, si rasti i Vlorës. Fajin e ka edhe shoqëria. Vlorës shteti ia ka kthyer shpinën. Edhe shoqëria.

Elita politike mburret se ka një prej sistemeve më të avancuara demokratike kur vjen puna te mbrojtja e qytetarëve pa dallim etnie, race a gjinie. Kushtetuta e Kosovës e ka përcaktuar si të barabartë rolin e grave dhe burrave në shoqëri. E ka parandaluar diskriminimin, duke e sanksionuar me nene të veçanta dhe me referenca të konventave ndërkombëtare.

"Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat tjera të jetës shoqërore", thuhet në nenin 7.



"Ligjin e bën Maliqi"

Edhe Ligji për Trashëgimi e përcakton ndarjen e barabartë të pasurisë mes anëtarëve të familjes, pa përjashtuar trashëgimtarët në baza gjinore, theksohet në nenin 3. Por, faktet janë kokëforta.

Të dhënat e fundit zyrtare tregojnë se vetëm 13 për qind e pronarëve të pronave të regjistruara në Kosovë janë gra. Barazia e proklamuar bujshëm, kurrkund hiç.

Vjosa Shkodra është këshilltare speciale për sundim të ligjit dhe shoqëri civile e Programit të USAID-it për të Drejtat Pronësore. Ajo thotë se sa i përket kuadrit ligjor në Kosovë, gratë dhe burrat janë të barabartë në trashëgimi.

"Problemi qëndron te fakti se ligjet tona shpeshherë nuk zbatohen në praktikë, sepse mbizotëron mentaliteti patriarkal si normë shoqërore. Kjo e fundit ndikon edhe gjatë zbatimit të ligjit. Përderisa flasim që, në përgjithësi, ligjet janë të mira në Kosovë, faktet në terren flasin që numri i grave që trashëgojnë pronë në Kosovë është 13.7 për qind (bazuar në Studimin Nacional për të Drejtat Pronësore, 2019)", thotë Shkodra, duke iu referuar të dhënave të hulumtimit më të ri të USAID-it.

Vlora po lufton e vetme kundër një sistemi të tërë në duar të burrave. "Veç kur m'ra puna jem me u marrë me gjykata, e mora vesh atë shprehjen e Shqipërisë: 'Ligjin e bën Maliqi'".

E mbështetur për muri, ajo më nuk po mendon fare për veten. E ka hallin e tre fëmijëve. Prapëseprapë, fajëson veten teksa kthehet pothuajse njëzetë vite prapa te ai takimi sekret në mal. Takimi i puthjes së parë. Dikur mendonte se po jetësonte ëndrrën. Tani i është kthyer në makth. Nuk është e sigurt nëse "puthja e ndaluar" i solli më shumë gëzim a vuajtje. I ka tre fëmijë, por ka mbetur pa shtëpi. Ata i japin forcë. Por, forca e burrit mbisundoi forcën e ligjit.

Vlora nuk i beson ligjit, sepse rrethi i besoi më fort "Maliqit". Dashuria që po shkonte fjollë në vitet e para, do të merrte përnjëherë teposhtën.

Vlora, viktima e parë. Jeta e familjes, lëmsh.

Burrave s'u ngutej

Burrave nuk është se u ngutej fort, derisa po e tjerrnin punën me çuarjen e njerëzve me shpresë se miqësia do të ruhej. Fatin e Vlorës e vajtonte vetëm e ëma, pa fuqi vendimmarrjeje. Pas diskutimesh të gjata për ta ruajtur nderin e derës së familjes së dhëndrit dhe të nuses – e ndonjë argumenti se më së shumti po e pësojnë dy fëmijët – burrat nëpër tymin e duhanit në odë prenë fatin e Vlorës. Kurrkush nuk çante kokën për vuajtjet që i kishte pësuar dhe për të zezat që do të pasonin. Ajo uli kokën dhe u bë kurban i gjallë i dy fëmijëve. Të tretin (djalin e dytë) do ta lindte pas disa vitesh.

"Kurrë nuk isha kthy' nëse e kisha pasë një shpi t'vogël sa me pasë ku m'i majtë thmijën. Me lyp hise te baba? Me guxu! Me m'pas thanë baba: 'Qe qika jem një copë oborr e po ta maroj një shpi se me shti kryet', isha marrë me thminë e mi e nuk i isha kthy' kurrë burrit se burri boll ma pat hangër shpirtin edhe atëherë", thotë me pezm.

Avokatja Shkodra potencon se viteve të fundit megjithatë ka nisur të ngrihet vetëdijesimi i grave për të drejtat e tyre. "Duke u bazuar në Studimin Nacional Afatmesëm për të Drejtat Pronësore në Kosovë (2017), studim i realizuar në kuadër të Programit të USAID-it për të Drejtat Pronësore, përqindja e grave që kanë njohuri mbi të drejtat e tyre pronësore është 37 për qind. I njëjti studim në vitin 2015 kishte rezultuar me vetëm 14 për qind të grave që kanë njohuri për të drejtat pronësore. Tani, në vitin 2019, është përsëritur e njëjta metodologji hulumtimi dhe numri është rritur në 53 për qind".

Shkodra mendon se bazuar në këto të dhëna mund të konkludohet se deri në vitin 2015 niveli i njohurisë për të drejta në pronë (duke përfshirë dhe trashëgiminë) ka qenë i ulët. "Por, me hapjen e këtij debati dhe duke theksuar situatën në mënyrë të vazhdueshme, ka ndikuar që jo vetëm gratë, por qytetarët në përgjithësi të kenë njohuri më të mëdha rreth çështjeve pronësore e trashëgimore".

Por, Vlora thotë se edhe po të pajtohej babai, zor se do të guxonte t'i ndante hise pa marrë lejen e vëllezërve, tashmë të ndarë. Ata ishin trashëgimtarët e vetëm të pasurisë – sipas zakonit.

Familja e ribashkuar e Vlorës u stabilizua dhe nuk pati probleme të theksuara shtatë vite. Burri po punonte në sektorin privat. Megjithëse nuk e mbante në të njëjtën punë, familja mbahej edhe me qiranë që po merrte prej dyqanit. Lagja e familjes së burrit të Vlorës ia pa hairin zgjerimit të qytetit, pasi po shtoheshin firmat private. Djali i dytë solli i çiftit gëzim në familje. Me ta jetonte edhe vjehrra. Vlora nuk donte të punonte meqë përmirësimi i mirëqenies ekonomike të familjes i lejonte më shumë kohë për t'u marrë me fëmijët në shkollë. "E mora lejen e kerrit dhe merresha me thmi m'i çu e m'i marrë prej shkolle. Edhe vjehrra më ndihmonte me punë t'shpisë". Prej ëndrrës së saj për shkollim kishte hequr dorë atëherë kur vendosi të martohej pa nisur shkollimin e mesëm.

"...ma kërsiti shuplakë" se "burrit i ka gjithçka hije"

Viteve të qetësisë relative në familjen e Vlorës do t'u vinte fundi kur burri nisi të vonohej deri në orët e vona të natës. "Bani pak pare dhe shkojke nëpër kafe. Niher nuk e çelke telefonin, dikur ardhke i pitë dru dhe kur i thashë niher: 'Je babë i tre thmive e s'po t'ka hije', ma kërsiti shuplakë. Prej asaj nate, nisi m'u shpeshtu e rrehnja".

Ndonëse Vlora ia kishte parë sherrin Kanunit në ndarjen e parë, prapë nuk shihte derë më të sigurt se ajo e babait. Në njërën prej vizitave të zakonshme te familja, njoftoi babanë dhe vëllezërit se ajo dhe fëmijët nuk do të ktheheshin më shtëpinë e tyre. Përsëri do të mblidheshin burrat në odën plot tym duhani në fshatin malor. Në fshat, gjithsecili kishte versionin e tij për shkaqet e ndarjes. Asnjërit s'i besohej. Vlora etiketohej më së shumti me pretendimin se "burrit i ka gjithçka hije", sikurse thotë njëra prej shprehjeve në popull, që me automatizëm ia kërkon gruas nënshtrimin.

Me Kanun, gruaja "tepricë"

Dëshmi familjarësh e versione të ndryshme – të burrave afërmendsh - dëgjoheshin për orë të tëra ditë pas ditësh derisa pleqnarët kolliteshin herë pas here para se ta prisnin fatin e Vlorës, duke u bazuar në forcën e Kanunit.

Kanuni i Lekë Dukagjinit e sheh gruan si "tepricë" në shtëpi. Të drejta i jep vetëm në ditën e martesës që lidhen me përmbushjen e zakoneve të ceremonisë së martesës. Pjesa tjetër ka frymë krejtësisht negative kur vjen puna te roli i gruas në trashëgimi, qoftë te babai, qoftë te burri. Në nyjen e njëzetë të Kanunit të Lekë Dukagjinit, "Trashgimi i grues shqyptare", thuhet se "grueja shqyptare farë trashëgimit s'ka te prindrja, as në plang, as në shpi, - kanuja e xen gruen si një tepricë në shpi. Prindja s'mendon per pajë as për kurrnji send vajzë të vet; që e xen do t'i a baje kujdesin. Prindja e djalit, qi e xun vajzen do të mendojn per gjith shka duhet per martesë të saj".

Shkodra thekson se mbizotërimi i Kanunit është një ndër shkaqet e moszbatimit të ligjit dhe "arsyeja kryesore e (keq)përdorimit të institutit të heqjes dorë të Ligjit për Trashëgiminë të Kosovës".

Sipas Shkodrës, vajzat janë rritur, edukuar dhe pjekur në frymën se "hisja" e tyre janë vizitat familjare te shtëpia e prindërve pasi të martohen, "kurse heqja dorë nga trashëgimia, siç është e rregulluar me Ligjin e Trashëgimisë, nuk qëndron si institut për arsyen e lartcekur. Heqja dorë është e rregulluar me ligj për shkak se asnjë qytetari nuk mund t'i cenohet vullneti i lirë. Në këtë rast, nëse ndonjë trashëgimtar dëshiron të heq dorë, ky institut ekziston meqë trashëgimia sa ka të drejta, ka edhe detyrime. Kjo e fundit nënkupton se, për shembull, nëse njëri trashëgon një pasuri që ka borxhe, automatikisht e trashëgon edhe borxhin. Rrjedhimisht, heqja dorë bëhet në raste të tilla, pra, kur një trashëgimtar nuk dëshiron të trashëgojë borxhe".

Derisa në odën e babait të Vlorës gjithkush interpretonte Kanunin, e pakkush mendonte për ligjin, dikush po e mësonte ligjërisht burrin e Vlorës të hiqte dorë prej pasurisë para se procesi i ndarjes të dërgohej në gjykatë. Ligji për Trashëgiminë në Kosovë thotë gjithashtu se "trashëgimtari mund të heqë dorë nga trashëgimia me deklaratë të dhënë pranë gjykatës gjersa të përfundojë seanca mbi trashëgiminë".

Shkodra konsideron se hulumtimet kanë treguar që kjo situatë ka filluar të ndryshojë duke e parë trendin në rritje të shoqërisë me një botëkuptim tjetër. "Tani që gratë në Kosovë punojnë, ndonëse jo kënaqshëm, pra, janë aktive në treg dhe ekonomi, kjo traditë ka filluar të zbehet. Por, kërkohet kohë dhe angazhim i shoqërisë dhe institucioneve të Kosovës për të ofruar siguri në zbatim të ligjeve, sepse vetëm kështu do të mund t'i tejkalojmë këto prapambeturi".

"Zoti, mos e baftë me ua nda hisen vllaznive!"

Vlora nuk e dinte se boshllëqet ligjore po shfrytëzoheshin kundër saj nga ish-bashkëshorti. Ai mbeti pa shtëpi – por, vetëm në letra. Nëna (vjehrra e Vlorës) iu bë krah djalit, duke ia ndarë me pëlqimin e tij hisen e burrit të Vlorës njërës prej motrave. Me letra, ai është edhe i papunë. Rrogën e merr me para në dorë. Paratë e qirasë ia jep motra, pronare me letra. Vlora ka dëgjuar se ish-burri është martuar. Ligji në anën e "Maliqit".

Vlora vazhdon të jetojë në familjen e prindërve. Po punon që t'ia lehtësojë vëllait barrën e mbajtjes së motrës me tre fëmijë. I është mirënjohëse familjes së vëllait. Shpreson se me ndihmën e familjes së babait do të ndajë pak nga paga prej 300 eurosh që pas disa vitesh të blejë një banesë të vogël sa të vendoset me fëmijët. E mohon çdo mundësi për t'u martuar përsëri. Është e traumatizuar.

Shkodra thotë se gratë të cilat kanë pasuri, qoftë nga trashëgimia, apo pasuria e krijuar me punë, janë më të fuqizuara sepse kanë fuqi ekonomike. Këtë e sheh pozitive si për mirëqenien e familjes, ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi. "Gratë që nuk kanë pasuri të tyre janë të margjinalizuara, sepse në raste divorci shteti nuk ofron mbrojtje të duhur sociale e as siguri juridike. Ato detyrohen të qëndrojnë në strehimore të cilat kanë afat të caktuar qëndrimi dhe me kushte të vështira, ndërkaq proceset gjyqësore zgjasin dhe zvarriten me vite të tëra. Si rezultat, gratë shpesh mbesin pa strehim. Implikimet këtu barten edhe tek fëmijët, në ato raste kur ka fëmijë, ngaqë në një formë apo tjetrën, edhe ata preken nga kjo situatë".

Ajo kujton se që nga viti 2015, kur ka filluar të zbatohet programi i USAID-it për të Drejta Pronësore, për ta adresuar këtë çështje, janë bërë ndryshime ligjore me qëllim të forcimit të mekanizmave për zbatim më të drejtë të ligjit. Është ofruar mbështetje në rritjen e efikasitetit të gjykatave në trajtimin e lëndëve pronësore dhe, më e rëndësishmja për shoqërinë tonë, janë realizuar fushata vetëdijesuese në mënyrë të vazhdueshme dhe në forma të ndryshme, "gjë kjo që ka bërë të mundur që numri i grave që trashëgojnë pronë të rritet nga 3.8 për qind sa ishte në vitin 2015, në 13.8 për qind në vitin 2019. Nga vetëm 0.3 për qind e grave që kishin iniciuar procesin e trashëgimisë në 2015, në 14 për qind të grave që kanë iniciuar procesin e trashëgimisë në vitin 2019. Këta janë tregues të trendëve pozitivë të ndryshimit në shoqëri. Përfundimisht tregon se shoqëria jonë është e hapur ndaj avancimit shoqëror dhe ndryshimeve të nevojshme për të arritur një gjë të tillë".

Vlora nuk u beson institucioneve të drejtësisë në Kosovë. Ka humbur besimin në institucionet përgjegjëse dhe në shoqërinë. E ka humbur betejën ligjore me ish-burrin për trashëgiminë. I beson vetëm familjes – edhe kur i bie keq. Nuk e ka ndërmend t'ia kërkojë babait hisen e saj. "Zoti, mos e baftë me ua nda hisen vllaznive. Kurrë jo!". Viktimë e zakonit. Ka një arsye të fortë.

Vlora, e cila pa i mbushur 16 vjeç i ishte dorëzuar verbërisht forcës së dashurisë, pothuajse njëzet vjet më vonë iu dorëzua forcës së Kanunit, sepse, siç thotë: "E pashë vet se ligjin e bën Maliqi".

Gazetar kontribuues:
Rexhep Maloku

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Barazia Gjinore si mundësi për të gjithë

Abelard Tahiri

Barazia gjinore është njëra nga të drejtat fundamentale në një shoqëri demokratike. Avancimi i mundësive të barabarta për të gjithë pjesëtarët e një shoqërie, pavarësisht dallimeve gjinore, përbën njërin nga kriteret bazike në ndërtimin e një rendi demokratik dhe liberal.

Çështja e forcimit të pozitës së gruas vazhdon të mbetet njëra nga temat kryesore thuajse anembanë botës. Sepse, siç dihet, edhe përkundër progresit demokratik në shumë fusha të jetës, pabarazia gjinore vazhdon të jetë prezente në shumicën e shoqërive njerëzore.

Ndërgjegjësimi për adresimin e barrierave strukturore që vazhdojnë ta pengojnë barazinë gjinore i ka karakterizuar disa nga agjendat politike dhe sociale, që nga lëvizja e njohur #MeToo e deri tek Forumi Global për Demokraci, i mbajtur në fund të vitit të kaluar në Strasburg, me temën "Gender equality – Whose battle?".

As Kosova nuk është imune nga këta trendë. Nuk mund të mohohet fakti se vendi ynë ka shënuar një sërë transformimesh pozitive në dekadën e parë të shtetësisë. Janë hedhur bazat legale dhe konstitucionale që kanë pasur për qëllim ta garantojnë barazinë e plotë gjinore në aspektin ligjor dhe kushtetues.

Mirëpo, edhe përkundër këtij progresi demokratik, në rrafshin praktik ende ekzistojnë vështirësi serioze që do ta bënin të mundur përfshirjen e plotë të grave dhe vajzave tona në të gjitha sferat e jetës sonë shoqërore.

Paragjykimet, forca e zakonit, stereotipet dhe diskriminimi mbi baza gjinore, ende e përbëjnë substratin kulturor të sjelljeve tona ditore. Në këtë drejtim, nevoja e çmontimit të këtyre barrierave mentale dhe kulturore është bërë një detyrë urgjente për dekadën e dytë të shtetësisë. Sepse, siç është konfirmuar tashmë nga zhvillimet e gjithanshme socio-ekonomike, sa më shumë që tejkalohen dallimet gjinore në një shoqëri aq më shumë rritet shkalla e produktivitetit të saj.

Ngritja ekonomike, mirëqenia sociale, avancimi demokratik dhe përmirësimi i cilësisë së edukimit, janë vetëm disa nga fushat më të dalluara që kushtëzohen nga investimi në përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri.

Pozita e pafavorshme e gruas në shoqërinë kosovare mund të pasqyrohet në mënyrë më adekuate vetëm po të merren parasysh anketat e kohëve të fundit të Fuqisë Punëtore, ku punësimi te burrat është 65.7 për qind, kurse te gratë 20 për qind.

Nëse deri më tash përkushtimi për ngushtimin e këtij hendeku argumentohej mbi parime universale morale, në kushtet aktuale të një ekonomie globale, siç pohon revista e njohur amerikane "Foreign Affairs", është shndërruar edhe në një "imperativ strategjik ekonomik".

Me këtë rast, një studim i bërë kohë më parë nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), konstaton se në rast të një forme më të balancuar gjinore ekonomike në kuadër të shteteve që janë pjesë e këtij entiteti transnacional, vlera e GDP-së së këtyre shteteve do të shtohej mbi 12 për qind. Një hulumtim i realizuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar pohon se rezultate të tilla do të arriheshin edhe për shtetet që nuk janë pjesë e kësaj organizate, kurse një raport i vitit 2015, i hartuar nga Instituti Global McKinsey, konkludon se në rast të ngushtimit të hendekut gjinor ndërmjet burrave dhe grave në vendet e punës, pasuria botërore përafërsisht do të shtohej deri në 12 trilionë dollarë sa i përket GDP-së globale deri në vitin 2025.

Në anën tjetër, në sektorin financiar, edhe pse është dëshmuar se shtimi i numrit të grave në bordet drejtuese të bankave ka ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e performancës së tyre ekonomike, përsëri vetëm një nga pesë anëtarët e këtyre strukturave menaxheriale është grua. Vetëm 2 për qind e udhëheqëseve ekzekutivë në nivel botëror janë gra.

Mjerisht, edhe përkundër këtyre dëshmive impresive që tregojnë se fuqizimi i grave e limiton varfërinë, hap perspektiva të përgjithshme të zhvillimit ekonomik dhe i adreson problemet më akute të botës, përsëri barazia gjinore mbetet një ideal ende i pajetësuar.

Progresi në këtë drejtim ka qenë i ngadalshëm dhe nuk është zhvilluar në përputhje me nevojat e domosdoshme të kohës. Sipas raportit të fundit të Forumit Ekonomik Botëror, hendeku ndërmjet dy gjinive deri më tani në rang global është ngushtuar vetëm për 68 për qind. Duke u bazuar në ritmet aktuale të ndryshimeve, të dhënat e këtij raporti prognozojnë se do të duhen edhe 108 vjet për t'i përmbyllur dallimet kryesore gjinore, kurse instalimi i barazisë së plotë ndërmjet gjinive vetëm në vendin e punës do të kërkonte 202 vjet.

Të gjitha këto fakte tregojnë për rrugën e gjatë që kemi përpara për t'i bërë shoqëritë njerëzore me inkluzive, më të barabarta dhe me mundësi të njëllojta për të gjithë

Duke marrë parasysh rëndësinë që paraqet avancimi dhe përmirësimi i barazisë gjinore, si Ministër i Drejtësisë e kam konsideruar të domosdoshme zbatimin sa më efikas të Strategjisë për të Drejtat Pronësore, e cila, ndër të tjera, parasheh përmirësimin e procedurave gjyqësore, theksimin e të drejtave të grave lidhur me përdorimin e pronësisë në praktikë, një komunikim më të mirë, qasje në informacion dhe kuptimin e të drejtave pronësore. Ndërkaq, nëpërmjet Ligjit për Trashëgimi kemi tentuar që ta fuqizojmë pozitën e gruas sa i përket të drejtave të saja trashëgimore pronësore. Me anë të ndryshimeve që kanë ndodhur në Kodin Penal, kemi tentuar që të krijojmë masa më efikase kundër dhunës në familje, qoftë ajo e ushtruar në aspektin psikologjik, fizik, etj.

Jam i vetëdijshëm se këto masa nuk janë të mjaftueshme për t'i prodhuar rezultatet që do të dëshironim t'i kishim. Ashtu siç thuhet në konkluzionet dhe rekomandimet e Forumit Botëror për Demokraci, sot përparimi i mirëfilltë në këtë drejtim duhet të promovojë ndryshime substanciale brenda sistemit. Bie fjala, ndonëse kuota është një instrument krucial i përfaqësimit gjinor si në politikë ashtu edhe në ekonomi, megjithatë ajo sot nuk është e mjaftueshme në vetvete. Si e tillë, ajo nuk duhet të shndërrohet vetëm në mekanizëm formal të reprezentimit, e pashoqëruar nga kultura e barazisë gjinore në institucionet politike dhe jetën ekonomike, si dhe e paçliruar nga mendësia e "diskriminimit, seksizmit dhe ngacmimit" Prandaj, është e rëndësishme që përpos mirëmbajtjes dhe zgjerimit të kategorisë së kuotës, kauza e barazisë gjinore të integrohet në gjitha nivelet dhe proceset e politikëbërjes.

Vetëm duke u bërë pjesë e një aksioni kolektiv që ka për objektiv të qartë përmirësimin e dallimeve gjinore do të mund ta korrigjonim situatën aktuale.

Në vend të pritjes afatgjatë, është detyrë vendimtare e jona që të angazhohemi pareshtur me qëllim që t'i përshpejtojmë këto transformime. Le ta shndërrojmë këtë 8 Mars jo vetëm në një moment celebrimi, por edhe mobilizimi. Nga shkalla e progresit të përfshirjes së plotë të grave në jetën ekonomike, politike, kulturore dhe arsimore përfitojnë si burrat ashtu dhe gratë.

Përfiton vet njerëzimi.

Autori është Ministër i Drejtësisë

Progresi i një shoqërie varet nga avancimi i gruas

Intervistë me Kryetaren e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Arta Rama-Hajrizi.

1. Në sistemin institucional të Kosovës gratë nuk kanë prezencë të duhur në pozitat e larta vendimmarrëse. Si Kryetare e Gjykatës Kushtetuese, a mund t'i identifikoni nga perspektiva gjinore disa nga përparësitë dhe pengesat për një grua në post të lartë?

Rama-Hajrizi: Është e vërtetë se femrat kosovare nuk janë të përfaqësuara në nivelin e duhur në pozitat vendimmarrëse në institucionet vendore. Kjo është një çështje që ekziston prej kohësh jo vetëm në vendin tonë, por edhe në shumë shtete të tjera në botë, madje edhe në ato me traditë shumëvjeçare të demokracisë përfaqësuese.

Ajo çfarë unë besoj se i bën më të veçanta gratë në raport me meshkujt, sidomos kur është fjala për vendimmarrje në pozita me përgjegjësi udhëheqëse, është perspektiva më ndryshe e të kuptuarit të realitetit dhe të botës rresh nesh, si dhe ndjeshmëria më e madhe ndaj padrejtësisë. Përparësi tjetër, për të cilën edhe është shkruar shpesh në media viteve të fundit, është fakti që gratë në poste të larta vendimmarrëse janë treguar shumë më pak të ndikuara nga aferat korruptive sesa meshkujt.

E kur është fjala për pengesat me të cilat gratë në pozita udhëheqëse më së shpeshti ballafaqohen në jetë, konsideroj se të qenit nënë dhe obligimet ndaj fëmijëve të porsalindur janë ndër kryesoret. Krahas kësaj, sfidë serioze për shumë femra në poste të larta paraqesin edhe paragjykimet tradicionale në shoqëri.

Por, gratë duhet të marrin vendet e merituara në çdo shoqëri dhe kjo nënkupton që të jenë pjesë e barabartë në çdo punë, funksion apo pozitë. Kjo sepse nuk ka shoqëri demokratike e të barabartë aty ku nuk ka ndarje të barabartë.

Fatmirësisht, krahasuar me gjeneratat para nesh, e gjithë bota tanimë po lëviz në drejtimin e duhur që të çrrënjos praktikat diskriminuese ndaj grave dhe që t'i institucionalizojë të drejtat e tyre për pjesëmarrje të barabartë në vendimmarrje.

Në vendin tonë, Gjykata Kushtetuese tashmë e ka thyer këtë stigmë për herë të parë, ku paneli i gjyqtarëve me shumicë meshkuj ka zgjedhur me vullnetin e lirë një grua për udhëheqëse.

2. Sa dhe si janë të ndërlidhur faktorët profesionalë me faktorët gjinorë në vendimmarrjen e nivelit të lartë?

Rama-Hajrizi: Edhe sot e kësaj dite femrat janë dukshëm më të diskriminuara se meshkujt në aspektin profesional, e veçanërisht në pozitat udhëheqëse. Kjo pasi jo të gjitha profesionet konsiderohen si "të përshtatshme" për gjininë femërore, ndërsa në shumë vende ende mbizotëron bindja se femrat nuk kanë zotësinë dhe

cilësitë për të udhëhequr. Megjithatë, sot bota ka ndryshuar dukshëm dhe femrat kanë dëshmuar me sukses se ato mund të jenë edhe udhëheqëse të forcave policore, edhe kryetare të akademisë së shkencave, edhe menaxhere të korporatave biznesore, por dhe presidente të shtetit.

3. Në sistemin juridik-kushtetues janë të përfshira premisat themelore mbi të drejtat e njeriut, konkretisht të drejtat e grave. Sipas jush, sa reflektohen këto të drejta në pozitën e grave në shoqërinë kosovare?

Rama-Hajrizi: Ndonëse dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktojnë dhe promovojnë qartë barazinë gjinore dhe të drejtat e barabarta për gratë, realiteti ende nuk përkon në tërësi me frymën e tyre. Prezenca e grave në institucionet shtetërore, e veçanërisht në pozitat udhëheqëse, jo gjithmonë përputhet me kuotat e domosdoshme gjinore. Pjesëmarrja aktive dhe fuqizimi i rolit të gruas në shoqërinë kosovare ende është larg nivelit të dëshiruar. Historia tashmë e ka dëshmuar se progresi i një shoqërie varet para së gjithash nga avancimi i rolit të gruas dhe se aty ku të drejtat e grave dhe të burrave janë të barabarta edhe zhvillimi i mirëqenies së gjithëmbarshme është i garantuar.

4. Me Kushtetutën dhe ligjet Kosova ka realizuar avancim në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave gjinore. Në këtë aspekt, a ka ndonjë të drejtë e cila është në Kushtetutën tonë, por nuk aplikohet mjaftueshëm në legjislacionin kosovar?

Rama-Hajrizi: Në vendin tonë tanimë kemi një kuadër ligjor të avancuar në mbrojtje të të drejtave të grave, madje më të avancuar se në shumë vende të tjera në rajon dhe në pajtim me standardet europiane. Por, këto ligje ekzistojnë brenda një konteksti kulturor ku të drejtat e barabarta të grave ende nuk janë norma të etabluara në tërë shoqërinë. Kjo mund të vërehet veçanërisht kur është fjala për të drejtën e gruas në trashëgimi. Gratë e vendit tonë në vazhdimësi janë dekurajuar që të pretendojnë ose të kërkojnë të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare, ndonëse shumë sosh mund edhe të mos jenë të informuara sa duhet për këtë të drejtë të garantuar. Konsideroj se reformat e mëtutjeshme të ligjeve të trashëgimisë, të mbështetura edhe me një fushatë vetëdijesuese gjithëpërfshirëse, janë një hap i duhur në drejtim të promovimit të mëtutjeshëm dhe zbatimit të kësaj të drejte.

Në këtë aspekt, edhe ne si Gjykatë Kushtetuese kemi përgjegjësinë që të kujdesemi që kjo e drejtë, si edhe të drejtat e tjera, të mbrohen dhe të vendosen në zbatim të Kushtetutës. Por, edhe komuniteti i gjerë, e sidomos shoqëria civile, kanë hisen e tyre të përgjegjësisë që të punojnë më shumë në ngritjen e vetëdijes dhe të nxitjes së rasteve gjyqësore, që do të rezultonin me përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në kontekstin e të drejtave të barabarta.

5. Shtojca "Koha për Gratë" i dedikohet 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Grave. Cili është mesazhi juaj për gratë dhe vajzat kosovare në kontekstin e sistemit ligjor?

Rama-Hajrizi: Të gjithë duhet të luftojmë së bashku dhe më me ngulm traditën e të vlerësuarit të gruas si "pronë" e burrit, sepse gratë mund të jenë politikane, administratore dhe vendimmarrëse po aq sa edhe çdo burrë. Vajzat dhe gratë kosovare duhet të besojnë dhe të punojnë pareshtur në realizimin e ëndrrave të tyre, si në jetën personale edhe në atë profesionale, dhe duhet të luftojnë pa hezitim për të drejtat që u takojnë. Për t'i mbrojtur sa më mirë të drejtat e tyre të garantuara edhe me Kushtetutë, shfrytëzoj rastin që të apeloj tek të gjitha gratë dhe vajzat kosovare që të informohen sa më shumë rreth sistemit kushtetues dhe ligjor të vendit tonë.

Urime 8 Marsi të gjitha grave kudo që janë!

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Gratë në dialog përcaktojnë të ardhmen

Sonja Licht

Me të vërtetë u ndjeva e nderuar kur Qendra Kosovare për Studime Gjinore më kërkoi të shkruaja për shtojcën "Koha për Gratë". Në mendje më erdhën shumë kujtime, fakte, fytyra, përderisa po mendoja për gratë në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe ndërmjet dy shoqërive. Ndoshta pamja më e rëndësishme që e kujtoj është tavolina në një piceri të mirënjohur në Prishtinë, që dikur ishte vendtakimi i grave nga Prishtina dhe një numri të psikologeve nga Beogradi. Këto takime unike u nisën dhe u organizuan nga organizata "Mens Sana", e financuar dhe e drejtuar nga dy psikiatër, Nijazi Macula dhe Ava Kurteshi nga Prishtina, si dhe nga psikologja Jelena Vlajkoviq, një ndër themelueset e "Qarqeve psikologjike" ("Psihološki krugovi") nga Beogradi.

Prej mesit të viteve 1990 deri në vitin 1999, "Tryeza e rrumbullakët e grave" organizonte takime një herë në muaj dhe me siguri ishte vendi i vetëm ku gratë shqiptare dhe serbe uleshin së bashku dhe flisnin për çështjet që i shqetësojnë të gjitha gratë: roli i grave në familje, rritja e fëmijëve, dhuna në familje, humbjet emocionale gjatë ciklit jetësor, rritja e vetëdijesimit në përpjekjet për të drejtat e grave, etj. Ava dhe Jelena, po ashtu, ishin shumë të përfshira në ngritjen e "Klubit të hapur" për fëmijë dhe të rinj në Prishtinë. Të dy projektet mbështeteshin nga Fondi për Shoqëri të Hapur nga Beogradi, përmes degës së tij në Prishtinë.

Megjithatë, "Tryeza e rrumbullakët e grave" vazhdoi edhe gjatë katër muajve në vitin 1996, kur Fondi u mbyll. Ishte më shumë se vetëm projekt. U bë domosdoshmëri për pjesëmarrëset. Kur mikja ime e dashur, aktivistja dhe studiuesja e famshme feministe Ann Snitow nga Nju Jorku, vizitoi Qarkun e grave ajo u emocionua dhe u prek shumë kur gjatë një mbrëmjeje që e kaloi me dhjetëra gra zbuloi se sa ngjasonte ky qark me qarqet e para për ngritjen e vetëdijesimit të feminizmit në SHBA në vitet 1960 dhe 1970. Edhe tash ajo e kujton takimin: "Pikëpamjet tona për familjen dhe rolin e tyre ishin aq të ndryshme. Kam mësuar aq shumë nga ato". Këto janë saktësisht fjalët e saj para disa ditëve kur i tregova se po shkruaj një artikull për gratë dhe dialogun për shtojcën e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore me rastin e 8 Marsit.

Po i kujtoj këto gjëra për të paktën tri arsye.

E para është se pikërisht këto mbledhje më bindën se sa ishte e rëndësishme, dhe në të njëjtën kohë e vështirë, për t'i trajtuar paragjykimet e kulturës tradicionaliste dhe patriarkale të të gjitha shoqërive tona, veçanërisht kur dikush e prek çështjen e gjinisë dhe marrëdhënieve gjinore. Në të njëjtën kohë, se si gratë ndjenin dhe e kuptonin që kjo ishte përpëlitje e përbashkët pa marrë parasysh identitetin etnik, fetar, arsimor apo të brezit.

E dyta, formatet si "Tryeza e rrumbullakët e grave" iu ndihmuan pjesëmarrëseve për të ngritur çështjen e vetë pozitës së tyre dhe të sfidave me të cilat përballen të gjitha gratë, për të kuptuar se solidariteti dhe ndjeshmëria iu ndihmon për të marrë forcë dhe vetëbesim të ri.

E treta, sepse ato dëshmuan edhe një herë se gratë kanë potencialin për të qenë agjentë të ndryshimit. Për të tejkaluar (animin) anë-mbajtjen dhe paragjykimet, ato duhet të organizohen, apo thënë ndryshe, ta rimendojnë rolin e tyre në familje dhe në shoqëri, të kuptojnë, mbështesin dhe fuqizojnë njëratjetrën, dhe duke emancipuar vetveten - ta emancipojnë tërë mjedisin ku jetojnë.

Në karrierën time si aktiviste dhe si profesioniste kam pasur rastin të shoh shembuj të përpjekjeve të shumta të grave të përfshira në dialogë dhe nisma të ndryshme, nganjëherë të vështira, për paqe. Këtu do të përmend dialogët dhe nismat e përbashkëta të aktivisteve për paqe të Izraelit dhe Palestinës. Përpara, gjatë dhe pas përfundimit të armiqësive në hapësirën ish-jugosllave, gratë ishin të përfshira në nisma të ndryshme të shumta për t'i tejkaluar ndasitë. Kjo është e kuptueshme sepse të gjitha konfliktet e dhunshme, siç ishte përvoja jonë në vitet e 1990-ta në hapësirën tonë jugosllave, dëshmuan se gratë e paguajnë çmimin më të lartë në konfliktet e tilla. Edhe pse shkaqet dhe vendimet nuk ishin në duart e tyre.

Dialogu ndërmjet Serbisë dhe Kosovës paraqet rast unik për të negociuar paqe të qëndrueshme dhe stabilitet për të dy këto shoqëri dhe për rritje të qëndrueshmërisë dhe zhvillimit për tërë rajonin e Ballkanit. Pra, është thelbësor për gratë. Për këtë arsye do ta citoja fjalinë përmbyllëse të Platformës së Grave për Zhvillimin e Serbisë 2014-2020: "Çka është e mirë për gratë është e mirë për Serbinë". Lehtësisht, këtë deklaratë mund ta shtrijmë për tërë rajonin tonë dhe ta mbajmë në mend kur mendojmë dhe veprojmë si akterë të përgjegjshëm socialë në përkufizimin e rolit tonë në dialog. Ky dialog duhet t'i përfshijë tërë shoqëritë, të gjitha grupet shoqërore, sidomos të rinjtë dhe gratë - sepse ato grupe nuk janë të përfaqësuara mjaftueshëm në organet dhe qarqet vendimmarrëse. Nëse shoqëritë marrin pjesë, atëherë çdo individ mund të pohojë pronësi, të ndjehet përgjegjës për përfundimin dhe pasojat e dialogut.

Gratë munden dhe do të duhej të jenë shumë më aktive në të gjithë hapat e dialogut - nga aspekti teknik e deri te ai politik, si dhe të jenë në pozitë për t'i mbrojtur ato çështje që janë të rëndësishme për gratë, pra për shoqëritë tona, si lëvizja e lirë e mallrave, ideve dhe njerëzve që sigurojnë më shumë mundësi për zhvillim ekonomik për gra, qasje më të mirë në edukim dhe kujdes shëndetësor, sa për t'i përmendur disa; por, po ashtu edhe në projektet e përbashkëta për parandalim aktiv të efekteve më të rrezikshme të ndotjes dhe ndryshimit klimatik, pra, të kontribuojnë për shëndet më të mirë publik për të gjithë. Ne, gratë, duhet t'i kuptojmë përgjegjësitë tona dhe të veprojmë në përputhje me to. Gratë dinë si të kujdesen për të ardhmen e familjeve dhe shoqërive të tyre dhe për këtë arsye ne duhet të kemi rol kryesor në përkufizimin e asaj të ardhmeje.

Autorja është Presidente e Fondit Beogradas për Posaçmëri Politike

Normat kundër normave

Luljeta Demolli

Në vitin 1813, Jane Austin preokupohej me pamundësinë e grave dhe vajzave angleze që të trashëgonin pronë.

206 vjet më vonë, gratë dhe vajzat kosovare lehtësisht mund të identifikohen me Elizabeth Bennet, heroinën e kult romanit "Krenari dhe Paragjykim".

Të nënshtruara nga normat, të varura nga familja, të pabarabarta në shoqëri.

"Gjëja më e rëndë në botë është t'i privosh fëmijët e tu nga trashëgimia" – vlente dikur, vlen edhe sot.

Përjashtimi i grave nga trashëgimia e pasurisë familjare është bërë normë në Kosovë.

Këtë e dëshmon përqindja shumë e vogël e grave që trashëgojnë pronë, më e ulëta në rajon. Atyre u imponohet të heqin dorë nga trashëgimia e tyre pronësore në favor të vëllezërve dhe djemve të familjes.

Normat diskriminuese gjinore gjallojnë brenda familjes kosovare duke u arsyetuar me zakone dhe qëndrime tradicionale.

Sipas mentalitetit patriarkal, një grua nuk njihet si pronare e plotë edhe nëse është trashëgimtarja e vetme në familje. Zakonet shekullore të traditës e kanë vendosur një zinxhir mbështetës që pranohet si normë në shoqëri, që thotë se baballarët i mbështesin djemtë në fëmijëri, në rini dhe pas martesës, ndërsa presin që ata t'ua kthejnë investimin prindëror në pleqëri.

Ndonëse Ligji për Trashëgiminë i bën gratë të barabarta me burrat në aspektin e pronës dhe trashëgimisë, kjo e drejtë nuk realizohet praktikisht ashtu siç duhet.

Në Kosovë, aktualisht, gratë kanë pronësi vetëm 13.8 për qind.

Dominimi i burrave në Kosovë në aspektin e pronësisë vazhdon të konsiderohet si normë gjinore edhe në institucionet e rëndësishme të shoqërisë.

Gratë janë të privuara nga qasja proporcionale në pushtet, rrjedhimisht të pafuqishme për ndikime në proceset politike.

Mospasja e pronës dhe mbizotërimi i burrave në vendimmarrje institucionale bëjnë që gratë të jenë pothuajse jashtë strukturave të pushteteve shoqërore.

Asnjëra nga 38 komunat e Kosovës nuk ka kryetare grua. Nga 21 ministri, vetëm dy udhëhiqen nga gratë. Nga më shumë se 80 zëvendësministra, vetëm 5 janë gra.

Këto norma e kanë ndërtuar një bazë të pandryshueshme në raportet e pushteteve gjinore, situatë e cila e rëndon statusin edhe ashtu përgjithësisht të pafavorshëm të grave në shoqëri.

Sipas statistikave, më shumë se 80 për qind e grave janë të papunësuara. Pronësia dhe pjesëmarrja në jetën politike është drejtpërdrejt e lidhur me fuqizimin ekonomik të grave, krijon të ardhura dhe siguri jetësore.

Statistikat shumëdimensionale do të ofronin peizazh edhe më bindës të prezencës së normave të kësisojta gjinore dhe mënyrën e adaptimit të tyre në shoqëri. Mungesa e vazhdimësisë së hulumtimeve empirike mbi vlerat dhe qëndrimet e shoqërisë kosovare i ka bërë edhe më të vështira strategjitë për sfidimin e dominimit të burrave në të gjitha sferat e jetës.

Arsyetimet më të shpeshta të zbatuesve të ligjit dhe vendimmarrësve për këtë situatë dhe për këto statistika janë se "normat dhe traditat kulturore janë prezente në shoqëri, prandaj duhet t'i marrim parasysh".

Me zbatim të dobët të ligjeve, me programe minimale për t'i ndryshuar qëndrimet tradicionale, një iniciativë kuptimplote për ndryshim e cila ka pasur sukses ka qenë intervenimi me politikën afirmative që pronësia dhe regjistrimi i pronës të jenë në emër të dy bashkëshortëve.

Normat gjinore ndikojnë edhe në gjeneratat e reja, dallojnë në mënyrë të konsiderueshme ndërmjet konteksteve të ndryshme kulturore, por bartin pasoja afatgjate. Ideja që djemtë domosdoshmërisht duhet ta trashëgojnë gjithë pronën familjare mund të ndikojë në pasivizimin e tyre jetësor në aspektin e krijimit të kapitalit, sepse – për dallim nga vajzat dhe gratë e reja – ata do të kenë më pak motiv të angazhohen në tregun e punës. Fuqizimi i vajzave dhe grave për marrjen e trashëgimisë obligativisht duhet të rritet në mënyrë që të përkrahen sa më shumë drejt ndryshimit të konditave të tashme gjinore.

Analiza feministe i konsideron normat gjinore si instrumente mbi të cilat mbahen e fuqizohen ideologjitë dhe marrëdhëniet e pabarabarta gjinore, prandaj me anë të shtojcës Koha për Gratë jemi përpjekur që t'i sjellim në pah perspektivat e pasojave negative të normave aktuale gjinore dhe idetë për sfidimin e tyre.

Ndryshimet pozitive imponojnë angazhime të vazhdueshme, të planifikuara, të strukturuara dhe të sinqerta.

Nga të gjithë ne.

Autorja është Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore



CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Dialogu i burrave tanë

Njëmbëdhjetë burra nga Kosova pati përballë Përfaqësuesja e lartë e BE-s, Federica Mogherini, kur në fillimjanar të këtij viti thirri në takim njoftues delegacionin shtetëror.

Dhjetë prej tyre ishin anëtarë të delegacionit, të deleguar prej partive në pushtet dhe një partie opozitare. I njëmbëdhjeti ishte Ambasadori i Kosovës në Bruksel.

Në anën e Mogherinit, që përfaqësonte Shërbimin e Jashtëm të Brukselit, ishin edhe tri gra tjera dhe një burrë.

Pas tetë vitesh negociata me Serbinë, kjo shënoi herën e parë që ekipi negociues përbëhej nga vetëm një gjini.

Ish-pjesëmarrës në dialog, anëtarë të subjekteve politike dhe përfaqësues të shoqërisë civile, kanë thënë se ky është prapakthim në përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore.

Edita Tahiri ka qenë Ministre për Dialog në mandatin e kaluar qeveritar dhe një mandat tjetër ka shërbyer si kryenegociatore kosovare në dialog me Serbinë. Sa i takon perspektivës gjinore, Tahiri ka thënë për shtojcën "Koha për Gratë" se hapësirat kanë qenë të kufizuara për shkak se dialogu i Brukselit ka trajtuar marrëdhëniet mes dy shteteve.

"Mirëpo, në hapësirat ku ka qenë e mundur unë kam insistuar dhe kam arritur ta përfshij perspektivën gjinore dhe sa më shumë gra në procesin e dialogut. Marrë parasysh se Marrëveshjet e Brukselit e kanë bërë të mundur shuarjen e strukturave paralele serbe dhe vendosjen e institucioneve shtetërore të Kosovës në pjesën veriore të vendit, sipas praktikave ndërkombëtare për paqendërtim dhe riintegrim- kjo praktikë ndërkombëtare e ka kufizuar trajtimin e çështjeve gjinore".

Kur është fjala për respektimin e barazisë gjinore në përbërjen e delegacionit shtetëror në Dialogun e Brukselit, Tahiri thekson se Kosova ka dhënë shembull pozitiv për rajonin dhe botën duke vendosur një grua kryenegociatore. Referuar të dhënave statistikore, ku vetëm 2 për qind e grave janë të përfshira në negociatat për paqe, pra në tryezat formale negociatore në nivel botëror, Tahiri ka thënë se Kosova e ka ngritur veten lart në rangimin e shteteve që respektojnë dhe besojnë në fuqinë e grave, për të bërë paqen dhe për të marrë vendime për paqen.

"Po ua jap edhe një analizë të rëndësishme për nivelin rajonal të Ballkanit. Në të gjitha proceset paqësore për t'i ndalur luftërat dhe zgjidhur konfliktet, vetëm një grua ka qenë negociatore e paqes në Ballkan. Ajo kam qenë unë, si pjesëmarrëse në Konferencën ndërkombëtare të paqes në Rambuje".

Mirëpo, shikuar përbërjen e delegacionit shtetëror në këtë dialog, Tahiri e ka pranuar se aty nuk ka pasur përfshirje të madhe të grave, gjë që ka pasqyruar diskriminimin e grave në qeveri dhe në administratën publike të Kosovës, ku gratë janë lënë anash sidomos në pozitat udhëheqëse të administratës publike dhe niveleve të ekspertëve.

Ajo ka thënë se në rrethin e ngushtë të ekipit negociator i ka pasur edhe dy gra koordinatore të marrëveshjeve, "të cilat kanë bërë një punë serioze dhe të shkëlqyeshme".

Për të përfshirë më shumë gra në procesin e dialogut, Tahiri ka deklaruar se është kujdesur që në procesin e zbatimit të marrëveshjeve të sigurohet se ka respektim të barazisë gjinore. Kësisoj, ajo ka përmendur marrëveshjen për kthimin e dokumenteve kadastrale nga Serbia në Kosovë, dhe atë për Agjencionin teknik për verifikimin dhe krahasimin e këtyre dokumenteve, ku ka arritur që "në marrëveshjen zbatuese të vendosë parimin e barazisë gjinore, gjë që është respektuar në zbatim".

"Po ashtu, në ekipet që kanë punuar për verifikimin e regjistrave civilë të kthyer nga Serbia, ekipe këto të Ministrisë së Brendshme dhe Agjencionit të Kosovës për Regjistrin Civil, ka pasur një pjesëmarrje të rëndësishme të grave".

Pas disa muajsh përpjekjeje për arritjen e konsensusit, më 15 dhjetor të vitit të kaluar, Kuvendi votoi delegacionin.

Bashkëkryesues të delegacionit janë zëvendëskryeministri Fatmir Limaj (Nisma) dhe Shpend Ahmeti, kryetar i PSD-së. Anëtarët tjerë të ekipit janë: Behgjet Pacolli (AKR), Enver Hoxhaj (PDK), Mahir Yagcilar (KDTP), dhe Dardan Gashi. Sipas rezolutës së votuar në Kuvend, një përfaqësues shtesë është caktuar nga opozita dhe një përfaqësues nga boshnjakët, si dhe një përfaqësues i shoqërisë civile që është propozuar të votohet nga ekipi dialogues. Kurse dy vende janë të rezervuara për LDK-në dhe VV-në. Por, në mungesë të tyre, pozitat do t'i mbajnë Visar Ymeri (PSD) dhe Dukagjin Gorani (PSD).

"Nuk ka koment kjo punë: është shkelje e plotë e barazisë gjinore. Është një kthim mbrapa në mënyrë dramatike, për faktin se Kosova ka ditur të jetë madje model për përfshirjen e grave në procese negociatore për paqe, duke marrë mirënjohje dhe respekt ndërkombëtar, duke përmirësuar imazhin e saj si shtet modern e demokratik, duke u ranguar lart në studimet botërore dhe trajtimet institucionale nga organizata botërore", ka thënë ish-kryengocatorja Tahiri, teksa ka komentuar përbërjen e delegacionit.

"Imazh primitiv"

Pjesë e Delegacionit Negociator nuk janë dy partitë kryesore në opozitë, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje.

Kryetarja e Komisionit për Punë të Jashtme, Vjosa Osmani, e ka kualifikuar si "imazh primitiv" fotografinë e burrave në Bruksel.

"Delegacioni aktual është një ekip pa legjitimitet që nuk negocion me askënd dhe BE-ja e konsideron vetëm ekip mbështetës të Presidentit. Megjithatë, pamjet e 12 burrave ulur përballë delegacionit të BE-së (kryesisht të përbërë nga gratë), japin një imazh mjaft primitiv", ka thënë Osmani. Sipas deputetes së LDK-së, historia dëshmon që në çdo rast kur gratë përfshihen në negociata, shanset për sukses janë më të mëdha.

"Prandaj edhe të gjitha organizatat ndërkombëtare që promovojnë paqen e dialogun i inkurajojnë shtetet që në procese negociatash t'i përfshijnë gratë".

Përtej kontekstit gjinor, në Lëvizjen Vetëvendosje kanë dallime thelbësore politike me mendësinë aktuale që, sipas zyrtarëve të këtij subjekti, shpeshherë është përfaqësuar edhe nga disa gra.

Kryetarja e Komisionit për Legjislacion, Albulena Haxhiu, ka thënë se një politikë me parime do të kishte së pari pozicion të drejtë politik karshi Serbisë dhe pastaj edhe përfaqësim të duhur politik e gjinor.

"Në këtë rast, ky grup është vetëm legjitimues i aventurës së Presidentit Thaçi. Edhe po të inkuadrohej ndonjë grua, kjo do të bëhej vetëm që formalisht të mbyllej një dimension i përfaqësimit, siç është ai gjinor. Por, kjo nuk do t'i jepte asnjë grimë më shumë legjitimitet këtij ekipi".

"Mos të harrojmë që gjithë të ashtuquajturin dialog teknik e ka udhëhequr Edita Tahiri, mirëpo për shkak të negociatave pa parime, pa kushte, nga qeverisja e asaj kohe sigurisht se nuk pati asnjë rezultat në drejtim të zgjidhjes së shumë plagëve të mbetura në Kosovë, e as asaj të dhunës seksuale". Sipas Haxhiut, pa qëllime, kushte e platformë të qartë shtetërore në negociata karshi Serbisë, përfaqësimi gjinor në asnjë mënyrë nuk e rregullon rezultatin që do të sjellin ato bisedime.

"Për më tepër, një kritikë e tillë për mospërfaqësim të duhur gjinor do të ishte e rendit të dytë në kohën kur orientimi politik është thelbësisht i gabuar".

Por, Edita Tahiri ka thënë se çështjen e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, nga e cila kanë pësuar mbi 20 mijë gra të Kosovës, e kanë paraqitur në Bruksel si temë për diskutim qysh në vitin 2011, në kuadër të dëmeve të luftës. Por, pala serbe nuk ka pranuar.

"Parimet e këtij dialogu kanë qenë dhe mbeten se pa u pajtuar të dyja palët për temën ajo nuk mund të bëhet pjesë e dialogut. Duke qenë se pala serbe nuk ka pranuar, nuk është futur në agjendë. Megjithatë, unë e kam ngritur çështjen e dhunimit seksual të grave në Bruksel sa herë që diskutimet në dialog kanë marrë kahje të trajtimit të luftës, gjenocidit serb në Kosovë dhe përgjegjësisë për dëmet e luftës".

Parimin që palët nuk mund të imponojnë tema njëanshëm Tahiri e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm, "sepse mbi këtë parim unë kam arritur t'i ndali pretendimet e Serbisë që të flitet për temat e kufijve, apo pasurive natyrore, apo tema tjera të rrezikshme për shtetin tonë".

Mospërfaqësimi gjinor, shqetësim për Gratë Deputete

Zyrtare të partive në pushtet e kanë pranuar se mungesa e grave në delegacionin shtetëror përbën shqetësim.

Blerta Deliu Kodra (PDK) është anëtare e Grupit të Grave Deputete. Ajo ka thënë se mospërfaqësimi gjinor është ngritur si problem edhe brenda këtij grupi.

"Në të kaluarën, delegacioni është udhëhequr nga një grua. Këtë peshë politike e ka bartur ish-kryenegociatorja Edita Tahiri për një mandat të tërë. Për neve si gra deputete ka qenë shqetësim që është adresuar edhe në nivel të grupit". Sipas saj, janë partitë ato që kanë vendosur të përfaqësohen në nivel të nënkryetarëve dhe kryetarëve.

"PDK është e përfaqësuar me Enver Hoxhajn, i cili është marrë një kohë të gjatë me këto negociata. Gjithsesi do të ishte mirë që të ketë gra. Na është thënë që gjatë ekipeve teknike, të cilat do të kenë shumë punë, do të ketë përfshirje më të madhe edhe përfaqësim gjinor", ka thënë ish-kryetarja e Grupit të Grave Deputete.

Partia Socialdemokrate (PSD) është subjekti i vetëm opozitar që u bë pjesë e negociatave. Në këtë parti kanë thënë se edhe ata janë pjesë e një mentalitetit patriarkal, ku gratë vazhdojnë të jenë të papërfaqësuara.

"Gratë në Kosovë edhe më tutje vazhdojnë të jenë të shtypura. Ato janë të papërfshira dhe të papërfaqësuara. Kjo është simptomë e një mentaliteti patriarkal, i cili është i institucionalizuar. Kjo kritikë vlen edhe për Partinë Socialdemokrate", ka thënë zëdhënësja e PSD-së, Natyra Kuçi.

Ajo ka shtuar se do të përpiqen që kjo gjendje të përmirësohet në të ardhmen, përmes një agjende me politika për avancimin e çështjes gjinore.

"PSD do të punojë shumë që në vështrimin dhe veprimin e saj ta ketë të integruar edhe aspektin e gjinisë, duke qenë çdoherë në përpjekje për barazi gjinore në kushte dhe mundësi".

Aktualisht, Kosova e ka shënuar pikën më të ulët edhe kur bëhet fjalë për përfaqësimin gjinor në kabinetin qeverisës. Në qeverinë e udhëhequr nga Ramush Haradinaj, prej 22 anëtarëve vetëm një ministri drejtohet nga ministre grua.

Përfaqësues të Shoqërisë Civile thonë se Delegacioni Shtetëror është reflektim i skenës politike kosovare ku pozitat e larta vendimmarrëse, si brenda partive ashtu edhe në institucione publike, mbahen nga burrat.

"Kjo përveç që është dekurajuese për vajzat e reja që duan të bëhen politikane, është dekurajuese edhe për gratë që janë aktualisht aktive në politikë, disa nga të cilat janë shumë të përgatitura për të qenë pjesë e këtij delegacioni. Mbi të gjitha, ky 'Delegacion i Burrave' paraqet një imazh tejet negativ për Kosovën si shtet në arenën ndërkombëtare", ka thënë Roberta Osmani, Hulumtuese e Lartë në "Demokraci Plus (D+)".

Mospërfaqësimi i grave në ekipe të tilla është në kundërshtim edhe me dokumentet ndërkombëtare, të cilat institucionet e Kosovës kanë marrë përsipër t'i zbatojnë.

Në janar të vitit 2014, Qeveria ka aprovuar Planin e Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325: "Gratë, Paqja dhe Siguria" të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ajo përfshin tri objektiva: "1. Pjesëmarrje e rritur e grave në vendimmarrje dhe në proceset e ndërtimit dhe ruajtjes së paqes; 2. Perspektiva gjinore e integruar dhe pjesëmarrja e rritur e grave në strukturat e sigurisë; 3. Viktimat e dhunës seksuale, torturës dhe formave të tjera të dhunës së lidhur me konflikt/luftë kanë qasje në mekanizma funksionalë për mbrojtjen, qasjen në drejtësi, rehabilitimin dhe re-integrimin e tyre".

Ndërkaq, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara kërkojnë që të bëhet "sigurimi i pjesëmarrjes së plotë dhe efektive dhe i mundësive të barabarta për lidership të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike".

Kosova ka edhe Program për Barazi Gjinore, i cili ka për qëllim të nxisë dialogun mbi integrimin e barazisë gjinore në Kosovë. Kjo nënkupton pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në jetën sociale, ekonomike e politike të vendit; mundësi të barabarta për t'i gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre në dobi të shoqërisë.

Çështja e viktimave të dhunës seksuale jashtë tryezës së dialogut

Kosova zhvillon dialog me Serbinë prej vitesh. Por, përfaqësuese të opozitës thonë se Kosova nuk ka pasur dobi nga ky proces, edhe për faktin se perspektiva gjinore nuk ka qenë e përfshirë. Janë skeptike nëse edhe delegacioni i mandatuar në fundi do të arrijë ndonjë rezultat.

"Nëse shikohen mbi 30 marrëveshjet e arritura në Bruksel që nga viti 2011, shihet që perspektiva gjinore nuk ka qenë e përfshirë në diskutime dhe as çështja e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës", ka thënë Vjosa Osmani.

Sipas Albulena Haxhiut, jo vetëm aspekti gjinor, por edhe nisja e këtyre negociatave ka qenë e gabuar nga pala kosovare.

"Vetëm prej vitit 2011 janë arritur 33 marrëveshje me Serbinë në fusha të ndryshme. Ato që do të duhej të ishin kushte për Serbinë shpesh është thënë se do të jenë tema, por sigurisht asnjëherë nuk kanë mundur të imponohen si tema të bisedimeve".

"I tillë është edhe rasti me të pagjeturit, dëmet dhe rastet e dhunimit të mbi 20 mijë grave shqiptare. Një gjë duhet të kemi parasysh që nuk mund të presim rezultate pozitive të veçanta, siç është rasti i temës për dhunën seksuale gjatë luftës, kur pozicioni i përgjithshëm i shtetit të Kosovës është krejtësisht i gabuar". Në Lëvizjen Vetëvendosje thonë se nuk mund të ketë raporte me Serbinë pa kaluar nga procesi i vendosjes së drejtësisë për viktimat dhe dëmet luftës, pa kërkuar falje për krimet e kryera në Kosovë dhe pa u distancuar qartazi nga ajo platformë gjenocidiale.

"Njohja e krimit të kryer, dënimi i kriminelëve të luftës, dëmshpërblimi dhe njohja e Pavarësisë së Kosovës - janë kushte të pakapërcyeshme. Ikja, arratisja prej tyre, përbën padrejtësi mbi viktimat, dëshmorët dhe të gjitha sakrificat e popullit", ka thënë Haxhiu.

Në vitin 2014, ish-kryenegociatorja Edita Tahiri përmes një dokumenti 17 faqesh pati listuar 7 tema për fazën vijuese në kuadër të dialogut me Serbinë. Në dokument parashihej të kërkohej edhe zhdëmtimi i familjarëve të atyre që janë vrarë dhe zhdukur nga Serbia, dëmshpërblimi i personave apo familjareve të atyre që janë mbajtur politikisht nëpër burgjet e ish-Jugosllavisë, si dhe dëmshpërblimi i grave të dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë. Sipas Tahirit, këto tema duhet të trajtohen në kuadër të reparacioneve të luftës.

Adresimi i çështjes së të dhunuarave të luftës është përfshirë edhe në Platformën e Dialogut.

"Në platformën e përpiluar nga Delegacioni Shtetëror, pikë e rëndësishme janë edhe krimet e luftës të shkaktuara nga aparati i dhunës së shtetit të Serbisë, ku sa i përket dhunës seksuale në platformë ceket: 'Për viktimat e dhunës seksuale, Kosova do të kërkojë drejtësi, rehabilitim dhe dëmshpërblim për vuajtjet denigruese dhe çnjerëzore të shkaktuara nga Serbia gjatë luftës në Kosovë", ka thënë Natyra Kuçi (PSD).

Edhe deputetja e PDK-së, Deliu-Kodra, mendon se pa i shtruar këto tema në tryezën e dialogut nuk mund të synohet normalizimi i marrëdhënieve me shtetin serb. Ajo ka thënë se zgjidhja e statusit të grave të dhunuara, të pagjeturve dhe mosdënimi i kriminelëve kanë qenë brenga e tyre e përhershme.

"Viktimat e luftës, gratë e dhunuara, të pagjeturit- natyrisht se janë temat më të rëndësishme që duhet shtruar. Jam e sigurt se pa u trajtuar këto tema nuk mund t'i kontribuohet një marrëveshjeje të suksesshme mes dy shteteve. Këto janë tema që kërkojnë zgjidhje dhe përgjigje".

Sipas Roberta Osmanit, me insistim të pakompromis në këtë fazë të dialogut duhet të kërkohet zbardhja e fatit të të zhdukurve dhe kërkimfalja publike e Serbisë për të gjitha krimet e kryera ndaj popullatës së Kosovës. "Kjo e dyta vështirë se do të ndodhë, duke qenë se historikisht Serbia nuk merr përgjegjësi për krimet e luftërave të veta. Por, me diplomaci publike mund të paktën t'ia rikujtojmë botës se kush ishte agresori dhe kush viktima në luftën e fundit në Kosovë, para se Serbia me diplomacinë e vet të arrij ta paraqes të kundërtën".

Kosova nuk ka ndërtuar një qëndrim të përbashkët rreth dialogut, as nuk ka vendosur vija të kuqe. Me versione të ndryshme liderët janë shfaqur edhe në takimet jashtë vendit, ku theksi është vënë tek marrëveshja që nuk e përjashton as ndryshimin e kufijve.

Delegacioni Shtetëror nuk do ta ketë rolin kryesor në negociata. Ai do t'i shkojë pas presidentit Thaçi, i cili prej dy vitesh ka marrë levat e dialogut, duke e çuar në një fazë tjetër.

Edhe për ndërmjetësuesen e dialogut, Federica Mogherini, presidenti kosovar është adresa kryesore në këtë proces, pasi edhe zyrtarisht i ka kërkuar qeverisë që ekipi vetëm t'i mbështetë përpjekjet e Thaçit për arritjen e një marrëveshjeje finale me Serbinë.

Gazetar kontribuues:
Fitim Gashi



CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Barazia gjinore – Ta bëjmë!

Karin Hernmarck Ahliny

Kur në vjeshtën e vitit 2014 Qeveria e Suedisë vendosi ta niste një politikë të jashtme feministe, ajo ishte qeveria e parë në botë që po e bënte një gjë të tillë. Së shpejti ajo u pasua me deklaratën se e tërë qeveria ishte qeveri feministe. Suedia është e lumtur që shumë vende të tjera e ndoqën shembullin e saj, përderisa rëndësia e agjendës feministe dhe e analizës themelore që qëndron prapa saj po bëhet pjesë e temave kryesore.

Asnjë lëvizje e rëndësishme që mëton ndryshim të njëmendtë nuk kalon pa kritikues ose kundërshtarë. Ndryshimi, madje edhe për të mirë, nganjëherë do të jetë i dhimbshëm dhe shpesh do të kërkojë rivlerësim të asaj që besoni se është e vërtetë, si dhe të kuptuarit se supozimet e pathëna duhet të vihen në pikëpyetje. Feminizmi e synon ndryshimin e vërtetë dhe e bën këtë nga bindja se një shoqëri me barazi gjinore mundëson jetë më të mirë për të gjithë pjesëtarët e saj, pa marrë parasysh identitetin gjinor.

Politika e jashtme feministe suedeze pikënisjen e kishte në tri pika kryesore: të drejtat, përfaqësimin dhe resurset, që të gjitha të bazuara në parashtrimin e shumë pyetjeve për të ardhur deri te realiteti të cilin po përpiqemi ta ndryshojmë. Tri pikat – sado të thjeshta që mund të duken – na ofrojnë përqendrimin për t'i parashtruar pyetjet e duhura kur ta vlerësojmë gjendjen e barazisë në cilëndo shoqëri.

A janë të drejtat e grave të njëjta si të burrave? Dhe a kanë ato qasje në resurse të njëjta? A munden, për shembull, gratë të hyjnë në tregun e punës dhe a marrin trashëgimi mbi të njëjtën bazë si burrat?

Globalisht, e dimë që përgjigja është jo. Në Kosovë, për fat të keq, përgjigja është gjithashtu jo. Përkundër ligjeve të shkëlqyeshme, diskriminimi i grave ngulmon në tregun e punës dhe pjesëmarrja e grave është e ultë. Sistemet e sigurimit social – dhe mungesa e të tyre – nuk i favorizojnë gratë, njëjtë si praktikat e trashëgimisë. Gratë nuk janë të regjistruara si pronare të pronës dhe nuk mund të kenë qasje në financa. Lista është e gjatë. Faktet ekzistojnë.

A janë gratë të përfaqësuara në proceset vendimmarrëse? Apo, a ka pengesa të njohura e të panjohura për gratë për t'u bërë pjesë e tryezave ku merren vendimet? Përkundër sistemit të kuotës, përfaqësimi i grave të Kosovës në pozita të larta është për keqardhje. Pse sot është vetëm një grua ministre në Qeverinë e Kosovës? Dhe pse nuk ka fare gra në delegacionin shtetëror në dialogun për normalizim kur ka hulumtime që sugjerojnë se proceset e paqes kanë gjasa më të mira për të arritur zgjidhje të qëndrueshme kur gratë janë të pranishme në tryezë? Nuk mungojnë politikanet kompetente kosovare, por ato nuk kanë vend në tryezë.

Një aspekt frustrues i përfaqësimit të politikës së jashtme feministe dhe qeverisjes feministe në përgjithësi ndonjëherë është koha e cila duhet kaluar për të shpjeguar çfarë është dhe pse është e domosdoshme. Kjo më ka lodhur. Ka dëshmi dërrmuese se barazia gjinore ka ndikim pozitiv në rritje ekonomike, shëndetësi, arsimim dhe paqe. Le të pajtohemi të gjithë për këtë dhe të përqendrohemi në atë se çfarë duam të bëjmë për ta ndryshuar gjendjen. Por, duke e bërë këtë të mos harrojmë se nuk është vetëm çështja për ta bërë botën një vend më të mirë për të gjithë ne. Barazia gjinore, mbi të gjitha, është e drejtë. E drejtë e njeriut. Dhe pa barazi gjinore, të drejtat e grave vihen në rrezik.

Si pjesa tjetër e botës, edhe Kosova çdo vjeshtë merr pjesë në 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore, por gratë – sepse kryesisht po flasim për gratë – ende rrihen dhe abuzohen në këtë vend. E dimë se gratë janë më së shumti në rrezik në shtëpitë e tyre, ku abuzohen dhe nganjëherë edhe vriten nga burrat që janë anëtarë të familjeve dhe thonë se i duan ato. Kjo është dukuri globale dhe është gjithashtu e pranishme edhe këtu në Kosovë. Ka të dhëna që sugjerojnë se 1 në 3 gra prej të gjitha grave në këtë vend kanë përjetuar këtë lloj të dhunës. Ky fakt pikëllues nuk mund të kuptohet pa i kuptuar dinamikat e përbrendësuara të pushtetit mbi të cilat lulëzon shoqëria patriarkale. Po të ishin gratë dhe burrat përnjëmend të barabartë, gratë nuk do të kishin nevojë të përjetonin dhunë fizike dhe burrat nuk do të kishin nevojë t'i kthenin emocionet e tyre në dhunë.

Për ta përmbyllur, ka gjëra që mund t'i bëjmë. Gjëra konkrete. Ja disa rekomandime.

Për politikanët:

Pushim prindëror të financuar nga qeveria qendrore dhe neutral ndaj gjinisë.

Zbatim i duhur i legjislacionit kundër diskriminimit në tregun e punës.

Rritje e resurseve dhe njohurive për policinë dhe sektorin e drejtësisë sa i përket dhunës në baza gjinore.

Strehimore për viktimat e dhunës në baza gjinore, të financuara në mënyrë të qëndrueshme nga qeveria qendrore.

Për të gjithë ne:

Të mos ndalemi së foluri për barazinë gjinore. Të flasim për pabarazitë. Të flasim për dhunën dhe abuzimin, por të mos flasim nëse ekzistojnë ato dhe çfarë efekti kanë. E dimë këtë. Të fillojmë të flasim për atë se çfarë mund të bëjmë – dhe pastaj ta bëjmë. Jemi vonuar shumë.

Autorja është Ambasadore e Suedisë në Kosovë

Të drejtat e grave dhe vajzave për një botë të bazuar në drejtësi

Ulrika Richardson

Dita Ndërkombëtare e Gruas është ditë për të reflektuar mbi progresin e arritur, ditë reflektimi për hendeqet e mbetura dhe për atë çfarë duhet të bëhet më shumë. Po ashtu, është ditë kur i bashkojmë forcat e ripërtërira, motivojmë njëra-tjetrën, por është edhe ditë kur kërkojmë më shumë llogaridhënie nga vendimmarrësit e ligjvënësit për të përshpejtuar arritjen e rezultateve drejt barazisë gjinore, fuqizimit të grave, si dhe mundësive të barabarta për vajza dhe djem.

Ka 109 vjet që kremtohet Dita Ndërkombëtare e Gruas, 71 vjet prej miratimit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, 40 vjet prej kur Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. dhe 24 vjet nga Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim. Natyrisht, bota ka qenë dëshmitare e përparimit të rëndësishëm - aktivizmi i miliona grave anembanë botës në shumë fronte është shpaguar. Por, gratë dhe vajzat anembanë botës ende vazhdojnë të qeverisen me praktika dhe norma të vjetruara që i bëjnë ato të jetojnë në pabarazi, diskriminim, padrejtësi dhe përjashtim. Kjo na tregon se tash nuk është koha për t'u ndalur dhe për të qenë të kënaqura me fitoret e deritanishme. Jo! Lufta jonë duhet të vazhdojë! Tash është koha për ta fuqizuar betejën tonë drejt çrrënjosjes njëherë e përgjithmonë të të gjitha shkaqeve të diskriminimit që ende i kufizojnë të drejtat e grave dhe vajzave në sferën private dhe publike.

Një aspekt i tillë i jetës sonë - për të cilin ndoshta flitet më pak - por i cili qartazi tregon shkallën dhe pasojat e diskriminimit në baza gjinore është posedimi i kufizuar i pronës dhe i të drejtave për tokë. Pasja e pronës luan rol vendimtar në forcimin e pozitës shoqërore, autonomisë dhe fuqizimit të grave. Gjithashtu e dimë se sigurimi i të drejtave të duhura pronësore sjell deri te rezultatet pozitive të dëshmuara shkencërisht për tërë shoqëritë dhe ekonomitë. Investimi në fuqizimin ekonomik të grave përcakton shteg të drejtpërdrejtë drejt barazisë gjinore, vë themelet për çrrënjosjen e varfërisë, duke thyer rrethin vicioz të varfërisë dhe duke vepruar si katalizator i fuqishëm ekonomik.

Thënë thjesht, të kesh të drejta në pronë nënkupton që pronësia është e njohur në aspektin shoqëror dhe ligjor, si dhe e zbatueshme nga autoritetet legjitime. Edhe sot, anembanë botës dhe në Kosovë, normat tradicionale dhe shoqërore të përkufizimit të trashëgimisë dhe të drejtave në pronë fuqimisht anojnë kah burrat, duke i lënë gratë prapa në qasjen ndaj të drejtave të tyre për trashëgimi dhe rrjedhimisht në përmbushjen e potencialit të tyre.

Kjo pabarazi në pronësi dhe në kontrollin mbi pronën është njëri ndër faktorët kryesorë që i mbajnë me këmbëngulje hendeqet gjinore në statusin shoqëror, mirëqenien ekonomike dhe fuqizimin. Po ashtu, e dimë se kjo i kontribuon dhunës në baza gjinore, sepse pa pavarësi ekonomike një grua ka më pak gjasa të ketë fuqi dhe mundësi për t'u larguar nga marrëdhënia abuzive. Duhet ta mbajmë në mend ndërlidhjen e fortë ndërmjet fuqizimit ekonomik dhe dhunës në baza gjinore kur përballemi me shifrat kthjelluese dhe trishtuese, sipas të cilave 1 në 3 gra në botë përjeton ndonjë formë të dhunës gjatë jetës së tyre.

Pa marrë parasysh ligjet e avancuara në fuqi dhe nismat vetëdijesuese për rishikimet e ligjeve që mbrojnë dhe stimulojnë qasjen e grave në trashëgimi, gratë në Kosovë vazhdojnë të heqin dorë nga trashëgimia e tyre në të mirë të vëllezërve apo kushërinjve të tyre, duke iu dhënë prioritet ligjeve zakonore. Përveç kësaj, gjatë analizave të rrëfimeve gojore, është vërejtur se ka raste kur anëtarët e familjeve ua mohojnë të drejtat pronësore fëmijëve të mitur pa asnjë mbështetje profesionale që do të siguronte mbrojtjen më të mirë të interesave të fëmijëve.

Të drejtat pronësore të grave dhe pronësia janë thelbësore për sigurinë e tyre ekonomike, statusin e tyre shoqëror dhe ligjor, dhe nganjëherë edhe për mbijetesën e tyre. Mungesa e qasje në asete i lë gratë në pozitë të cenueshme në familje dhe shoqëri, duke i bërë ato ekonomikisht të varura nga anëtarët burra të familjes. Burimet për këtë pabarazi dhe diskriminim janë strukturat e vjetruara të familjeve dhe shoqërisë patriarkale, ligjet zakonore, si dhe mungesa e vetëdijesimit për të drejtat e grave.

Në vitin 2018, përqindja e grave kosovare që kishin pronë ishte 17 për qind – që shënon rritje për 6 për qind krahasuar me vitin 2013, por ende mbetet shumë prapa rajonit apo BE-së. Kjo do të thotë se edhe pse gratë e përbëjnë gjysmën e shoqërisë kosovare, ato nuk janë as afër pjesëmarrjes së plotë në zhvillimin e saj, sepse iu mungojnë mundësitë për t'u bërë ndërmarrëse dhe për të krijuar biznese të reja, për të ndihmuar në rritjen ekonomike dhe për të krijuar vende pune për të tjerët. Kjo ndërlidhje ndodh meqenëse pa pronë të regjistruar në emrin e tyre ato nuk mund të marrin kredi në banka. Kjo nuk është e dëmshme vetëm për shoqërinë kosovare, por i parandalon gratë nga të qenit anëtare të barabarta në familje dhe në shoqëri, si dhe paraqet shans të humbur për t'i ndjekur ëndrrat personale – është potencial i humbur.

Hierarkitë gjinore, strukturat patriarkale dhe diskriminimi paraprak vazhdojnë t'i vendosin gratë në pozita të pafavorshme në shumë sektorë të shoqërisë, duke i mbajtur në mënyrë kronike të nënpërfaqësuara në vendimmarrjen politike dhe ndërtimin e paqes.

Si grua nga Suedia, vend nismëtar i hershëm i lëvizjes globale të grave, si dhe përmes 25 vjetëve të përvojës ndërkombëtare në bashkëpunimin zhvillimor në kontekste të ndryshme kulturore, politike dhe ekonomike, e kam parë me sytë e mi parakushtin qendror dhe të domosdoshëm për fuqizimin e grave për përparimin socioekonomik dhe qëndrueshmërinë e cilësdo përpjekjeje të ndërmarrë.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave gjithashtu është pjesë përbërëse dhe zemra e secilës prej 17 Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ). Objektivat globale për të cilat është zotuar Kosova e ndërlidhin drejtpërdrejt me procesin më të rëndësishëm global të shekullit 21, si dhe me hapësirë për t'i përkufizuar përpjekjet e saja për zhvillim me standardet e reja universale për zhvillim që do të sigurojnë që askush nuk do të mbetet mbrapa.

Dita Ndërkombëtare e Gruas ofron mundësi për t'i shtjelluar mundësitë për përshpejtimin e Agjendës 2030, duke ndërtuar momentum për zbatimin efikas të OZHQ-ve. Vetëm duke i siguruar të drejtat e grave dhe vajzave në të gjithë objektivat do të mund të jetojmë në një botë të bazuar në drejtësi dhe përfshirje, me ekonomi që funksionojnë për të gjithë, si dhe duke ruajtur mjedisin tonë të përbashkët tani dhe për brezat e ardhshëm. Në këtë ndërmarrje ambicioze për t'i bërë OZHQ-të realitet, të gjithë ne - qytetarët, qeveritë, udhëheqësit, shoqëria civile, bizneset e sektorit privat - luajmë rol në mbështetjen e fuqizimit të grave, si dhe në avancimin e barazisë gjinore përmes veprimeve në shtëpi, komunitet dhe në vend të punës. Shkurtimisht, realizimi i OZHQ-ve varet nga përmbushja e Objektivit 5 - Barazisë Gjinore. Si përfaqësuese e OKB-së në Kosovë, por ç'është më me rëndësi, si përkrahëse e të drejtave të barabarta për gra, unë shoh që:

- Çdo vit ne bëjmë zotime të vlefshme - por ato nuk përkrahen me mbështetje financiare dhe politike.
- Statistikat tregojnë numër të vogël të pronësisë – kjo ende nuk i kontribuon ndryshimit.
- Mbështetemi shumë në rrjetet e grave - por ato nuk janë mjaft të fuqishme.
- Çdo vit kërkojmë analiza gjinore - por nuk gjejmë buxhetin e duhur për mbështetje.
- I nxis institucionet kosovare dhe shoqërinë ta kuptojnë potencialin e grave si kontribuuese në shoqëri, duke i respektuar dhe zbatuar të drejtat për pronë dhe pronësi.
- Gratë mund të luajnë rol të fuqishëm në forcimin e qeverisjes demokratike dhe të drejtave të njeriut nëse partnerët përkatës monitorojnë zbatimin e ligjeve në të mirë të të drejtave të barabarta për gra dhe burra.
- Shoqëria civile duhet të ketë më shumë qasje në fonde për fuqizimin e grave dhe kjo mund të jetë diçka që mund ta hulumtojmë bashkërisht përderisa ecim përpara drejt zbatimit të OZHQ-ve.
- Në fund, rritja e qëndrueshme ekonomike e Kosovës varet nga performanca e 50 për qind të kapaciteteve të shoqërisë kosovare.
- "Të mos e lëmë askënd mbrapa" është zotimi parësor global i OKB-së brenda Agjendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm. Të drejtat e grave janë të drejta të njeriut! Dhe të drejtat e njeriut qëndrojnë në thelb të parimit për të mos e lënë askënd mbrapa. Të drejta të njeriut dhe drejtësi sociale.

Sot, më 8 Mars, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, i nderoj të gjitha gratë dhe burrat që luajnë rol të jashtëzakonshëm në luftën për të ardhme të drejtë dhe të barabartë. Sot e përshpejtojmë hapin tonë në rrugëtimin drejt një bote ku gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, zënë të njëjtin vend, gëzojnë të njëjtat të drejta dhe mundësi, dhe jetojnë krah për krah me respekt dhe në paqe!

Autorja është Koordinatore e Programit të OKB-së për Zhvillim

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

EDHE NJË VIT PA DREJTËSI PËR GRATË

Pa drejtësi gjinore

Për herë të parë në Kosovë një aktgjykim ka ngjallur shpresë se megjithatë drejtësia mund të vendoset kur bëhet fjalë për vrasës vajzash e grash. Ndonëse nuk është rast që e përfaqëson frymën se si vendos drejtësia karshi dhunës e vrasjes se grave, dënimi i Pjetër Nrecajt, i cili ka vrarë bashkëshorten dhe vajzën e tij, ka ngjallur shpresë të gratë që denoncojnë këto raste. Por, për raste të ngjashme si kjo drejtësia nuk ka ardhur njëjtë. Zinxhiri i gjatë hetuesisë shpeshherë është shkëputur dukë bërë që gra e vajza të mos gjejnë drejtësi, por në vend të saj të mbrohen abuzuesit



Ka rreth tre vjet qëkur vizitat e A. N., 22 vjeçare nga Prishtina, për në dyert e hetuesisë janë bërë të shpeshta. Policia, prokuroria dhe gjykata janë vendet që tashmë më së shumti i viziton. E përcjellë nga nëna dhe motra me e re, ajo para disa javësh ka trokitur sërish në dyert e zyrës së një prokurori. Insistonte që të bisedonte me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Një marrëdhënie saj e dhunshme me një burrë shtatë vjet me të vjetër se ajo ia ka pamundësuar jetën normale. Jo vetëm asaj. Jetë normale, sipas tyre, nuk ka askush nga familja.

Shtatë denoncime e pesë urdhra mbrojtës nuk kanë arritur që ta shpëtojnë A.N. Dënimet me kusht për abuzuesin ka bërë që posa ai të dalë nga burgu të vazhdojë ta maltretojë.

Historia është gati çdoherë e njëjtë. Një denoncim në polici, i cili nëse ke fat trajtohet shpejt në Prokurori, e lënda në gjykatë merr shumë muaj. Për këtë viktimë dënimi nuk ka qenë satisfaksion.

"Një herë katër muaj e një herë gjashtë muaj me kusht", ka thënë ajo.

Ky nuk është rast i izoluar. Çështja e trajtimit të dhunës në familje shpesh ka mbetur pa përgjigje nga drejtësia, ndërsa në rastet kur është përgjigjur ka qenë tepër vonë për viktimat gra ose fëmijë.

"Hetimet vazhdojnë"

Një numër telefoni pa pagesë që gjendet në faqen zyrtare të Policisë së Kosovës është kontakti i parë që viktimat mund të kenë për denoncimin e abuzuesve.

Për disa ditë është provuar të telefonohet ky numër. Pak sekonda janë dashur që dikush nga Policia e Kosovës të përgjigjet për ta pranuar denoncimin. Ndonëse efikas në përgjigjen e parë, procedimi i një rasti të dhunës në familje pastaj merr kohë, ose injorohet - përkundër faktit se korniza ligjore për këtë pjesë është e avancuar.

Betim Musliu, hulumtues i lartë në Institutin e Kosovës për Drejtësi, e ka sqaruar këtë aspekt.

"Sipas Ligjit për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje, është obligim ligjor për Policinë e Kosovës t'i përgjigjet secilit njoftim për veprat ose kërcënimet e dhunës në familje. Sikurse Policia e Kosovës, respektivisht Shefi i njësitit rajonal të Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje, mund ta shqiptojë urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente dhe të caktojë masa adekuate të mbrojtjes kur ekzistojnë baza për të besuar se kryesi ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje. Apo kur kryesi i dhunës paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të atypëratyshëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, të cilët duhet të mbrohen me anë të urdhrit për mbrojtje".

Thyerjen e parë një grua ose vajzë në raport me drejtësisë e pëson në Policinë e Kosovës. Hetuesit policorë të cilët janë hallka e parë e grave që kërkojnë drejtësi shpesh nuk i trajtojnë me seriozitetin e duhur kanosjet që u bëhen grave.

Kësisoj, ka raste kur hetuesit të cilët e përpilojnë kallëzimin penal të viktimës nuk e trajtojnë atë seriozisht. Kjo bën që pak kërkesa të prokurorëve, edhe pse të mëdha në numër për masën e paraburgimit, të kalojnë në gjykatë. Për shumicën e të dyshuarve për abuzim gjykata nuk parasheh masë paraburgimi.

Sipas të dhënave zyrtare të sistemit të drejtësisë, masat e paraburgimit për këtë kategori caktohen rrallë.

"Prej 2.959 kallëzimeve penale në vitin 2016, prokuroria ka bërë 84 kërkesa për paraburgim (2.8 për qind). Në 2017, paraburgimi u kërkua në 115 raste (11.3 për qind) dhe në gjysmën e parë të vitit 2018 paraburgimi u kërkua në 69 raste (5.5 për qind)", dëshmojnë të dhënat e përpunuara për këtë çështje nga organizatat që e monitorojnë këtë fushë.

Një gjë e tillë bën që pasiguria e grave dhe vajzave të rritet.

Efektet e lirimit të autorëve të krimit, sipas monitoruesve të këtij sistemi, shpesh përcillen me presion familjar ndaj viktimës, por ka pasur raste kur i kanë shpjerë viktimat drejt tërheqjes së deklaratave të tyre dhe ndjekjes penale të akteve të dhunës në familje. Sipas raporteve, një gjë e tillë përshkallëzon kur prokurorët lejojnë pa asnjë hetim shtesë ndryshimin e deklaratave të viktimave pasi i dyshuari lihet në liri.

"Mbështetja e përgjithshme e prokurorëve mbi deklaratat e viktimave, si dhe tërheqja e mëvonshme e viktimës nga prokuroria, kontribuon në numrin e madh të rasteve të hedhura poshtë çdo vit në gjykatë", thuhet në një raport të organizatës KIPRED, të botuar muaj më parë.

Dhunë në sy të policisë

Janë të shumta rastet kur viktimat kanë gjetur vdekjen nga abuzuesit e tyre disa orë, ose disa ditë, pasi kanë njoftuar Policinë e Kosovës.

Valbona Marku - Nrecaj dhe vajza e saj e mitur janë viktimat më të fundit të dhunës së burrave në Kosovë. Vrasja e nënës dhe bijës, të cilat edhe më herët kishin përjetuar dhunë në familje, do të mund të parandalohej nëse Policia e Kosovës do ta trajtonte seriozisht këtë rast. Pak orë para vrasjes, Valbona e kishte denoncuar ish-bashkëshortin në polici. Kishte thënë se po e kanoste. Policia e Kosovës e kishte kërkuar tek shtëpia e të dyshuarit. Nuk e kishin gjetur. Pastaj, siç thonë ata, kishin provuar ta telefononin këtë recidivist për dhunë në familje, por nuk ua kishte hapur telefonin. E kishin lënë me kaq. Pak orë pasi zyrtarë të policisë shkuan në shtëpinë e prindërve të Valbonës, ajo dhe vajza e saj tashmë kishin ndërruar jetë si pasojë e plumbave të ish-bashkëshortit, të cilit pak orë me herët Policia e Kosovës kishte dështuar të ia identifikonte vendndodhjen.

Ahmet Hasi, nënkolonel në Policinë Rajonale të Gjakovës, ka dhënë një deklaratë në lidhje me vrasjen e Valbona Marku – Nrecajt.

"Në orën 15:00, ankuesja, tani viktimë, bashkë me vëllezërit ka hapur rast 'kanosje', pasi ka njoftuar se me sms është kërcënuar nga bashkëshorti. Hetuesit e kanë kërkuar personin në fjalë, përfshirë edhe në shtëpinë e tij në fshatin Bitesh. Disa herë është provuar të kontaktohet edhe përmes telefonit. Me rastin e paraqitur me 7 gusht, viktima nuk ka kërkuar mbrojtje as strehim, derisa është hapur vetëm rast kanosje për sms-të".

Pak kohë para vrasjes, Valbona Marku – Nrecaj kishte përjetuar lëndime të lehta trupore nga ish-bashkëshorti. Për këtë, rreth një muaj më parë, Prokuroria në Gjakovë kishte ngritur aktakuzë kundër bashkëshortit. Aktakuza ishte për veprën "lëndim i lehtë trupor", ani pse ajo ishte ankuar që bashkëshorti e kishte dhunuar seksualisht disa herë. Kjo deklaratë nuk ishte marrë seriozisht nga Prokuroria Themelore në Gjakovë.

Prokurorja e rastit ka thënë pas vrasjes se deklarata për dhunë seksuale nuk ka mundur të trajtohet për shkak që nuk ka qenë e mundur të bëhet ekspertizë.

"Cili ekspert në botë mund ta konstatojë një ekspertizë të dhunës seksuale kur ajo pretendonte se bashkëshorti kishte kryer marrëdhënie me dhunë për 16 vjet, por asnjëherë s'e ka treguar kohën, as mënyrën dhe as nuk e ka paraqitur rastin, por vetëm se ka pasur raste gjatë martesës", ka deklaruar prokurorja Mone Syla.

Sipas prokurores, për shkak të pamundësisë për të vërtetuar ajo nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim shtesë për ta hetuar pretendimin e viktimës Valbona Marku-Nrecaj për marrëdhënie seksuale me dhunë, të kryera ndaj saj nga ish-bashkëshorti Pjetër Nrecaj.

Institucionet e drejtësisë tregojnë se statistikat e dhunës në familje rriten nga viti në vit.

Nga të dhënat e Policisë së Kosovës që i janë ofruar shtojcës "Koha për Gratë", vetëm këtë vit rreth 700 gra i kanë paraqitur në polici burrat, vëllezërit dhe familjarët e tjerë të cilat kanë ushtruar dhunë ndaj tyre.

"Në periudhën gjashtëmujore janar-qershor 2018 janë evidentuar 628 raste", thuhet në përgjigjen e Policisë së Kosovës.

Sipas këtij institucioni, vetëm në muajin korrik janë sulmuar 123 gra dhe vajza.

"Gjatë vitit 2016 janë evidentuar 1227 raste, gjatë vitit 2017 janë 1269 raste", thonë të dhënat e Policisë.

Rritje të rasteve të dhunës në familje ka konstatuar kohë më parë edhe Gjykata Themelore në Prishtinë. Sipas kryetares së kësaj gjykate, Afërdita Bytyqi, numri i rasteve është duke u rritur nga viti në vit. Megjithatë, kjo mund të jetë edhe rritje e vetëdijes për raportim.

"Statistikat e rasteve të dhunës në familje, ndër vite, në lëminë civile tregojnë se janë në rritje lëndët e kësaj natyre dhe kjo shihet edhe nga ky raport: gjatë vitit 2016 janë proceduar 122 raste me urdhër mbrojtje (dhunë në familje), gjatë vitit 2017 janë proceduar 148 raste me urdhër mbrojtje (dhunë në familje), dhe deri në gusht të vitit 2018 janë proceduar 78 raste me urdhër mbrojtje (dhunë në familje)".

Statistikat nuk janë aspak më pozitive as në vitin 2019.

"Koha për Gratë" ka kërkuar përgjigje nga Policia e Kosovës për statistikat në dy muajt e parë të vitit 2019. Për këtë periudhë është duke vazhduar trendi i njëjtë i dhunës ndaj grave.

"Në janar të këtij viti janë raportuar 130 raste te dhunës në familje, ndërsa në muajin shkurt janë raportuar 96 raste të dhunës", thuhet në përgjigjen e Policisë së Kosovës.

Pak drejtësi për gratë e abuzuara

Një grup burrash në pozita të ndryshme zyrtare janë prapa grilave për shkak se dyshohen të kenë abuzuar një vajzë kur ajo ishte në moshën 16 deri 18 vjeçare. E mitura nga Drenasi dyshohet se është abuzuar rreth dy vjet, fillimisht nga mësuesi. Kur kishte marrë guximin ta paraqiste në polici, dyshohet se për të kishte nisur një abuzim tjetër. Hetuesi i përfshirë në rast dyshohet se e ka riviktimizuar viktimën. Reagimi i Shoqërisë Civile ishte i ashpër. Në burg u gjendën dy burra të dyshuar se abuzuan me këtë vajzë kur ishte nxënëse e mitur. "Hero" i këtij skandali u konsiderua një avokat i cili e ndihmoi zbardhjen e këtij rasti. Por, "heroizmi" i tij zgjati vetëm disa javë. Hetimet e mëvonshme zbuluan dyshimet se edhe vetë avokati ishte një nga personat që dyshohet se kishte abuzuar me viktimën.

Përderisa hetimet në këtë rast po vazhdojnë, ka të tjera raste që dëshmojnë se drejtësia për gra është vonuar.

Në vitin 2011, Bislim Morina e martoi vajzën Antigonën me shkues (mësitni). Por, martesa e saj me Hilmi Zenën nga fshati Malësi e Vogël zgjati vetëm tri ditë. Sipas Prokurorisë, ajo vdiq si pasojë e gjakderdhjes që kishte pasur nga organet gjenitale mbrëmjen e parë të martesës, në shtëpinë e burrit të saj, ku kishte qëndruar mes datave 27, 28 dhe 29 korrik të vitit 2011.

Antigona vdiq 6 vjet më parë, tri ditë pasi u martua, për shkak të hemorragjisë së vazhdueshme, ndërsa burri i saj Hilmiu nuk i kishte ofruar ndihmë mjekësore. Për më keq, ai kishte vazhduar marrëdhëniet seksuale me të.

Gjykata, Prokurori, e të tjerë të përshirë në lirimin e Hilmi Zenës, që dyshohet se me mosveprimet e tij vrau bashkëshorten Antigona Morina, nuk kanë pranuar të marrin përgjegjësi për rastin deri kur KTV bëri disa raportime në lidhje me këtë çështje. Vetëm pasi rasti u bë publik, gjykata rinisi trajtimin e tij. Përfundimisht, bashkëshorti i Antigonës u dënua me dy vjet burg.

Zejnepe Bytyqi-Berisha është therur për vdekje nga bashkëshorti më 23 tetor 2015, pas disa viteve të të qenit e nënshtruar ndaj ushtrimit të dhunës në familje. Bashkëshorti i Zejnepës kishte histori të sjelljes kriminale dhe të ushtrimit të dhunës në familje. Në vitin 2002, ai ishte shpallur fajtor për vepër të dhunshme të kryer ndaj saj dhe i ishte shqiptuar dënim me burg me kusht për 6 muaj.

Në vitin 2008, në një incident të ndarë – jo lidhur me dhunën në familje, bashkëshorti i Zejnepës ishte dënuar me gjobë prej 300 eurosh për veprën penale – posedim i paautorizuar i armëve.

Më 2012, Zejnepja tentoi të vetëvritej. Policia hapi hetimet lidhur me tentim-vetëvrasjen për të vlerësuar se a ka pasur apo jo sjellje kriminale. Në deklaratat e atëhershme, Zejnepja kishte thënë se i kishte raportuar në polici incidentet e dhunës në familje, në shtatë apo tetë raste të ndara, të kryera nga bashkëshorti kundër saj dhe vajzës së tyre 11 vjeçare. Më tej, ajo kishte deklaruar se përgjatë viteve vazhdimisht i ishte nënshtruar dhunës fizike të kryer nga bashkëshorti dhe një ditë para tentim-vetëvrasjes ai kishte ushtruar dhunë fizike ndaj vajzës së tyre.

Vazhdon të jenë alarmant numri i kallëzimeve penale që kanë të bëjnë me rastet e dhunës në familje të cilat janë hedhur poshtë, ose janë refuzuar me aktgjykime.

Në vitin 2017, mbi gjysma e të gjitha kallëzimeve penale lidhur me rastet e dhunës në familje ishin hedhur poshtë (51.6 për qind).

"Gjatë vitit 2016, ka pasur 94 aktgjykime refuzuese, 62 në vitin 2017 dhe 20 në gjysmën e parë të vitit 2018", thuhet në të dhënat për mënyrën se si ka përfunduar trajtimi i këtyre rasteve në gjykatë.

Ky mbetet shqetësim për Shoqërinë Civile.

"Si rezultat i monitorimit sistematik të sistemit të drejtësisë, IKD vlerëson se praktika e deritanishme ka dëshmuar se qoftë Policia, Prokuroria dhe Gjykata, nuk i kanë marrë me seriozitetin e duhur rastet e dhunës në familje", ka thënë Betim Musliu.

Sipas tij, problem është koordinimi mes institucioneve të drejtësisë në këtë fushë.

"Për shkak të mungesës së bashkëpunimit dhe koordinimit reciprok mes këtyre institucioneve, jo rrallë rastet e dhunës në familje përfundojnë me fatalitet. Edhe kjo fushë, sikurse fushat tjera, vuajnë nga mungesa e zbatimit të legjislacionit dhe politikave në praktikë dhe mungon llogaridhënia në raport me zyrtarët që dështojnë t'i trajtojnë këto raste sipas ligjit".

Aktivistë dhe njohës të sistemit të drejtësisë shohin shumë probleme ligjore në mënyrën se si kategorizohen sanksionet për rastet e dhunës në familje.

Në raportin hulumtues të Rrjetit të Grave të Kosovës me të dhënat për vitet 2000-2017 të marra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Policia e Kosovës, janë 18.444 raste të dhunës në familje të raportuara në Kosovë. Prej tyre, vetëm 11.1 për qind të rasteve janë dënuar me burgim, gjersa shumica e kryesve të dhunës dënohen me kusht dhe dënim me gjobë. Edhe Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në Familje, aprovuar nga Qeveria e Kosovës (2016-2020), kërkon nga Objektivi Strategjik 3 rritjen e dënimeve për kryesit e dhunës në familje dhe ndryshimin e legjislacionit adekuat.

Gazetare kontribuuse:
Saranda Ramaj

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Nuk duam që paqja të bëhet për ne, por duam të jemi paqebërëse



Jeta Krasniqi

Është viti 1998. Është kohë kur heshtja shurdhon. Kohë frike e dhune. Mijëra gra me bukë në duar nisen në drejtim të Drenicës "Kemi bukë, jo armë, na lini të kalojmë!", "Bukë për fëmijët, për gratë dhe familjet e Drenicës", "Stop Gjenocidin!", janë mesazhet që ato bartin. Mobilizim i fuqishëm i grave që synon të tërheq vëmendjen ndërkombëtare mbi katastrofën njerëzore që po ndodh në Kosovë nga regjimi serb kundër njerëzve të pafajshëm, faji i vetëm i të cilëve është se janë shqiptarë

Ky është vetëm një ndër momentet ikonike të mobilizimit të grave në Kosovë, të cilat dhanë kontributin e tyre, u sakrifikuan, gjetën forcën për t'u ringritur si feniksi nga pluhuri për të mirën e shoqërisë në të cilën ne jetojmë sot.

Me ish-Presidenten Atifete Jahjaga, si këshilltare e saj, kishim përfshirë këtë moment të fuqishëm të historisë sonë në fjalimin e saj në TEDxAmsterdamWomen. Në një adresim ku historia e Kosovës u nda nëpërmjet rrëfimeve të grave të shtetit tonë. Ishte ndër herët e para që Kosova vinte para një audience ndërkombëtare në këtë mënyrë. Gratë e Kosovës në çdo kohë kanë qenë katalizatore, mbështetëse, shtylla dhe fuqi prapa proceseve nëpër të cilat kaluam si shoqëri. Padyshim, edhe viktima të po këtyre proceseve.

Sikur të tentonim të shihnin më shpesh historinë e vendit tonë nga kjo perspektivë e cila përfshin eksperiencat si të burrave ashtu edhe të grave, do të kuptonim çfarë vlerash kemi dhe çfarë pasurie zotërojmë si shoqëri. Por mbi të gjitha, pjesëmarrja e grave në secilin proces do të vinte në mënyrë natyrale pa nevojën e përdorimit të kuotave gjinore.

Për fat të keq, këtë e bëjmë shumë rrallë. Në narrativin e Kosovës, roli i grave është rrëfim i munguar. Rrëfimet e grave si Luljeta Pula, Sevdije Ahmeti, Edi Shukriu, Flora Brovina, Afërdita Saraçini - Kelmendi, Safete dhe Igballe Rogova, Edita Tahiri, Vjosa Dobruna, Shukrije Gashi, e shumë e shumë grave të tjera.

Në vitin 2003, gratë e Liberisë, myslimane dhe katolike nga të gjitha shtresat e shoqërisë, iniciuan një lëvizje të paqes të njohur si Gratë e Veprimit Masiv të Liberisë për Paqe, duke u bërë forcë politike kundër dhunës dhe qeverisë së tyre. Kjo lëvizje e detyroi Presidentin e Liberisë, Charles Taylor, të negocionte me forcat rebele në Ganë. Dyqind gra të veshura në të bardha udhëtuan në Ganë për ta vazhduar presionin. Rrethuan dhomën duke bllokuar çdo dalje, duke mos i lejuar palët të tërhiqeshin nga bisedimet pa arritur një marrëveshje. Mobilizimi i tyre solli deri te një marrëveshje në një kohë kur bisedimet për paqe ishin ndalur. Krijoi paqe pas 14 vitesh të luftës civile, duke sjellë në pushtet edhe Presidenten Ellen Johnson Sirleaf, e cila shtyu përpara ndryshime në qeverisjen e këtij vendi dhe në vet trajtimin e grave dhe rolin e tyre në shoqërinë e pasluftës.

Po në Kosovë, ku gratë luajtën rol të rëndësishëm gjatë viteve të rezistencës dhe të luftës, pse nuk u lejuan të jenë pjesë e pandashme edhe e paqebërjes dhe e shtetndërtimit? Pse u tentua që gratë të lihen anash këtyre proceseve dhe kontributi i tyre të mos njihet?

Në 2011, Kosova filloi një tjetër proces negociatash me Serbinë, pas dy cikle negociatash të zhvilluara në të kaluarën, rezultatet e të cilave nuk ishin pranuar nga Serbia - bisedimet e Rambujesë në vitin 1999, ku rol qenësor kishte luajtur një grua e fuqishme, Sekretarja e atëhershme e SHBA-ve, Madeleine Albright, dhe bisedimet e Vjenës në 2006, ku u diskutua mbi statusin final të Kosovës. Bisedime këto të cilat i vendosën themelet e shtetit të Kosovës dhe të shoqërisë së të gjithë qytetarëve pa diskriminim gjinor. Procese të cilat e gjetën Edita Tahirin, njërën nga organizatoret e Marshit drejt Drenicës, krah burrave të Kosovës.

Pak dihet për gratë që ishin pjesë e këtyre delegacioneve dhe u përfshinë në këto procese, qoftë drejtpërdrejt apo indirekt. Rrëfimi i ndërtuar mbi këto dy procese negociatash nuk është tentuar asnjëherë të nxjerrë në pah rolin e tyre dhe kontributin e çmuar që dhanë. Roli i grave është një rrëfim i munguar në historinë tonë të paqebërjes.

Në dialogun Kosovë-Serbi, të filluar më 2011, nuk u veprua më ndryshe. Pavarësisht përfshirjes së Edita Tahirit që mbante në supe eksperiencë të çmuar, ky proces më 2012 u bë politik dhe la jashtë perspektivën gjinore. Kjo u reflektua në vet temat që u negociuan dhe për të cilat u arritën marrëveshje në mes palëve.

Tash kur po diskutojmë rreth fazës përmbyllëse të dialogut dhe arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ligjërisht të obligueshme, Kuvendi i Kosovës e ka votuar një delegacion shtetëror prej 12 anëtarësh. Negociatat e partive politike u zhvilluan për përfshirjen e komuniteteve joshumicë, atij boshnjak dhe turk, në këmbim të votave të nevojshme për mbështetje të Rezolutës në Kuvend. Por, nuk kishte asnjë angazhim për garantim të përfaqësimit gjinor. As gratë e partive politike nuk u mobilizuan. Siç nuk u mobilizua as Grupi i Grave Deputete, kur dihej shumë mirë që burrat e partive as që e kishin në agjendë këtë element të përfaqësimit. Dhe neve si shoqëri na mungoi reagimi i fuqishëm.

Edhe dokumentet e nxjerra nga ky delegacion, siç është Platforma për Dialogun, flasin për gjithëpërfshirje, ndërsa vet delegacioni në përbërjen e tij nuk garanton përfaqësim gjinor. Projektligji për Delegacionin Shtetëror në asnjë pikë të tij nuk reflekton frymën e Kushtetutës e cila e konsideron barazinë gjinore si vlerë themelore për shoqëri demokratike, as nuk e reflekton frymën e Ligjit për Barazi Gjinore, por as edhe minimumin e kuotës gjinore prej 30 për qind. Duke e kundërshtuar vet nocionin e gjithëpërfshirjes.

Ndërsa duhet mirëpritur që Platforma e ka integruar parimin mbi drejtësinë për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, ku flitet në mënyrë të përgjithshme për kërkesat për drejtësi, rehabilitim dhe dëmshpërblim. Mbetet të shihet, në fakt, se sa do të reflektohet kjo në marrëveshjen eventuale në mes palëve, apo do të mbetet një element formal vetëm në letër.

Kosovës iu deshtën gati 18 vjet për ta filluar procesin e njohjes së statusit të personave të dhunuar gjatë luftës në Kosovë. Pavarësisht numrit të tyre, e rëndësishme mbetet që të zyrtarizohet se dhuna seksuale u përdor si mjet lufte në shumicën e rasteve ndaj grave e vajzave të reja të Kosovës. Andaj, kjo çështje duhet të trajtohet me seriozitet të lartë, siç duhet të trajtohet edhe kërkimfalja, parim i cili nuk është pjesë e Platformës së Dialogut. Një element ky shumë i rëndësishëm për të gjitha ato gra që përjetuan dhunë seksuale dhe shumë gra të tjera që humbën fëmijët e tyre, më të dashurit e tyre, për shumë ëndrra të mbetura përgjysmë, e jetë të parealizuara.

Sikur gratë në Kosovë të ngriheshin tani dhe të kërkonin që edhe ato të jenë të pjesë e tavolinës vendimmarrëse në këtë proces, jo pak njerëz do të reagonin duke thënë se nuk është koha për këto kërkesa. Kemi probleme më të mëdha. Skena politike është e fragmentarizuar, po flasim për çështje të territorit. Nuk kemi kohë për "të humbur" me çështje të tilla. Duke harruar faktin e pakontestueshëm që përgjegjësitë ndaj këtij shtetit na takojnë të gjithëve. Siç na ndikojnë të gjithëve vendimet të cilat mund të merren në këtë proces të dialogut, si qytetarë të barabartë të shtetit.

Natyrshëm vjen pyetja: Si duam ta ndërtojmë shtetin tonë? Të ardhmen e tij?

Kjo është, besoj, pyetja esenciale që secili qytetar i shtetit të Kosovës duhet t'ia bëjë vetes. Shtet i cili u bë falë përpjekjeve të burrave dhe grave të këtij vendi.

Në Kolumbi, në 2012 filluan negociatat në mes Qeverisë dhe FARK-ut, ku vetëm një grua ishte pjesë e tyre. Gratë aktiviste u mobilizuan, organizuan Samitin e Grave dhe Paqes, dhe artikuluan kërkesat e tyre të qarta ndaj këtij procesi. Gratë luajtën rol qenësor në këtë proces të paqes, me përfshirje direkte të tyre. Më 2016, Marrëveshja gjithëpërfshirëse e paqes u arrit, duke u bërë shembull në mbarë botën për përfshirjen e perspektivës gjinore dhe të vet grave në këtë proces.

Marina Gallego, koordinatorja e organizatave të grave në Kolumbi, ishte shprehur: "Nuk duam që paqja të bëhet për ne, por duam të jemi paqebërëse".

Ka ardhur koha që edhe gratë e Kosovës të mobilizohen e t'i bëjnë të qarta qëndrimet e tyre për këtë proces të dialogut me Serbinë. Të kërkojnë që të jenë pjesë e tavolinës vendimmarrëse dhe përcaktuese të rrjedhës së historisë së shtetit tonë.

Ka ardhur koha që të mos lejojmë më që historia jonë të ndërtohet duke lënë anash gratë.

Autorja është Menaxhere e Projektit në Institutin Demokratik të Kosovës

Disa fjalë për dhunën ndaj grave dhe vajzave në Kosovë

Adelina Berisha

"Ra ky mort e u pamë", dhe po bien shumë morte e ne po e kuptojmë se ku qëndrojmë si shoqëri në mbrojtjen e grave dhe vajzave nga dhuna. E sidomos këta muaj në media na dolën raste të dhunës ndaj grave dhe vajzave të cilat na e përplasën fytyrës realitetin. Realitet të cilin, ne si shoqëri, refuzojmë me çdo kusht ta pranojmë.

Ne jemi shoqëri patriarkale.

Neve na duhet kohë të dalim nga këto norma që po na ngulfasin përditë. Një rast ndodhi në Drenas, u tronditëm të tërë. Disa nga mllefi e nga tronditja, e disa nga frika se si do flasin për ne, me frikën se po na "humb morali". E për hir të moralit, është më lehtë t'i vihet faji një njeriu sesa një sistemi të tërë patriarkal!

"Ato janë të poshtra, e kanë merituar, pse s'i ndodhi dikujt tjetër? Të pamoralshme!", janë disa prej mbiemrave që iu vishen grave dhe vajzave që janë viktima të dhunës seksuale, apo të cilësdo forme tjetër të dhunës. Mbiemra të ngjashëm u vihen edhe atyre që bëhen zëri i viktimave. Gratë duhet të heshtin. Kjo është kërkesa që po iu bëhet grave dhe vajzave përditë në këtë shoqëri.

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave e përkufizon dhunën me baza gjinore si "dhunë e cila është e drejtuar kundër grave për shkak se ato janë gra, ose ngaqë kjo ndikon mbi gratë". Të dhënat nga Policia e Kosovës na tregojnë se në mbi 80 për qind të rasteve të dhunës në familje viktima janë gratë. Viktima të abuzimit seksual, të dhunimeve, tentim-dhunimeve, në të shumtën e rasteve po ashtu janë gratë dhe vajzat. Botërisht, çdo e treta grua ka përjetuar dhunë fizike apo seksuale nga partnerët intimë, apo dhunë seksuale nga jo-partnerët, thotë Organizata Botërore e Shëndetësisë. Këta janë vetëm disa shembuj të asaj që gratë në Kosovë e përjetojnë çdo ditë.

Kushtetuta e Kosovës e ka të adaptuar Konventën e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, apo siç njihet - Konventa e Stambollit, që është gjithashtu një dokument i cili kërkon mbrojtje, parandalim, hetim dhe eliminim të të gjitha formave të dhunës ndaj grave. Konventa ka për qëllim të eliminohen të gjitha format e diskriminimit ndaj grave dhe të promovohet barazia mes burrave dhe grave, si dhe krijimin e mekanizmave ligjorë me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes sa më të mirë për gjitha viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe zbatuesit e ligjit me qëllim të një bashkëpunimi sa më të mirë, në ofrim të përkrahjes për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, është po ashtu një prej qëllimeve të kësaj konvente. Muaj më parë, deputetja Aida Dërguti kishte iniciuar kërkesën për amendamentim të Kushtetutës duke kërkuar shtimin e një paragrafi të ri, pas paragrafit 8 të nenit 22, Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare të Kushtetutës, respektivisht të shtohet edhe paragrafi 9: "Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje".

Në vitin 2010, Kosova ka miratuar Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, të përcjellë me hartimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, ndërsa deri tani ka hartuar dy strategji dhe plane veprimi për mbrojtje nga dhuna në familje. Strategjia e fundit vlen për periudhën 2016-2020.

Nga janari i këtij viti, dhuna në familje dhe ngacmimi seksual janë definuar si vepra penale në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, kjo falë angazhimit të disa organizatave të grave (RRGK, QKSGJ, etj.). Edhe pse janë ndërmarrë të gjitha këto veprime për ta kriminalizuar dhunën në familje dhe ngacmimet seksuale, hulumtimi i Rrjetit të Grave të Kosovës, i vitit 2015, tregon se 68 për qind e grave dhe vajzave kanë përjetuar dhunë në familje gjatë tërë jetës së tyre, 41 për qind vetëm në vitin paraprak (2014). Ngjashëm, 64.1 për qind e grave dhe vajzave kanë deklaruar se kanë përjetuar ngacmim seksual gjatë tërë jetës së tyre.

Në anën tjetër, dhuna ndaj grave dhe vajzave vazhdon të mbetet një prej formave më pak të ndëshkueshme.

Një raport i KIPRED i vitit 2018, tregon se në vitin 2017, 51.5 për qind e kallëzimeve penale të ndërlidhura me rastet e dhunës në familje janë hedhur poshtë. Hulumtime të ndryshme kanë gjetur ngjashëm se mungesa e njohurive mbi dhunën në baza gjinore,ka ndikuar në mosndëshkueshmërinë e këtyre krimeve. Tendenca e pajtimit të familjeve me qëllim të ruajtjes së "shenjtërisë së familjes" edhe në rastet kur ka vepër penale (kërcënime me armë, kanosje, lëndime të rënda trupore, etj.), si dhe fajësimi i viktimës, kanë ndikuar në mosndëshkueshmërinë e krimeve të ndërlidhura me dhunën ndaj grave dhe vajzave - janë gjetje të përbashkëta të shumë raporteve hulumtuese.

Mediat do të vazhdojnë të raportojnë edhe për shumë raste të dhunës ndaj grave dhe vajzave, të dhunës së burrit ndaj gruas; vrasjeve të grave me sëpatë nga burrat e tyre, vrasjet e vajzave me armë nga babai, me thikë nga djali; abuzimet seksuale të të miturave nga mësues, zyrtarë, avokatë; ngacmime seksuale; diskriminim në punë, në familje, diskriminim nga shoqëria i grave dhe vajzave. Skenari më i mundshëm është se ne do të shokohemi, do të flasim dy a tri ditë, e pastaj do t'i kthehemi "rrënjëve".

"Ato janë të poshtra!", "E kanë merituar!", "Pse s'i ndodhi dikujt tjetër?", "Të pamoralshme!".

Ose, mund ta ndryshojmë këtë skenar të prapambetur duke zgjedhur të bëhemi zëri i viktimave të dhunës në familje, abuzimeve seksuale, përdhunimeve, ngacmimeve seksuale. Ky zë është ai që i nevojitet çdo gruaje apo vajze që sot është duke vuajtur nga dhuna. E kemi borxh t'i ndryshojmë këto norma të prapambetura dhe patriarkale, në të kundërtën, gjeneratat e reja, do të na urrejnë për vendin që po iu trashëgojmë.

Nëse jo sot, nesër do kemi nevojë që dikush të bëhet zëri ynë.

Kush do jetë ai që?

Autorja është Koordinatore për Avokim në Rrjetin e Grave të Kosovës

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Gratë kosovare në energji

Petrit Selimi

Në shkrimin e vitit të kaluar në këtë shtojcë (Koha për Gratë, 2018), kam thënë se "pa përfshirje të barabartë të grave nuk ka ekonomi funksionale" dhe kam treguar sa të angazhuar jemi ne si FMK të punojmë së bashku në fuqizimin e gruas në sektorin e energjisë.

Gjatë tërë vitit jemi marrë me analizën reale të situatës së përfshirjes së gruas në sektorin e energjisë. Po, është e vërtetë se ky sektor ku priten investimet më të mëdha të pasluftës është sektor i dominuar nga burrat, por tash jemi të lumtur që do të bisedojmë edhe për disa projekte konkrete dhe masa që duhet t'i ndërmarrim që gratë të jenë pjesë e tij.

Është me rëndësi se në përpjekjen për të adresuar përfshirjen e grave në sektorin e energjisë tashmë kemi disa rrëfime fantastike të grave të angazhuara në këtë industri. Një prodhues kosovar i paneleve solare ka staf me mbi 50 për qind gra. Në termocentralin tonë është një teknologe 25 vjeçare, e cila me kompetencë të plotë merr vendime në ciklin prodhues të rrymës. Fushata jonë "Gratë në Energji" është e bazuar në fytyra të njohura lidere të sektorit të energjisë, si znj. Pranvera Dobruna, znj. Fllanza Hoxha, apo znj. Arjeta Pajaziti. Ato e kanë rrahur rrugën sfiduese ashtu që gjeneratat e tjera të kenë më lehtë.

Vendosmëria për të qenë pjesë e sektorit dhe arsimimi i mirë në fushën e energjisë ishin dy elemente të përbashkëta ndërmjet grave që tashmë punojnë në energji. Për këtë arsye, ne si MFK, ndër tjerash, kemi përfshirë tri programe përkrahëse: punë praktike për rreth 200 vajza në fushën e energjisë; bursa për energjinë në institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë për rreth 25 vajza kosovare, si dhe grante për bizneset me gra pronare që investojnë në fushën e energjisë.

Qëllimi i programit të bursave është ofrimi i mundësive për vajzat kosovare të studiojnë në fushën e energjisë në kolegje dhe universitete ndërkombëtare dhe aplikimi i këtyre njohurive në fushën e energjisë në Kosovë. Fushat e studimit i kemi caktuar pasi është bërë analiza e kërkesës së tregut për fuqinë punëtore në fushën e energjisë. Pra, kemi caktuar si prioritet fushat e energjisë për të cilat ka kërkesë dhe mangësi në treg në mënyrë që bursistet tona ta kenë më të lehtë punësimin e tyre në këtë sektor pasi të kthehen në Kosovë.

Me 20 shkurt kemi hapur thirrjen për aplikim për bursat e para për studime në Amerikë dhe aplikacioni është i hapur deri më 7 prill 2019. Grupi i parë i grave përfituese të bursave do të përzgjidhet në maj. Ato do të jetojnë dhe studiojnë në Des Moines Area Community College (DMACC) për dy vjet, duke filluar nga vjeshta e këtij viti. MFK ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me DMACC për sponsorizimin, menaxhimin dhe mbështetjen e vajzave kosovare për këto dy vjet për studime në fushën e energjisë. Kurset në të cilat këto vajza do të marrin ekspertizë janë në energji të ripërtërishme, softuerë të aplikueshëm në fushën e energjisë, prodhimtari të energjisë dhe aftësim profesional të ndërlidhur me fushat e energjisë. Diplomat që do t'i marrin vajzat në DMACC janë diploma dyvjeçare të cilat do ta mundësojnë specializimin e tyre në fushat e përzgjedhura të energjisë.

Për vitin e ardhshëm do të rrisim bashkëpunimin me institucione tjera ndërkombëtare të arsimit të lartë të cilat ofrojnë kurse dhe diploma një ose dyvjeçare në fushën e energjisë. Planifikojmë të kemi bashkëpunim me të paktën 5 universitete dhe kolegje në Evropë dhe Amerikë, prandaj rrjedhimisht kohorta e dytë e vajzave të përzgjedhura gjatë vitit 2020 do të bëhet pjesë e këtyre universiteteve.

Pas përfundimit të studimeve, bursistet kosovare do të punojnë në sektorin e energjisë së Kosovës për të paktën 1 vit, në mënyrë që ta japin kontributin e tyre në këtë sferë. Si rezultat, këto vajza do të jenë lidere dhe inspiruese për vajzat tjera kosovare që synojnë të njëjtën karrierë dhe janë në nevojë të një shtytjeje.

Sektori i energjisë është sektori me më së shumti investime të huaja, por me më së paku pjesëmarrje të grave. MFK synon përfshirjen dhe fuqizimin e grave kosovare që të mund t'i shfrytëzojnë dhe rrisin këto investime.

Andaj, ne si MFK i inkurajojmë të gjitha vajzat dhe gratë kosovare që dëshirojnë të thyejnë stereotipin që "gratë s'duhet me u përzi në energji" dhe të investojnë në të ardhmen e tyre, të aplikojnë për programin tonë të bursave dhe të punëve praktike në sektorin e energjisë së Kosovës.

Autori është Udhëheqës i i Fondacionit të Mileniumit të Kosovës

Aktivizmi i grave për të trashëguar pronë

Driton Zeqiri

Në diskursin publik të shoqërive në tranzicion, përfshirë këtu edhe Kosovën, në të shumtën e rasteve traditës i referohen si një tërësi praktikash shoqërore statike, të pandryshueshme. Një diskurs i tillë dominon edhe në komunikimin publik mbi të drejtën e grave për të trashëguar.

Studimet sociologjike dhe antropologjike dëshmojnë se ky interpretim i praktikave tradicionale është joshkencor, sepse praktikat tradicionale në vazhdimësi i nënshtrohen procesit të ndryshimit, përmes reinterpretimit. Praktikat tradicionale memorizohen dhe barten nga një gjeneratë tek tjetra përmes procesit të socializimit, duke pasur si qëllim primar stabilitetin social. Në procesin e bartjes së praktikës tradicionale nga një gjeneratë në tjetrën zakonisht shfaqen dy tendenca kundërthënëse brenda shoqërisë: tendenca e disa individëve dhe grupeve për ruajtjen ose konservimin e plotë të praktikave tradicionale dhe tendenca e disa individëve dhe grupeve që praktikat e mëhershme të braktisen dhe zëvendësohen me praktika të reja. Rritja e kontradiktave mbi një praktikë ose zakon shoqëror përbën në vete procesin e ndryshimit. Në procesin e braktisjes së një tradite siç është ajo e trashëgimisë në linjë patrilineale, ka shumë mundësi që grupe të caktuara të aktivizohen për të parandaluar ndryshimin, duke përdorur edhe mjete si ato të komunikimit masiv. Prandaj, qytetarët duhet të informohen se një diskurs publik ku ky zakon (trashëgimia në linjë patrilineale) paraqitet si i pandryshuar është një diskurs i fabrikuar.

Përmes Programit për të Drejtat Pronësore, USAID-i në Kosovë përgjatë viteve 2015–2019 ka realizuar tri hulumtime në nivel nacional për të mbledhur të dhëna drejtpërdrejt nga qytetarët për qëndrimet, njohuritë dhe praktikat e tyre rreth të drejtave pronësore, si dhe për të matur ndikim e Programit të USAID-it për të Drejtat Pronësore. Mesazhet e dërguara nga ky Program përmes fushatës për ndryshim të sjelljeve shoqërore me qëllim të promovimit të barazisë në të drejtat pronësore kanë arritur tek 87 për qind e popullatës.

Përmes kësaj fushate është arritur që njohuritë e qytetarëve për të drejtat pronësore të rriten nga 27 për qind sa ishin në vitin 2015, në 53 për qind në vitin 2019; ndërsa përqindja e atyre që i përkrahin të drejtat e grave për të trashëguar është rritur nga 64 për qind në vitin 2015, në 77 për qind në vitin 2019. Është konstatuar një ndërlidhje pozitive midis rritjes së njohurive, ndryshimit të qëndrimeve dhe ndryshimit të praktikave. Përkrahja e të drejtës së grave në trashëgimi dhe rritja e njohurive ka krijuar një terren social të përshtatshëm për ndryshimin e praktikave.

Rezultatet tregojnë se mesazhet e dërguar nga Programi i USAID-it për të Drejtat Pronësore kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në aktivizmin e grave për t'i realizuar të drejtat e tyre në trashëgimi. Aktivizmi i grave është rritur dukshëm gjatë fushatës, ku nga vetëm 0.3 për qind e grave që kishin iniciuar procesin e trashëgimisë në 2015, në vitin 2019 kjo përqindje është rritur në 14 për qind.

Me ndryshimet ligjore të bëra në vitet e fundit, me rritjen e efikasitetit të gjykatave në trajtimin e lëndëve pronësore dhe me ngritjen e performancës të zyrave komunale për kadastër, është bërë e mundur që numri i grave që trashëgojnë pronë të rritet nga 3.8 për qind sa ishte në vitin 2015, në 13.8 për qind në vitin 2019. Hulumtimet po ashtu japin indikacione se numri i grave që do të trashëgojnë pronë do të rritet me një ritëm të shpejtuar në vitet në vijim, nëse shteti merr iniciativa në nxitjen e qytetarëve për formalizimin e të drejtave pronësore dhe lehtësimin e procedurave.

Dhe së fundi, braktisja e zakonit të trashëgimit vetëm nga burrat është një proces i pashmangshëm për çdo shoqëri që synon zhvillimin, rritjen ekonomike dhe përvetësimin e kulturës së demokracisë. Nuk duhet të ketë asnjë dilemë tek qytetarët se tanimë zakoni i bartjes së trashëgimisë vetëm tek burrat është një zakon që ka humbur popullaritetin dhe funksionin që mund të ketë pasur në të kaluarën. Çfarëdo përpjekje për ruajtjen e një zakoni të tillë, në kontekstin e sotëm social, shpie te fenomeni i njohur si "ndërgjegje e dyfishtë", që nënkupton se një individ, grup apo popull ka besime dhe qëndrime që janë kontradiktore mes vete. Prandaj, përpjekja e ciliitdo individ apo grup për të ruajtur këtë zakon duhet të shihet si një përpjekje e izoluar dhe nuk duhet të mbraps asnjë grua që të kërkojë të drejtën e saj në pronë dhe trashëgimi. E drejta në pronë është e drejtë e njeriut dhe nuk mund të mohohet nga shteti, shoqëria, komuniteti, apo familja.

Autori është Specialist për Monitorim dhe Vlerësim tek Programi i USAID-it për të Drejtat Pronësore

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Në kërkim të ekuilibrit punë-jetë

Errësira e cila e kishte mbuluar dhomën filloi të largohej, teksa dielli po i lëshonte rrezet e tij të para.

Fiks në orën 06:00, alarmi e zgjon nga gjumi Arjeta B. Pa bërë shumë zhurmë, i merr gjësendet e saja dhe del në dhomën tjetër. Bëhet gati me nxitim dhe për më pak se një orë e zgjon nga gjumi edhe vajzën e saj dyvjeçare. E ushqen dhe e vesh. Para se ta marrë rrugën për në punë, Arjeta e dërgon fillimisht vajzën në çerdhe. Një çerek para orës 08:00, ajo arrin në marketin që punon 6 ditë në javë, nga 8 orë në ditë, ndonjëherë edhe më shumë. Këtë punë e kishte filluar sa ishte në studime në Fakultetin Juridik. Megjithatë, edhe pas përfundimit të studimeve, ajo nuk kishte arritur të gjente punë në profesionin e saj. Por, Arjeta ka vendosur që në vend se të presë, të vazhdojë punën aty ku kishte filluar në 2014.

Punën nuk e ka lënë as pas krijimit të familjes. Të qenit nënë për Arjetën ka qenë mjaft sfiduese. Përveç punës, asaj i është shtuar edhe përgjegjësia për vajzën, edhe pse thotë se për këtë e ndihmon edhe bashkëshorti. “Isha në mes të dy zgjidhjeve, ta lija punën dhe të bëhesha amvise, të bëja gjithë ditën punë që nuk paguhen e që për dikë nuk janë asgjë, ose të vendosja që ta vazhdoja punën dhe ta rrisja vajzën njëkohësisht”.

Por, balancimi i punës dhe jetës për të është mjaft i vështirë. “Vajza është ende e vogël. Angazhimet në punë janë të shumta. Shpeshherë punoj edhe pas orarit të punës, e dikush nga familja duhet ta marrë vajzën nga çerdhja”. Për punën që e bën thotë se nuk paguhet sa duhet. Madje, thekson se ka dallime edhe në mes të kolegëve. Sipas saj, burrat paguhen më shumë edhe pse bëjnë punën e njëjtë. “Në listën e pagave që kemi nënshkruar dhe bisedat me kolegë e kam vërejtur se disa paguhen më shumë, sidomos burrat. Edhe pse kam kërkuar sqarim për këtë, më është thënë se ata punojnë më shumë”. Asaj nuk i paguhet as orët shtesë.

Arjeta bën pjesë në numrin e vogël të grave që punojnë në Kosovë, numër ky që vazhdon të jetë ndër më të ulëtit në Europë. Me gjithë numrin e vogël, gratë në Kosovë vazhdojnë të diskriminohen në punësim karshi burrave.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, nga 29.1 për qind e të punësuarve në Kosovë, vetëm 12.8 për qind janë femra, ndërsa 45.6 për qind janë meshkuj. Për nivelin e ultë të punësimit të grave dhe fuqisë punëtore në Kosovë, Agjencia Inovative Amerikane (MCC) ka bërë një analizë të fuqisë punëtore. Hulumtimet e saj tregojnë se burrat në krahasim me gratë kanë dyfish më shumë mundësi për të gjetur punë. Ky raport vë në pah vështirësitë dhe barrierat me të cilat ballafaqohen gratë kosovare për të gjetur një punë. Edhe pse të dhënat e shkollimit tregojnë se numri i vajzave që vazhdojnë shkollimin në universitet është më i madh se sa i djemve, punësimi për burrat është dukshëm më i lehtë se për gratë. Statistikat vendore dhe ato ndërkombëtare flasin për një diskriminim të theksuar të punësimit të grave në relacion me burrat në Kosovë.

Sipas MCC-së, në të gjithë treguesit e tregut të punës pjesëmarrja e grave është shumë më e ulët se sa ajo e burrave. Raporti tregon se gratë kanë përgjysmë mundësi për t’u punësuar, ndërsa dy herë më shumë kanë gjasa për të qenë joaktive në treg. “Një e katërta e grave janë sipërmarrëse, ndërsa pjesa më e madhe janë punëtore familjare të papaguara, dhe sipas të dhënave, ato investojnë pothuajse pesë orë më shumë në ditë për kujdes ndaj familjes se sa burrat”.

Valza Zogjani, politologe e cila është menaxhere e projektit në Institutin Demokratik për Zhvillim (D4D), thotë se Kosova radhitet ndër shtetet me joaktivitetin më të lartë të grave në tregun e punës në nivel europian. “Në kontekstin e sektorëve të punësimit, ekziston ndarje gjinore e profesioneve: gratë janë kryesisht të punësuara në sektorin e arsimit, tregtisë (kryesisht në aktivitete të shitjes), kujdesit shëndetësor dhe punës sociale (48.4 për qind të grave të punësuara). Përderisa më shumë se gjysma (54.5 për qind) e grave janë të punësuara në sektorë të cilët tradicionalisht konsiderohen si profesione të dominuara nga gratë, kjo tregon që ende është sfidë thyerja e barrierave dhe stereotipeve gjinore rreth profileve të punësimit”.

Niveli i ulët i punësimit të grave mbetet problem ndër vite. Edhe më shqetësuese mbetet pjesëmarrja e tyre e ulët në tregun e punës. Të dhënat e fundit tregojnë se vetëm 20 për qind e grave kërkojnë punë. Kjo shifër ka qenë për 15 për qind më e lartë në vitin 2002.

Për Dita Dobranjën nga Instituti Riinvest, pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore është tejet e ulët. “Edhe për ato gra që janë aktive në tregun e punës, niveli i papunësisë është më i lartë se për burrat. Roli i sigurisë në punë ka bërë që gratë të kenë tendencë të preferojnë sektorin publik në vend të atij privat. Sa u përket sektorëve specifikë, gratë janë të përfaqësuara më shumë në bujqësi dhe shërbime tregtare”.

Burrat paguhen më shumë se gratë

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Millennium Challenge Corporation (MCC), del se në shumicën e sektorëve gratë paguhen dukshëm më pak sesa burrat. Sipas Dobranjës, në përgjithësi në Kosovë gratë paguhen 0.70-0.81 centë për 1 euro që paguhen burrat. “Një pjesë e këtij hendeku në paga shpjegohet me faktin që burrat janë më lart nëpër pozita, ku pozita ndikon që të kenë rrogë më të madhe. Mirëpo, edhe kur i eliminojmë diferencat në arsim gratë paguhen më pak se burrat, edhe pse ky hendek në paga ngushtohet në nivelet më të larta të arsimit”.

Arsimi vazhdon të jetë sektorët e mbipërfaqësuar nga gratë në Kosovë. Orari më i shkurtër krijon përparësi që të bëjnë një balancim më të mirë mes familjes dhe punës, pasi gratë kosovare vazhdojnë ta ndjejnë përgjegjësinë e të qenit prindër më shumë se burrat.

Mësimdhënësja Hasime Mehmeti, nënë e dy fëmijëve, tregon se edhe pse ka vetëm 5 orë punë i duhen së paku edhe 3 orë tjera për t’u përgatitur për orët që mban para nxënësve. Përkundër angazhimeve të shumta në punë, ajo thotë se mundohet ta mbajë një ekuilibër në mes të punës dhe familjes në mënyrë që t’i kushtojë më shumë kohë fëmijëve të saj.

“Bashkëshorti im punon çdo ditë nga 10 orë, barra më e madhe që të merrem me fëmijë më takon mua. Bashkëshorti merret më shumë me fëmijë gjatë vikendit. Por, shkaku i këtyre angazhimeve shumë pak kemi kohë për relaksim për vete gjatë ditës”. Sa i përket pagës, Mehmeti thotë se në arsim nuk ka diferencë në paga mes profesorëve burra dhe gra, pasi arsimi njihet për numër më të madh të grave të punësuara.

Megjithatë, në raportin e MCC-së që ka të bëjë me gjendjen ekonomike të kosovarëve, totali i pagës mesatare mujore në Kosovë është 340 euro, me një mesatare prej 353 euro për burrat dhe 289 euro për gratë.

Diferenca mes pagës mesatare të burrave dhe grave që kanë të përfunduar vetëm shkollën fillore është 202 euro - 277 euro për burrat, ndërsa 175 për gratë. Paga mesatare e grave që kanë mbaruar shkollën e mesme të lartë është 267 euro, 80 euro më pak sesa paguhen mesatarisht burrat me të njëjtin shkollim (347 euro).

Të dhënat tregojnë se gratë që kanë kryer shkollimin universitar paguhen mesatarisht 377 euro në muaj, ndërsa burrat me të njëjtin shkollim marrin mesatarisht 434 euro pagë mujore. Ndërsa gratë që kanë të përfunduar magjistraturën paguhen 36 euro më pak se burrat, sepse burrat paguhen mesatarisht 504 euro, kurse gratë 468 euro.

Dallimi thellohet edhe më tej mes pagës mesatare të burrave dhe grave pas studimeve të doktoraturës. Gratë paguhen mesatarisht 376 euro më pak se burrat. Paga mesatare e burrave me këtë nivel shkollimi është 1057 euro, ndërsa për gratë është 681 euro.

Hendeku gjinor i pagave është parë si shqetësim edhe nga Organizata Botërore e Punës (ILO). Në raportin e saj të fundit, ajo tregon se në Shqipëri hendeku gjinor i pagave është 32 për qind. Pabarazia në paga është shumë e vogël në vendet skandinave, si Suedia, Norvegjia dhe Finlanda, pastaj Belgjika, etj. Ndërsa niveli i pabarazisë është tejet i lartë në Afrikën Jugore, Nambi dhe Brazil.

Vendet skandinave njihen si vendet me ekuilibrin më të mirë mes jetës personale dhe asaj private. Në hulumtimin e Totally-Money, i cili ka analizuar se cilat vende europiane ofrojnë kohën më të madhe të lirë në mënyrë që qytetarët e tyre të jenë të lumtur dhe minimumin e orëve të punës (me kusht që ata të jenë produktivë), Danimarka ka balancën më të mirë mes pagës mesatare dhe kostos së jetesës, kohës së argëtimit (15,9 orë) dhe orëve të punës (32.9 orë).

Suedia mban të njëjtën renditje me Danimarkën, por e ka më të lartë nivelin e kohës mesatare të punës në javë – 3.5 orë. Gjithashtu ka edhe tri ditë pushimi zyrtar më shumë në një vit. Vendi me më pak orë pune në javë është Holanda (30.3 orë pune në javë), me nëntë ditë pushimi zyrtar në vit.

Sa u përket orëve të punës, Dita Dobranja tregon se gratë në Kosovë punojnë mesatarisht 7 deri në 8 orë në ditë në punë të paguar, ndërsa punojnë mbi 3 orë në punë të papaguar shtëpiake. Edhe raporti i MCC-së tregon se punësimi i pavullnetshëm është endemik në Kosovë.

Gratë mbajnë barrën e kujdesit ndaj fëmijëve dhe të moshuarve

Përgjegjësia që gratë kosovare ndjejnë ndaj familjes llogaritet një nga pengesat kryesore të pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës. B. Sh., e cila për disa vite kishte punuar si infermiere në një qendër të mjekësisë familjare, para një viti ishte detyruar ta ndërpriste punë. Shkak për këtë ishte bërë kujdesi ndaj vjehrrës, e cila vuante nga një sëmundje si pasojë e së cilës kishte mbetur pothuajse e palëvizshme.

“Kam punuar për gati 10 vjet si infermiere, edhe shkollimin e kam në atë drejtim, por dikush duhej që të kujdesej për vjehrrën - ose unë, ose bashkëshorti. Shkaku që bashkëshorti kishte pagën më të madhe se unë, mora vendim që ta lë punën për një kohë sa është e nevojshme”. Ajo ka treguar se nganjëherë punon në një klinikë private dhe paguhet për gjysmë orari, vetëm e vetëm që mos të shkëputet plotësisht nga puna.

Dobranja nga Riinvest thotë se gratë kanë barrë joproporcionale të kujdesit dhe zakonisht ato janë të vetmet që kujdesen për fëmijët. Sipas saj, duhet të bëhen disa ndryshime në mënyrë që të përmirësohet situata.

“E para, të ofrohet pushimi i atësisë për baballarët, mirëpo të rregullohet që të jetë pushim i paguar, në mënyrë që të mos kenë arsye për të mos e marrë pushimin. E dyta, të investohet në çerdhe dhe kujdes për fëmijët që është lehtë i qasshëm dhe i përballueshëm, në mënyrë që grave t’iu ofrohet mundësia të dalin në treg të punës pa pasur barrën e kujdesit ndaj fëmijëve. E treta, të përmirësohet infrastruktura e kujdesit ndaj të moshuarve”.

Edhe Valëza Zogjani nga D4D tregon se faktorët shoqërorë dhe kulturorë që e përcaktojnë rolin e grave në shoqëri ndikojnë në masë të madhe në qasjen e grave kosovare në tregun e punës.

Sipas saj, hulumtimi i fundit i bërë nga D4D tregon se 53.2 për qind e grave nuk kërkojnë punë për shkak të përgjegjësive familjare në kujdes të fëmijëve dhe të moshuarve. Marrë parasysh numrin tejet të madh të grave joaktive në tregun e punës, është me rëndësi të promovohen mënyra që i inkurajojnë ato për t’i motivuar që të jenë më proaktive dhe të angazhohen në mënyrë aktive në jetën ekonomike.

“Puna me orar jo të plotë mund të përdoret si urë për të kaluar në punësim me orar të plotë, veçanërisht për gratë që nuk kanë punuar asnjëherë më herët. Në këtë aspekt, qeveria do të mund të ofronte skema të ndryshme për të promovuar punën me orar jo të plotë, si përpjekje për të përfshirë në mënyrë aktive gratë në fuqinë punëtore”. Ajo mendon se edhe rritja e vetëdijesimit qytetar për rëndësinë e përfshirjes së barabartë të grave në treg te punës, dhe tejkalimi i konceptimit të rolit tradicional gjinor të grave vetëm si kujdesdhënëse në familje, kërkon përpjekje të veçantë.

Mungesa e pushimit për baballarët thellon pabarazinë

Mungesa e pushimit të atësisë për baballarët shihet si shqetësuese dhe krijon hendek në mes të kohës që nënat kalojnë me fëmijët në raport kohën e baballarëve.

Në raportin e Institutit Riinvest, “Gratë në Tregun e Punës”, të publikuar në vitin 2017, 91 për qind e grave besojnë deri në njëfarë mase se burrat janë po aq të aftë sa gratë të kujdesen për fëmijët, kurse në 74 për qind të rasteve, të dy partnerët janë të përfshirë në kujdesin ndaj fëmijëve.

Ligji aktual i Punës në Kosovë parasheh vetëm dy ditë me pagesë dhe dy javë pa pagesë për leje të atësisë për baballarët që punojnë, të cilin mund ta marrin kurdo para se fëmija të arrijë moshën trevjeçare. Sipas Valëza Zogjanit, kjo e përforcon pabarazinë gjinore si në familje, ashtu edhe në shoqëri, duke rezervuar nënat si kujdesdhënëse primare të fëmijëve dhe duke i shtuar barrierat për përfshirje të barabartë të tyre në tregun e punës.

“Modeli ekzistues ndikon negativisht edhe në mirëqenien sociopsikologjike të fëmijëve, të cilët kërkojnë praninë e të dy prindërve për zhvillim të plotë emocional dhe kognitiv. Për barazi gjinore në familje dhe shoqëri, leja e lindjes, e atësisë dhe leja prindërore, si dhe kujdesi për fëmijët, duhet të trajtohen si përgjegjësi kolektive”.

Burrat i marrin vendimet e mëdha

Pabarazia krijohet edhe brenda familjeve kur merren vendimet e mëdha. Sipas një hulumtimi të Riinvest, vendimet për shpenzimet e zakonshme, ato për ushqim dhe veshje, bëhen bashkë nga çifti në rreth 77 për qind të rasteve, vetëm nga gratë në afërsisht 16 për qind të rasteve, ndërsa vetëm nga burrat në rreth 4 për qind të rasteve.

Vendimet për shpenzimet e mëdha, në formë të investimeve, në 78 për qind të rasteve bëhen bashkë nga çifti, mirëpo përqindja e secilit partner që merr vendime i vetëm ndryshon nga shpenzimet e zakonshme, pasi këto vendime merren nga partneri i vetëm në rreth 15% të rasteve, dhe rastet më të rralla këto vendime merren nga vetë gruaja ose nga një anëtar tjetër i familjes. ?

Gazetare kontribuuse:
Sanie Jusufi

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Punët e nënave



Nora Hasani

“Nganjëherë mendoj që e nxjerrin foshnjën, e në vend të saj na fusin fajin”

Arianna Huffington, bashkëthemeluese dhe kryeredaktore e The Huffington Post, për BigThink në 2009.

Asnjë fjali nuk mund ta përshkruajë më mirë ndjenjën e vazhdueshme të fajësisë e cila i përcjellë nënat që punojnë. E këtu të gjitha ndiejmë njësoj, pa marrë parasysh moshën që kemi, vendin ku jetojmë, çfarë pune apo pozite kemi, nëse jemi të martuara apo vetushqyese.

Ndërsa po e shkruaj këtë shkrim, jam në zyrën time, jashtë orarit, si shumë herë më parë. Edhe mua më përndjek ndjenja e fajit si një hije që shfaqet kohë pas kohe dhe më godet kur nuk e pres. Ndihem në faj se, përkundër faktit që jam nënë vetushqyese e një djali 6 vjeçar, dua të punoj dhe të angazhohem akoma më shumë që përmes punës sime ta jap një kontribut për zhvillimin ekonomik të vendit tim, për Kosovën e djalit tim, që ai ta ketë një të ardhme më të mirë.

Ndihem në faj që po e lë fëmijën nën përkujdesje të tjetërkujt, që po më ikin momente të çmuara, të cilat nuk kthehen më pas. Pyes veten se në çfarë forme do të ndikojë kjo tek fëmija im në të ardhmen.

Pastaj kujtoj që sot nuk e mbaj mend se cilat momente nga jeta ime do të mund t’i kenë ikur nënës sime. Karriera e saj padyshim ka pasur ndikim të madh tek unë, kur e shoh se çfarë roli ka luajtur ajo në shoqëri dhe çfarë frymëzimi vazhdon të jetë, jo vetëm për mua, por për të gjithë njerëzit që e njohin dhe punojnë me të. Megjithatë, nuk ka pilulë që e zhdukë ndjenjën e fajit. Jemi nën presion shoqëror dhe ndjekim idealin që mund t’i kemi të gjitha. Në shoqërinë tonë kësaj i shtohen edhe rolet tradicionale që nuk po i thyejmë dot. Gruaja është ajo që e ka obligim të përkujdeset për anëtarët e familjes, për amvisëri – pa e ndarë këtë barrë me askënd. Shpeshherë akoma pa krijuar familje, vajzat dhe gratë kosovare duhet të vendosin ndërmjet punësimit dhe krijimit të familjes. Përderisa burrat janë ata që duhet të punojnë për ta mbajtur atë familje. Në Kosovë nga 323.508 persona të punësuar vetëm 75.284 janë gra.

Sociologia gjermane Jutta Allmendiger, në njërën prej intervistave të saj për gazetën Die Zeit, thotë se gratë që punojnë kanë potencial ta ndryshojnë botën, mirëpo vetëm nëse ndryshojnë strukturat ekzistuese, të cilat në vazhdimësi nxisin stereotipizimin, jo vetëm tek punëdhënësit. Pra, duhet të ndryshojë qasja ekzistuese tek punëdhënësit, që ata mos ta shohin stafin e tyre të gjinisë femërore me paragjykimin që "sapo të bëhet nënë, nuk do të dëshirojë të bëjë më karrierë”, apo të investojnë dhe promovojnë më shumë burrat, për shkak se për ta krijimi i familjes nuk paraqet pengesë për punësim.

Natyrisht, këto imazhe ndikojnë gjithashtu në mënyrën e vendimmarrjes tek gratë. Gjithnjë kanë pozitë më të vështirë në negociata qoftë në punë, qoftë në shtëpi. Pra, duhet t’i thyejmë konceptet tradicionale, që punët në shtëpi dhe përkujdesja ndaj fëmijëve të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet partnerëve.

Nënat kosovare, përpos që duhet t’i luftojnë konceptet patriarkale të shoqërisë për ta filluar apo vazhduar marrëdhënien e punësimit, duhet të luftojnë edhe për ta gjetur një vend në kopsht. Njëri prej faktorëve vendimtarë që do të lehtësonte qasjen në tregun e punës është padyshim qasja në kopshte për fëmijë, që ofrojnë përkujdesje cilësore dhe siguri me çmime të arsyeshme. Në Prishtinë është më lehtë ta regjistrosh fëmijën tënd në fakultet sesa t’ia gjesh një vend në kopsht publik. Në pjesën dërrmuese të komunave dhe të qyteteve tjera në Kosovë as që ka kopshte publike për fëmijë. Gjendja është pak më ndryshe sa u përket kopshteve private. Aty kemi oferta nga më të ndryshmet: kopshte të licencuara e të palicencuara, kopshte në shtëpi e në ndërtesa të banimit kolektiv, kopshte që ofrojnë programe edukative, apo të tilla që fëmijëve u ofrojnë programe televizive… Përkundër dallimeve, kopshtet private e kanë një të përbashkët: janë të paarritshme për shumicën e buxheteve familjare.

Dhe nëse përkundër të gjitha peripecive arrijnë të punësohen e ta menaxhojnë familjen edhe punën, kthehemi prapë te ndjenja e fajit që nxitet në veçanti nga diskurset sociale e mediale lidhur me ndikimin e nënave të punësuara tek fëmijët.

Nuk është e rrallë që nënat e punësuara, e në veçanti ato që kanë ambicie dhe synojnë karrierë, të etiketohen si nëna të këqija, që devijojnë nga roli i tyre si përkujdesëse dhe kanë ndikim të keq në familje. Një studim i publikuar nga Kathleen McGinn et al. në Harvard Business School jep një argument të fuqishëm kundër këtij stereotipizimi negativ për nënat. Studimi u bie me grusht etiketimeve të llojit “nënat të cilat punojnë e shkatërrojnë familjen” dhe “nënat e punësuara i lënë anash dhe i braktisin fëmijët”. Sipas këtij hulumtimi, nënat e punësuara jo vetëm që kanë ndikim pozitiv tek vajzat e tyre, por edhe te djemtë. Fëmijët që rriten në familje ku nëna është në marrëdhënie pune mësohen të jenë më të pavarur e të marrin përgjegjësi, mësohen t’i ndajnë obligimet brenda familjes dhe kështu t’i përmbysin gradualisht konceptet mbi rolet tradicionale gjinore jo vetëm në familje e shoqëri, por edhe në tregun e punës!

Të dhënat për këtë studim janë mbledhur nga 24 shtete të ndryshme. Sipas këtij studimi, vajzat e rritura të nënave të punësuara kanë më shumë gjasa për t‘u punësuar, për të fituar më shumë dhe për të pasur pozita udhëheqëse në krahasim me vajzat e rritura të nënave të cilat qëndrojnë në shtëpi kur fëmijët e tyre janë të vegjël. Në anën tjetër, djemtë e rritur të nënave të punësuara janë më të përkushtuar ndaj familjes, ata kalojnë më shumë kohë në përkujdesjen ndaj anëtarëve të familjes. Studimi gjithashtu tregon se ata kanë gjasa më të mëdha të martohen me vajza të punësuara, në krahasim me djemtë e nënave që qëndrojnë në shtëpi.

Studimi i McGinn synon të shërbejë si shtytës për nxitjen e krijimit të politikave më të favorshme kombëtare dhe lokale për punësim prindëror dhe largimin e barrierave që e vështirësojnë balancën ndërmjet punës dhe familjes. Në veçanti rekomandohen politika për përkrahjen e nënave të punësuara.

Në Kosovë jemi akoma në proces të hartimit të politikave më të favorshme për t’i përkrahur gratë në përgjithësi, e nënat e punësuara në veçanti. E deri atëherë, shtylla kryesore që përkrah nënat e punësuara mbetet familja.

Si të gjitha nënat që punojnë, kam betejën time të brendshme ndërmjet dëshirës për ta përmbushur veten dhe synimet profesionale dhe të qenit “nënë e mirë”, luftë për të arritur një balancë ndërmjet punës dhe jetës private. Një luftë të cilës nuk i shihet dot fundi, sepse ekuilibri që synojmë ta arrijmë është veçse një mit. Kohën nuk mund ta ndajmë proporcionalisht ndërmjet punës dhe familjes. E as që duhet kohën e kaluar me fëmijë ta matim me orë, por më shumë me përkushtimin edhe prezencën që e kemi ndaj tyre kur jemi në shtëpi.

Ndërsa, për ato nëna të cilat përkundër sfidave vazhdojnë ta ndjekin punën dhe karrierën e tyre, të gjeturat nga ky studim i Harvard Business School mund të shërbejë si një lehtësim i vogël nga ajo ndjenja e përhershme e fajësisë për ikjen e çasteve që nuk përsëriten më. Ndikimi pozitiv në zhvillimin e fëmijëve është më afatgjatë dhe më i thellë se një kujtim i humbur.

Autorja është Drejtoreshë Menaxhuese e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare

Qëndrimet e shprehura janë personale dhe nuk shprehin qëndrimet e institucionit.

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Barazia Gjinore, Parakusht i Qeverisjes së Mirë

Edi Gusia

Ky artikull u përgatit si kontribut në cilësinë e një rekapitullimi të gjithë asaj që ndodhi nga 8 Marsi i vitit të kaluar, dhe parë në atë këndvështrim duket si një vit jo pak sfidues për shoqërinë tonë në përgjithësi dhe për çështjet gjinore në veçanti.

Në aspektin institucional, Agjencia për Barazi Gjinore udhëhoqi iniciativa të shumta dhe nuk ishte aspak e lehtë vendosja e prioriteteve në fushën e barazisë gjinore ku parë nga të dhënat nga vlerësimi i zbatimit të politikave publike që promovojnë barazinë gjinore, prioritetet ishin të shumta për nga rëndësia, sepse çka në fushën e çështjeve gjinore ishte më pak e rëndësishme? Të gjitha ishin të rëndësishme për nga pesha dhe ndikimi që mund të kenë në tërë shoqërinë në përgjithësi dhe në jetën e vajzave dhe grave në veçanti.

Qeveria e Kosovës në vitin 2018 filloi procesin e verifikimit të statusit të të mbijetuarave/ëve të dhunës seksuale gjate luftës, një proces ky tejet sfidues, dhe shoqërisë sonë iu deshën me tepër se një dekadë për të pranuar dhe ballafaquar me të vërtetën se çka kishte ndodhur dhe sa e madhe ishte dhimbja e të mbijetuarave/ëve për mospranimin publik të krimit monstruoz të ndodhur ndaj tyre, të mbështetjes së mohuar. Procesi filloi dhe vazhdon, jo me pak sfida, por pensionet e para u ndanë dhe një kompensim minimal, më tepër shpirtëror, hyri në sistemin shtetëror, duke na dëshmuar se arritjet më të mëdha mund të arrihen vetëm kur të bashkohen forcat e institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile. Çdo kauzë e drejtë na bashkon dhe duhet të na bashkojë.

Vlerësoj se kjo e arritur e përbashkët duhet të jetë platforma e të gjithë neve që duam të kontribuojmë në agjendën e barazisë gjinore dhe çdo agjende tjetër që në qendër të vëmendjes e vë mirëqenien e qytetarëve dhe qytetareve të Republikës së Kosovës.

Sfida dhe njëkohësisht dhembja më e madhe gjatë këtij viti ishte humbja e jetëve të gjithë atyre grave, në mesin e tyre edhe një e mitur, që ishin viktima të dhunës në familje gjatë vitit 2018, brenda mureve të shtëpisë, të cilat ne nuk arritëm t'i mbronim dhe t'iu ofronim sigurinë e së drejtës së jetës dhe gëzimit të saj. Shifrat janë alarmante dhe kërkojnë përkushtim maksimal për t'i parë dhe përmirësuar dobësitë në sistemin e referimit, mbrojtjes dhe trajtimit. Jetët e humbura duhet të jenë objektivi ynë për të vënë drejtësi dhe sjellë para përgjegjësisë të gjithë atë pjesë të sistemit e cila dështoi për t'i mbrojtur jetët e nënave, motrave, bijave, vajzave dhe shoqeve tona, qytetareve të këtij vendi.

Fenomeni kërkon qasje shumëdimensionale duke filluar nga edukimi, nisur nga fakti se çfarë ne nënkuptojmë me sferë të domenit privat, sepse kur bëhet fjalë për të mbrojtur jetë njerëzish është interes publik, interes shtetëror dhe aty nuk ka "hapësirë për ta trajtuar si interes privat" dhe dënimet duhet ashpërsuar për përgjegjësit. Javët e fundit dy të rinj humbën jetën, u vranë në rrugë, gjë që është sinjal alarmant për nivelin e sigurisë dhe duhet menduar se çka na duhen tërë këto armë në duart e qytetarëve. Për kë jemi armatosur në këtë mënyrë ne, qytetarët e rëndomtë? Pse qenka kaq e lirë jeta e individit? Çfarë qenka kaq e paripareshme dhe e pakorrigjueshme që kërkon marrjen e jetës së tjetrit? Pse po e sfidojmë besimin dhe punën e institucioneve që i krijuam me aq sakrificë dhe që në mandat kanë mbrojtjen e jetës së të gjithë qytetarëve/eve të Republikës së Kosovës. Besimi dhe respekti mes qytetarëve dhe institucioneve duhet ndërtuar në parime të shëndosha dhe barazia gjinore është shtylla e qeverisjes së mirë, prandaj duhet investuar në të.

Zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore kërkon të ndërmarrim veprime shtesë si masat afirmative që synojnë fuqizimin e rolit të gruas në përgjithësi dhe atij ekonomik në veçanti. Këto masa për qëllim përfundimtar kanë ndryshimin e normave kulturore përmes pavarësimit ekonomik të gruas, që është parakusht i mirëqenies fizike dhe emocionale, si dhe ndryshimin e normave kulturore, të cilat e vënë gruan në pozitë të pafavorshme karshi burrit në mungesë të mbështetjes financiare dhe kushteve adekuate për t'u zhvilluar si individ i pavarur. Edhe pse në fillet e para të buxhetimit gjinor, vlejnë për t'u përmendur iniciativat si ajo e Agjencisë për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale për regjistrimin e pronës pa pagesë, në emër të të dy bashkëshortëve - për çiftet të cilat duan ta shfrytëzojnë këtë të drejtë. E filluam me 105 raste që kishin pronë në emër të dy bashkëshortëve dhe në fund të vitit 2018 kishte më se 4100 çifte që regjistruan pronën në emër të përbashkët.

Në Politikat Zhvillimore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, masa afirmative për gratë fermere të cilat kanë përparësi në përfitimin e granteve me 2 pikë shtesë solli rezultate inkurajuese. Sipas të dhënave të Ministrisë, nga pagesat direkte në këtë kategori gjatë vitit 2018 kanë përfituar 794 gra, në shumë totale prej 530.054 euro. Ndërsa, sa i përket përfituesve të granteve duke përfshirë sektorë të ndryshëm, gjithsej janë 617 përfitues, prej tyre 294 gra dhe 313 burra, në shumë totale të buxhetit 30.915.255 euro (kjo vlerë është për të dy gjinitë).

Edhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, gjatë vitit 2018 kishte ndarë për projekte kulturore të artist skenik, promovimit kulturor, letrar për krijueset diku rreth 350.000 euro, mirëpo në anën tjetër përkundër rezultateve të arritura totali i investimit në sport për gratë dhe vajzat nuk kalonte shifrën prej 15 për qind të buxhetit total për sport të kësaj ministrie.

Gratë në Kosovë dëshmuan përgjatë historisë së ndërtimit të shtetit tonë se pjesëmarrja dhe kontributi i tyre nuk vlen vetëm për përfaqësim numerik, por dhe si kontribut cilësor e shoqëror në krijimin e një realiteti të ri në Kosovë dhe një imazhi mbresëlënës. Mjafton të përmendim: Majlinda Kelmendin, Feride Rushitin, Ilire Vincën, Taibe Canollin, Blerta Zeqirin, dhe shumë të tjera që promovuan vlerat e Kosovës në nivel ndërkombëtar dhe janë "ambasadoret" më të mira që ka vendi ynë.

Dhe në fund, mendoj se gjatë vitit 2019 duhet të fokusohemi më qenësisht tek të drejtat e garantuara që nuk zbatohen me automatizëm nëse nuk kërkohen, promovohen, plasohen dhe sqarohen. Ne si shoqëri kemi nevojë t'i prezantojmë ligjet dhe t'i njoftojmë qytetarët dhe institucionet më shumë me të drejtat e garantuara. Ne nuk veprojmë çdoherë në frymën e legjislacionit të cilin e kemi dhe të cilin nuk e zbatojmë në tërësi, jo rrallëherë edhe pse nuk e njohim në thelbin e vet. Andaj, në procesin e reformës zgjedhore, rëndësi e veçantë duhet kushtuar harmonizimit të Ligjit për Zgjedhjet dhe Financimin e Partive Politike me Ligjin për Barazi Gjinore për përfaqësim prej 50 për qind, me fokus masën afirmative e cila duhet të vazhdojë të jetë në fuqi.

Autorja është Kryeshefe Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore

Maskuliniteti në Kosovë

Besnik Leka

Ngjarjet e tmerrshme në Kosovë duhet të na kthejnë vëmendjen tek burrat.

Kur them vëmendjen, nënkuptoj normalisht jo-aministimin e burrave, për këtë s'bëhet fjalë. Kjo, mbi të gjitha, duhet kuptuar si thirrje e zëshme që të shohim se nga e morën të drejtën burrat që të ndihen të provokuar, e jo se si gratë "provokojnë". Pra, diskursi duhet të ndryshojë dhe duhet shikuar thellë se cilët janë faktorët që u kanë krijuar burrave rehatinë të provokohen e të ndihen sikur u takon të dhunojnë.

Është një vijë e hollë që ndan drejtimin e gishtave nga burrat, sepse ata botërisht janë shkaktarët më të mëdhenj të dhunës gjinore dhe kthimin nga burrat që padyshim mbahen përgjegjës për dhunën e shkaktuar, por mobilizohen për ta ndaluar ciklin e dhunës. Pra, burrat duhet të tejkalojnë përtej thjesht pranimit pasiv të statistikave, por të mobilizohen për t'i ndryshuar ato.

Burrat duhet t'i bashkohen përpjekjes për barazi, duke mos pritur që dikush t'u zgjatë dorën. Shkurt, dhuna duhet t'i zgjojë burrat nga letargjia, sidomos burrat që e dinë sa keq janë gjërat dhe mjaftohen me të pranuarit e kësaj gjendjeje. Dhe kështu, burrat duhet të jenë përgjegjës për ndalimin e dhunës. Mendoj që përgjithësisht mungon kjo qasje, përcillet faji, por jo domosdo përgjegjësia për ta ndryshuar gjendjen, për t'i ndryshuar statistikat që i nxjerrin burrat si shkaktarë të dhunës në bazë gjinore.

Pra, burrat duhet ta marrin vesh që nuk mund të ecin rëndom dhe të dhunojnë. Ata kanë obligim t'i sfidojnë privilegjet me të cilat janë rritur dhe mësimet që i kanë bërë ata të mendojnë që gjithçka u takon atyre. Asnjë burrë nuk duhet amnistuar vetëm me faktin që i vjen keq për dhunën. Nuk mjafton të ndihesh keq për atë që ndodh, dhe po, është koha që kaq arbitrarisht t'i shohim gjërat në këtë aspekt.

Madje, nuk mjafton të dish që maskuliniteti i dëmshëm është ndërtuar me vite të tëra, është pjesë integrale e rritjes së burrave dhe që burrat janë ushqyer asisoj që të jenë të dhunshëm. Është e domosdoshme ta dish këtë, por është qenësore që në mënyrë aktive ta sfidosh këtë histori patriarkati. Është esenciale që burrat të mos mjaftohen me atë se si janë rritur. Dhuna nuk justifikohet. Aq më pak rehatia në dhunë. Pra, dhuna duhet sfiduar kur rehatohemi në sistem dhunues. Marrëdhëniet e pabarabarta dhe mirëmbajtja e tyre për kohë kaq të gjatë janë pasojë e rehatisë në dhunë e patriarki.

E kjo është pjesa e vështirë. Rehatia që burrat kanë krijuar. Është e habitshme sa e pritshme është bërë që me shpejtësi të fajësohet viktima në Kosovë. Kur them e pritshme mendoj për atë se sa shumë e kemi relativizuar dhunën, deri në normalizim. Kjo na kthen lart, kur them që askush nuk pyet se ku e marrin të drejtën burrat të provokohen e ta sendërtojnë këtë provokim në dhunë, hej!

Ata po dhunojnë dhe në maskulinitetin dominues raportimi i dhunës në polici nga disa konsiderohet si provokim ndaj policit që të dhunojë. Aq shumë është bërë e zakonshme dhuna, saqë një grua që del natën konsiderohet si provokuese, ndërsa një burrë që e dhunon atë konsiderohet viktima e provokuar. Burrat duhet ta kuptojnë që të ndihesh i provokuar nga një grua është e padrejtë. Edhe ne, të gjithë, duhet ta kuptojmë që gratë nuk provokojnë aktivisht, janë burrat që provokohen. Pra, me ta duhet të merremi. Ata duhet t'i mësojmë që nuk kanë të drejtë të provokohen.



Kur pati raste të ngacmimeve seksuale në Universitetin Publik, kur doli në pah rasti i të dhunuarës shumëfish nga Drenasi – pothuajse në mënyrë paralele me zërat që solidarizoheshin me viktimën pati zëra që e fajësonin atë. Aktivizmi duhet të nisë më maksimën: "Asnjë burrë nuk duhet ta ketë rehatinë dhe të drejtën të ndihet i provokuar (në kontekstin në të cilin përmendet provokimi në raste të këtilla) dhe të bëhet dhunues, ndërsa asnjë grua nuk duhet të jetojë me frikën se vetëm pse ajo merr frymë dhe ekziston mund të provokojë ndonjë burrë, i cili më pas e dhunon atë".

Patriarkia ka histori të gjatë. E kjo histori duhet të mbetet e kaluar. Ta vësh në pyetje historinë e patriarkisë do të thotë të vësh në pikëpyetje vlera dhe norma që janë thelluar aq shumë, saqë burrat mund të ndihen sikur po u sfidohet vetë qenia. Ashtu jam ndier unë dhe pa dashur të përgjithësoj, ashtu janë ndier qindra burra të rinj me të cilët kam punuar përgjatë shumë viteve. T'i thuash troç një burri që ti nuk ke të drejtë të dhunosh, të thuash në një muhabet me dosta që ti nuk pajtohesh me ta kur ata flasin për gratë si të ishin objekte, të qëndrosh kundër instrumentalizimit të gruas është sfidë. Por, kjo sfidë është kopsht me lule kur marrim parasysh sfidat që gratë i kanë përditë me burrat patriarkë e me dhunën e përditshme ndaj tyre. Pra, nuk barazohet dhunuesi me viktimën assesi. Diskutimi duhet të përqendrohet në atë se si shoqëria jonë po mirëmban burra që kanë premisa të dhunojnë.

Në këtë linjë, burrat duhet ta kuptojnë që atyre u duhet feminizmi, u duhet barazia. Kjo nuk është tendencë për të krahasuar kush vuan më shumë prej sistemit patriarkal, sepse kjo dihet, statistikishit çdo e treta grua përjeton dhunë nga partneri intim. Po ashtu, në Kosovë dhuna po vazhdon të rritet. Megjithatë, duke u kthyer sërish te roli i burrave – arsyeja kryesore për vetëvrasjet e burrave është pamundësia që ata t'i përmbushin pritshmëritë e krijuara ndaj tyre. Pra, këto pritshmëri shpeshherë janë që burrat të jenë të vrazhdë, të mos shpërfaqin emocione, siç thash më lart, të refuzojnë t'u bashkohen diskutimeve ku gratë përmenden si objekte, që burrat të jenë fitimtarë gjithnjë. Po kështu, mbrojtja e "nderit" që bie në "detyrat" e burrave ka bërë që burrat përveç dhunës në bazë gjinore të ushtrojnë edhe dhunë ndërpersonale, pra në asnjë ekuacion burrat nuk përfitojnë prej dhunës që e shkaktojnë. Kjo është e rëndësishme të përfshihet në bisedën për barazi gjinore. Përderisa patriarkia mundohet të fuqizojë rigorozitetin tek djemtë dhe burrat, ushqen agresivitetin si ndjenjën e parë dhe pothuajse të vetme që burrat duhet të shpërfaqin, e në anën tjetër ushqen bindshmëri tek gratë, atëherë duhet që në thelb burrat të përfshihen në mësime të reja ku ata stimulohen të dashurojnë, të qajnë e kështu të pranojnë e të protestojnë kundër dhunës, ashtu siç protestoi grupi i djemve në Drenas kundër dhunës ndaj bashkëmoshatares së tyre.

Burrëria nuk është nocion negativ statik, pra i pandryshueshëm, dhe janë pikërisht burrat ata që duhet të punojnë që burrëria të mos jetë më kërcënim i barazisë.

Autori është aktivist i shoqërisë civile

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Bashkërenditje kundër dhunës në baza gjinore

Alessandra Roccasalvo

Përderisa po afrohet 20 vjetori i Programit të OKB-së për Zhvillim në Kosovë, i shqyrtojmë të arriturat tona, por edhe reflektojmë çfarë mund të bëhet më shumë. Gjatë pesë viteve të mia këtu kam parë shumë zhvillime pozitive në shoqërinë tonë, por mund t'i lëmë anash lavdërimet dhe të kërkojmë gjithmonë zhvillim të shoqërive më të drejta, paqësore, më të qeta dhe më të sigurta.

Kur njerëzit mendojnë për paqe dhe siguri, paramendojnë lirinë për të shëtitur natën, për t'u ndjerë të sigurt në shtëpitë e tyre dhe të vlerësohen si pjesëtarë të barabartë të shoqërisë.

Paqja dhe siguria janë dy shprehje të ndërlidhura ngushtë dhe do të duhej të përfshijnë zotimin e grave dhe burrave për të zhvilluar shoqëri më të shëndoshë.

Kombet e Bashkuara ka kohë që janë zotuar për promovimin e rëndësisë së pjesëmarrjes së barabartë dhe përfshirjen e plotë të grave dhe burrave në shoqëri. Kjo përfshirje është pjesë e procesit për zhvillimin e shoqërive paqësore, të sigurta dhe të qëndrueshme. Gjithmonë do t'i nxisim shoqëritë për ta ngritur pjesëmarrjen e grave në proceset e ndërtimit të paqes dhe përfshirjen e pikëpamjes gjinore në legjislacion, politika dhe programe. Kjo ilustrohet përmes Rezolutës 1325 të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Në një shoqëri si Kosova, gratë kanë qenë themeli i familjeve me shekuj. Megjithatë, në këtë pozitë tradicionale ato mbesin vetëm brenda familjes. Shumë gra nuk janë aktive në pjesëmarrje në punësim, vendimmarrje, hartim të politikave, ose në politikë. Është e pashmangshme e vërteta se gratë kanë pozita që paguhen më pak, e pothuajse fare nuk ka gra në pozita të larta drejtuese; vetëm 9 për qind të grave janë në këto pozita.

Përkundër kornizës së fortë ligjore, vendimmarrësit - shumica e të cilëve janë meshkuj - shpesh mëtojnë të marrin vendime bazuar në vlerat patriarkale e jo në atë që thotë ligji. Për shkak të kësaj, shumë gra përjashtohen nga të drejtat e tyre për pronësi dhe trashëgimi - vetëm 20 për qind e grave kanë pronë të regjistruar në emrin e tyre. Këto realitete të pakëndshme rezultojnë në gratë si anëtare të pabarabarta të shoqërisë sonë dhe rrjedhimisht sigurojnë që shumë prej tyre ekonomikisht varen nga burrat. Kjo paraqet pengesë për lirinë e tyre për të bërë zgjidhje të pavarura dhe në disa raste shërben si model i kontrollit dhe i dhunës kundër tyre.

UNDP-ja, si pjesë e familjes së gjerë të OKB-së, ka mandat për të siguruar që përfshirja e perspektivës gjinore është pjesë e nismave tona për zhvillim. Përfshirja e perspektivës gjinore është procesi i vlerësimit të pasojave për gra dhe burra të çfarëdo veprimi të planifikuar, duke përfshirë legjislacionin, politikat ose programet në të gjitha fushat dhe nivelet. Po punojmë së bashku me partnerët tanë në qeveri, agjenci të huaja për zhvillim, organizatat joqeveritare dhe opinionin publik, për ta përmirësuar pozitën e grave në shoqëri në të gjithë sektorët. Përmes projekteve për punësim, më shumë se 50 për qind e përfituesve për fuqizim ekonomik janë gra, gjë që ua mundëson atyre t'i çelin bizneset e tyre. Ato tani prodhojnë ëmbëlsira, dizajnojnë dhe krijojnë veshje, si dhe sigurojnë të ardhura për vetvete dhe familjet e tyre. Gjithashtu po punojmë në përmirësimin e angazhimit të grave për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, përmes stërvitjeve praktike, ushtrimeve në komunitet dhe rritjes së vetëdijesimit. Po punojmë drejt përmirësimit të qasjes në drejtësi për gratë - duke përfshirë edhe ato në pozita të cenueshme dhe të margjinalizuara - përmes mbështetjes sonë për ndihmë ligjore falas dhe ndërmjetësimit, si dhe përmes zhvillimit të kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe policisë.

Gjatë tërë punës sonë me institucionet dhe shoqërinë civile, gjithmonë kemi promovuar pjesëmarrjen e grave në hartimin e politikave dhe strategjive, si dhe për integrimin e çështjeve gjinore në çdo fushë. Është me rëndësi jetike që gratë dhe nevojat e tyre të shprehen në çdo politikë shoqërore dhe që gjendja e tyre sociale të mos ndikohet nga aspekti ekonomik e as situata e tyre ekonomike të mos ndikohet nga aspekti social. Në shoqëritë tona pozita e grave gjithmonë do të duhej të jetë pozitë e barazisë, veçanërisht për çështjet familjare, trashëgimisë dhe pronësore.

Megjithatë, siguria nuk është e plotë nëse nuk pasqyron nevojat bazë të sigurisë për gra, veçanërisht përkitazi me fatkeqësitë natyrore, dhunën në familje dhe kontrollin e armëve. Meqenëse gratë janë më përgjegjëset për të ofruar kujdes ndaj fëmijëve, pleqve dhe anëtarëve të tjerë të familjes gjatë një fatkeqësie natyrore, institucionet përgjegjëse për parandalim të fatkeqësive duhet t'i marrin parasysh nevojat e tyre gjatë hartimit të çfarëdo strategjie për reagim ndaj fatkeqësive. Përveç kësaj, kontrolli dhe eliminimi i armëve janë drejtpërdrejt të lidhur me sigurinë fizike të grave, sepse fatkeqësisht, në një incident të kohëve të fundit të dhunës në familje janë përdorë armë ilegale.

Për fat të keq, dhuna në baza gjinore konsiderohet çështje private dhe e mbyllur për shoqërinë, gjë që mundëson që kjo shenjë e turpit të vazhdojë kundër nënave, bijave, motrave e mikeshave tona.

Edhe pse kemi punuar drejt një niveli të zotimit legjislativ dhe politik për ta luftuar këtë, zbatimi i përditshëm i ligjeve dhe rregulloreve ende dështon ndaj grupeve më të cenueshme. Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar dhe kjo gjë fatkeqësisht është bërë çështje e rregullt, duke iu mohuar atyre që jetojnë në rrethanat më të vështira ekonomike dhe sociale të drejtën e tyre për paqe dhe siguri.

Për të mundësuar ndryshim të qëndrueshëm, duhet t'i trajtojmë rrënjët e dhunës në baza gjinore dhe kjo mund të arrihet vetëm përmes përpjekjeve të bashkërenditura. E vlerësojmë punën e vazhdueshme rreth Mekanizmit koordinues komunal kundër dhunës në familje, si dhe përpjekjet e Zyrës së koordinatorit nacional dhe të Ministrisë së Drejtësisë. Megjithatë, duhet të punohet edhe më shumë, veçanërisht në zbatimin dhe aplikimin e ligjeve dhe strategjive përkatëse. Jo vetëm që gjyqësori është përgjegjës për të siguruar qasje efikase në drejtësi dhe ndarje efektive të sundimit të ligjit, por kjo është edhe përgjegjësi shoqërore. Që shoqëritë tona të bëhen më të drejta, më të mira, më paqësore dhe më të sigurta, ne të gjithë duhet të bëhemi ndryshimi pozitiv që duam të shohim.

Gjithçka që lexuat, si dhe gjithçka që bëjmë në UNDP është në përpjekje për të krijuar shoqëri më të qëndrueshme, më të sigurt, më paqësore dhe më të drejtë për çdo person. Po ashtu, do të jetë zotimi ynë për të punuar drejt arritjes së barazisë gjinore dhe fuqizimit të të gjitha grave dhe vajzave. Kjo është pjesë e zotimit tonë ndaj Objektivave të Qëndrueshme për Zhvillim dhe përkushtimi ynë ndaj Agjendës 2030.

Të gjithë luajnë rolin e tyre në krijimin e shoqërive që do të dëshironim të jetojmë, prandaj i bëj thirrje secilit prej nesh që gjithmonë të punojnë drejt këtyre idealeve.

Autorja është Përfaqësuese e Përhershme e UNDP-së në Kosovë.

Të drejtat e personave LGBTI janë të drejta të njeriut

Aktivistët e të drejtave të njeriut në shtetet e zhvilluara dhe organizatat e ndryshme joqeveritare ndërkombëtare kanë filluar shumë herët që të merren me të drejtat e personave LGBTI në kuadër të avancimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Organizatat joqeveritare në Kosovë që nga paslufta janë marrë me avancimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe të drejtat e personave LGBTI. Kjo çështje tashmë nuk do të duhej të konsiderohej tabu dhe diskutimi për këtë temë do të duhej të ishte i lirshëm.

Shoqëria kosovare vazhdon të jetë e mangët në respektimin e të drejtave të njeriut, deridiku për shkak të paragjykimeve, e në një pjesë të konsiderueshme për shkak të mungesës së informatave. Kur flasim për personat LGBTI dhe të drejtat e tyre të garantuara duhet nënkuptuar që po flasim edhe për sfidat e tyre, sidomos në Kosovë. Avancimi dhe mbrojtja e të drejtave të personave LGBTI është një betejë e vazhdueshme jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë botën.

Problemi qëndron në shumë aktere, duke filluar prej familjes e shoqërisë, institucioneve qeveritare e publike, duke përfshirë edhe ato të rendit e ligjit, pastaj nga disa media e deri tek sistemi i arsimimit që përhap gjuhë diskriminuese, që kryesisht ka të bëjë me cilësimin e të qenit "LGBTI" si sjellje devijante, ose si sëmundje mendore. Kjo në mënyre direkte ndikon në keqformësimin e mënyrës së të menduarit tek "liderët dhe profesionistët" e të ardhmes.

Qëndrimet homofobike dhe transfobike janë të rrënjosura thellë në mendjet e një pjese të konsiderueshme të popullatës, pastaj kur i kontribuon edhe mungesa e mbrojtjes së duhur ligjore, atëherë vihet në dukje më së shumti shkelja e të drejtave të njeriut për këtë pjesë të shoqërisë. Nivelet e larta të homofobisë dhe transfobisë u shkaktojnë personave LGBTI pasiguri dhe frikë nga persekutimi, mosbesim në institucione - sidomos ato të rendit dhe ligjit, frikën për ta shfaqur veten ashtu si janë, e të tjera. Të gjitha llojet e sulmeve që kryhen ndaj personave LGBTI nuk duhet të kualifikohen si vepra penale të thjeshta, por të cilësohen si vepra që janë kryer të motivuara nga një karakteristikë e mbrojtur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi.

Kohëve të fundit më shumë se kurrë po dekriminalizohet dhe legalizohet nëpër botë martesa ndërmjet personave të të njëjtit seks. Në vitin 2000, Holanda u bë vendi i parë në botë i cili e legalizoi martesën ndërmjet personave të të njëjtit seks, dhe në vitin 2009 Afrika e Jugut u bë shteti i parë afrikan që e mori këtë vendim, duke martuar një çift në mënyrën tradicionale të Afrikës së Jugut. Ky vendim historik në SHBA nuk u mor deri në qershor të vitit 2015, edhe pse lufta për të drejtat e komunitetit LGBTI filloi atje në fund të viteve të 1960-ta.

Kushtetuta e Republikës Kosovës është garantuesja më e lartë e të drejtave dhe lirive të njeriut. Vlerat e saj janë të bazuara në parimet e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit. Këto vlera janë shumë qartë të shprehura në nenin 24 të Kushtetutës: "Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim".

Në këtë nen gjithashtu theksohet se "Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal".

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi i vitit 2015 përcakton saktë konceptin e diskriminimit si dhe të gjitha format dhe llojet e trajtimit të pabarabartë. Po ashtu, Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi ofron mbrojtje nga diskriminimi në sektorët publikë dhe privatë në lidhje me disa fusha, si në punësim, orientim dhe trajnim profesional, mbrojtje sociale, arsim, qasje në strehim, etj. Legjislacioni në vete nuk është garanci për gëzimin e të drejtave të njeriut nëse ai nuk mbështetet nga vullneti politik dhe praktikat institucionale.

Çka duhet të bëhet për përmirësimin e pozitës së LGBTI në shoqëri?

Institucionet qeveritare dhe publike, si dhe organizatat joqeveritare, duhet të organizojnë sa më shumë aktivitete të ndryshme të cilat do të ngritin vetëdijen dhe do të informojnë shoqërinë kosovare, zyrtarët e sektorit publik dhe privat, për parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjit për Barazi Gjinore, parimet e gjithëpërfshirjes, organizimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese, publikimet e ndryshme për të drejtat e njeriut si vlerë e shtuar e një shoqërie, praktika të suksesshme kundër diskriminimit, rishikimi i teksteve shkollore dhe akademike me përmbajtje diskriminuese, dhe përfshirja në programet shkollore e të drejtave të personave LGBTI si të drejta themelore njerëzore, etj.

Po ashtu, edhe Organizatat e Shoqërisë Civile me fokus personat LGBTI duhet që sa më shumë të ndërtojnë partneritete me njëra-tjetrën dhe me organizatat me fokus personat LGBTI në Ballkan dhe në nivel ndërkombëtar, të shtojnë bashkëpunimin me institucionet e Republikës së Kosovës, partitë politike, etj. Organizatat tjera të shoqërisë civile që i mbrojnë të drejtat e njeriut në përgjithësi duhet të inkuadrojnë në fushëveprimin e tyre edhe të drejtat e personave LGBTI, për shkak se personat LGBTI, përveç që i takojnë këtij komuniteti, gjithashtu i takojnë edhe çdo komuniteteve tjera, siç janë gratë, komuniteti rom, ashkali, egjiptian, serb, personat me nevoja të veçanta, etj.

Shkrim nga Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore - CSGD

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Tradicionalja në modernen artistike gjinore

Sihana Klisurica

Simbolika e veshjeve tradicionale sot tek gratë mund të shikohet si relikte e cila flet për një të kaluar me vlera që duhen të ruhen. Flasin për një realitet të kohës dhe sistemit shoqëror. Derisa dikur ishin pjesë e përditshmërisë, tash ato i gjejmë më shumë si elemente në kreacione të modës, ose hyjnë në përdorim për festa të caktuara. Në një shoqëri konservatore dhe patriarkale, ku gratë marrin rolin dytësor në familje dhe rrethin ku jetojnë, e më shumë shihen si amvise dhe kujdestare të shtëpisë, veshja bëhet pjesë plotësuese e asaj pikëpamjeje. Viteve të fundit, dizajnere të ndryshme, por edhe artistë të fushave të ndryshme, kanë filluar që tradicionalen ta kthejnë në krijimet e tyre duke e bërë pjesë të projekteve të tyre moderne. Ndërthurja e tradicionales me modernen, sidomos kur flitet për veshjet tek gratë, ka marrë më shumë mesazhin e fuqizimit.

E tillë paraqitet gruaja në veshjet e kreatoreve kosovare kur ec nëpër pasarela me veshje që kanë ndërthurje mes tradicionales dhe modernes.

Besa Neziri Rugova dhe Krenare Rugova janë vetëm dy prej dizajnereve të cilat në krijimet e tyre kanë përfshirë elemente të tradicionales, duke i integruar ato në veshjet e tyre moderne. Në këtë formë është hapur një mundësi e re për prezantimin e tradicionales edhe jashtë vendit, duke i prezantuar krijimet e tyre nëpër botë.

Përveç tyre ka edhe artistë të tjerë që kanë përdorur mediume të ndryshme të artit për të risjellë tradicionalen në frymën moderne, gjithmonë duke pasur gratë në fokus. Një shembull i tillë është këngëtarja kosovare Fatime Kosumi, e cila me projektin e saj "Andrra" ka realizuar dokumentar mbi rapsodet gra dhe më pas ajo vet ka incizuar këngë të vjetra në EP-në "Palinë".

Tradicionalja në kreacionet e modës

Bashkë me zhvillimin shoqëror trendët e rinj kanë zënë vend. Veshjet kombëtare apo tradicionale, qofshin ato për gratë apo për burrat, janë një prej elementeve që flasin për këtë ndryshim. Kur specifikisht përmenden veshjet tradicionale shqiptare, atëherë dalin në pah edhe veçoritë sipas rajoneve brenda territoreve shqiptare.

Elemente të veshjeve tradicionale tashmë janë thurur e qepur në veshjet e dizajneres Besa Neziri Rugova. Ajo thotë se shpeshherë është bërë përpjekje dhe dizajnerë të shumtë janë joshur për të përdorur elemente tradicionale në dizajnet e tyre. Neziri-Rugova inspirimin e gjen tek elementet etnografike.

"Duke filluar prej siluetave dhe konstruktimit te veshjeve e deri te detajet më të vogla të punuara me shumë mjeshtri dhe dashuri, e më së shumti elementet sensuale e romantike, siç janë dantellat, qëndisjet, pëlhura e punuar në vek". Në veshjet e saja mëton që gruan ta prezantojë sa më të fuqishme duke i dhënë edhe zë që të zotërojë feminitetin e saj.

"Shpeshherë po e vërej një tendencë te gratë që për t'u dukur gra të fuqishme dhe për t'u dukur të barabarta me burrat vishen më mashkullore! Unë mendoj që edhe duke e mbërthyer feminitetin mund të jemi gra të forta dhe e inkurajoj atë me veshjet e mia shumë femërore dhe sensuale! Nuk besoj në idenë që për t'u dukur e fuqishme duhet të dukesh mashkullore", thotë Neziri-Rugova, e cila tashmë ka brendin e saj të veshjeve nën emrin "Besë". Ajo jeton dhe vepron në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por inspirimet për veshjet e saja shumë shpesh i gjen tek kultura dhe tradita e vendlindjes së saj. Për të, ndërlidhja mes tradicionales dhe modernes vjen shumë natyrshëm, madje e konsideron edhe autentike.

"Janë elemente me të cilat jam rritë dhe janë pjesë e identitetit tim. Po ashtu e ndjej edhe si obligim moral për t'i mbajtur gjallë sa ma gjatë edhe për gjeneratat e reja, duke i sjellë ato në formë moderne në veshjet e mia".

Edhe kreatorja e njohur kosovare Krenare Rugova-Zeqa ndërthur shumë elemente të kulturës shqiptare në veshjet e saja. E veçon veshjen e Dukagjinit, sepse konsideron se e ndjen dhe kupton më shumë.

"Veshjet e malësive gjithmonë më kanë lënë përshtypje. E kam përshtypjen që veshja e bjeshkëve dhe malësive e transmeton shumë bukur dhe qartë fuqinë dhe karakterin e fortë të gruas. Kombinimet e tekstileve të thurura, të errëta, janë të preferuarat e mia", thotë ajo, tek tregon se inspirimet e saj me kostumet tradicionale shqiptare nuk lidhen domosdo me patriarkalizmin. Është më e thellë se aq.

"Në fakt, kur shoh fotografi të grave me veshje tradicionale më japin një ndjenjë shumë të fortë të një gruaje të fuqishme me qëndrim e karakter të fortë, pa marrë parasysh që në ato kohë janë përballur me shoqëri patriarkale". Një shembull i këtij gërshetimi mund të jetë koleksioni për vjeshtë/dimër 2015/2016, i cili u pat prezantuar në atelienë e kreatores. Ajo kishte gërshetuar pëlhurën e thurur në vek dhe qëndisjen të cilat ishin punuar disa gra nga shoqata "Dyert e hapura" në Prishtinë, me të cilat bashkëpunon. Ajo kishte nxjerrë modelin që kishte dashur dhe e kishte ekspozuar në studion e saj. Ky model, apo "yrnek", siç e quante ajo, ishte marrë nga çejzi apo paja e njërës prej grave të shoqatës. Rugova-Zeqa e kishte marrë atë model dhe më pas e kishte vendosur në letër, duke ia ndërruar ngjyrën, madhësinë dhe formën. Kështu e solli në jetë përmes veshjeve moderne. Kjo ka qenë e kombinuar me veshje që u krijuan nga pëlhura të vjetra deri në 70 vjet, të cilat i kanë shfrytëzuar familje të ndryshme. Qëndisja po ashtu ka qenë një tjetër element i cili karakterizoi koleksionin e saj. Pëlhurat ishin qëndisur për të marrë edhe më shumë formën e duhur.

"Mendoj që të gjithë krijuesit kanë referenca tek elementet tradicionale të kulturave të ndryshme, e natyrisht që edhe kultura jonë ka mjaft për të na inspiruar për shumë krijimtari në shumë fusha. Krijimtaria e veshjes, apo modës, e ka fuqinë për të komunikuar kulturë, e ka fuqinë e influencës. Ndoshta kjo është një ndër arsyet më të forta: tregimet e padëgjuara që përmbajnë veshjet tradicionale shqiptare t'i tregoj përmes koleksioneve të mia për opinionin e gjerë", thotë Rugova-Zeqa.

Është një tjetër artiste kosovare e cila ka gjetur forma që duke përdorur artin e saj t'i japë qasje tjetër tradicionales, por në të njëjtën kohë të krijojë fushatë për luftimin e disa mendësive. Është kjo këngëtarja Fatime Kosumi.

Tradicionalja dhe folklori në muzikë

Para gati tri vitesh, Fatime Kosumi kishte marrë përsipër që të bëjë një vizitë studimore nëpër vise të ndryshme të Kosovës për të kuptuar më shumë për këngët e rapsodeve gra. Si rezultat, ajo ka bërë një dokumentar. Gratë rapsode në këtë dokumentar paraqiten të veshura me veshje tradicionale dhe rrëfimi i tyre dhe i këngëve që këndojnë vjen prej një prizmi tjetër.

Dokumentari "Këngë dhe Defa" rrëfen kërkimin që Kosumi kishte bërë për t'i parë specifikat e muzikës folklorike. Aty tregohet se si gratë e vjetra në Kosovë rrallëherë e kanë pasur rastin të mësojnë shkrim e lexim. Për to, këndimi ka qenë një medium i shprehjes. Këngët që i kanë kultivuar festonin tradicionalen, shpirtëroren dhe ritet religjioze. Një prej temave që më së shumti del në pah tek këto këngë është rituali i martesës. Zakonisht, këto këngë janë kënduar dhe diku vazhdojnë të këndohen një natë para martesës, para se vajza të shkojë tek shtëpia e burrit. Këto këngë zakonisht flasin se si vajza e lë prapa familjen dhe fëmijërinë për t'u bërë nuse. Kosumi, e cila tash përdor emrin skenik "Andrra", përmes kësaj ka ngritur zërin kundër martesave të hershme.

Në një intervistë për gazetën Koha Ditore, në vitin 2014, ajo kishte treguar për lidhjen e saj me këngët e "kanagjegjeve", duke thënë që kjo vjen nga fakti se "sado larg na duket tani ideja e të qenit e martuar me 'zor', prapë edhe sot janë disa 'zore' që i shtyjnë vajzat të martohen".

"Më herët 'zori' ishte më i dukshëm, kurse tani janë të padukshëm dhe fakti se atëherë vajzat kanë qajtë natën para martesës tregon se ato së paku e kanë ditë se çfarë është kah ndodh me to, prandaj edhe tekstet janë shumë konkrete dhe racionale. Kurse tani, edhe pse shumë pak martohen nga dashuria, e përqafojnë dhe e fshehin atë çfarë është duke i shtyrë ta bëjnë atë hap. Mua më intereson shumë sfidimi i kësaj teme muzikalisht, por edhe përtej", kishte thënë Kosumi.

Në këtë formë, ajo sfidon tradicionalen dhe i jep një tjetër qasje asaj që konsiderohet vlerë. Nga kjo del se sa e rëndësishme është që të bëhet gërshetimi i të kaluarës dhe të tashmes për një prezantim sa më të denjë të tradicionales më kontekstin e të drejtave të grave.

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Mes letrave, skenës dhe paragjykimeve

Rrugëtimi i grave në profesionet që kanë të bëjnë me artin, nëpërmjet së cilave manifestohet një sentiment dhe liri ndryshe e shprehjes, dallon goxha shumë nga ai i burrave. Gratë krijuese shpesh sfidohen nga mendësia maskuliniste dhe mentaliteti paragjykues.

Shkrimtare dhe aktore kosovare, të cilat sot dallohen me punën e tyre krijuese, rrëfejnë për sfidat nga mentaliteti patriarkal dhe për vlerësimin publik që u ishte bërë dikur dhe u bëhet sot. Sukseset e tyre gjithmonë kanë ecur paralelisht me paragjykimet që nisnin qysh në kohën kur një vajzë do të përcaktohej të hynte në botën e artit.

Ilire Vinca kujton kohën kur kishte vendosur të studionte aktrimin. Ëndrra e saj për t'iu përkushtuar këtij arti skenik do të pranohej me skepticizëm prej një grupi njerëzish që mendonin se ishte më mirë që ajo t'i rrekej mjekësisë.

"Unë i takoj gjeneratës së parë të aktorëve, e cila përkoi me hapjen e kësaj dege në Universitetin e Prishtinës në vitin 1989. Për mua ishte bekim që ky moment po përputhej me ëndrrën time. Në të njëjtën kohë regjistrova edhe mjekësinë. Kisha në dorë dy indeksë dhe dy grupe njerëzish që jepnin mendime se cili është profesion më i mirë", kujton Vinca, e cila kishte zgjedhur ta dëgjonte grupin më të vogël të njerëzve që e kishin përkrahur ta jetësonte ëndrrën e saj për t'u bërë aktore. Kjo edhe për shkak se duhej shembur paragjykimet patriarkale.

"E rritur në ambient familjar ku poezia dhe muzika ishin përditshmëri, i dhashë vetes detyrë që grupi i vogël duhej rritur, ndërsa vetëdija kolektive duhej ndryshuar. Ky rrugëtim nuk ka qenë gjithmonë i lehtë, por qëllimi në jetë na e jep emrin që ne duam. Emrin që ne zgjedhim ta mbajmë", ka thënë Vinca. Suksesi i saj në teatër e film e ka dëshmuar se nuk ka gabuar me zgjedhjen.

Rrugëtimi s'ka qenë i lehtë as për ato gra që kanë zgjedhur ta shpalosin botën e brendshme nëpërmjet poezive dhe shkrimit.

Shkrimtarja Ilire Zajmi rrëfen se kur ka hyrë në botën e letërsisë është përkrahur dhe paragjykuar njëkohësisht.

"Në botën e letërsisë hyra pa trokitur. Thjesht, i hapa dyert e një bote magjike, e dashuruar pas librave dhe e magjepsur fillova të shkruaja si fëmijë dhe të botoja në revistat dhe gazetat e atëhershme që dilnin në kuadër të 'Rilindjes'. Kam gëzuar përkrahje, por edhe jam paragjykuar, si shumë të tjera para dhe pas meje".

Të shumta kishin qenë paragjykimet kur ajo kishte nisur t'i botonte poezitë e para.

"Hamendësimet e natyrës si 'Kush po t'i shkruan poezitë?', 'Dikush po të përkrahë se ti si femër, s'mundesh vet', etj., më kanë ndjekur atëherë, deri te 'Këshillat për të mirën time', si 'Poezitë janë përralla, mos humb kohë me to, hapi sytë, bëj diçka të mençur se nesër bëhesh grua'".

Asaj i ka mbetur e ngulitur në kujtesë një ngjarje e veçantë nga ajo kohë. Shkrimet për botim i dërgonte përherë me postë. Por, kishte ëndërr ta vizitonte Pallatin e Rilindjes dhe t'i dorëzonte personalisht ato.

"Në redaksinë e revistës 'Fjala', redaktori u habit kur i thash kush isha. 'Ilire Zajmi?!'. Një vajzë e hajthme, trupvogël, me sy depërtues. Nuk i besohej se isha unë autorja e sa e sa poezive dhe përkthimeve nga anglishtja. Nuk i botoi shkrimet e mia deri në kohën kur u bëra studente dhe u bind se askush tjetër s' ishte pas emrit tim".

Pengesat nuk e kanë ndalur rrugëtimin e saj, prandaj sot Zajmi është personalitet i njohur në botën e letrave.

"Përkundër këtyre sfidave gjatë rrugëtimit tim, librat e mi të parë, njëri në poezi e tjetri në prozë, u pritën shumë mirë nga kritika dhe lexuesit. Madje, romani 'Fashitja e ëndrrave rebele' u lexua dorë më dorë dhe kërkohet edhe sot. Asokohe kritika vuloste karrierën tënde", ka thënë Zajmi, duke shtuar se sot situata është ndryshe.

"Si autore e dhjetë librave, e përkthyer në disa gjuhë të huaja, ndihem e vlerësuar dhe e arrirë edhe në vendin tim edhe jashtë kufijve, paçka se kritika në Kosovë thuajse nuk ekziston".

Dije Demiri-Frangu, e cila ka botuar 8 libra dhe poezia e saj është përkthyer në disa gjuhë, beson se secilës shoqëri i duhet impulsi i gruas. Ajo thotë se krijimtaria e grave është përvojë universale njerëzore me narracion unikal, derisa niveli i zhvillimit socio-kulturor i një vendi e përcakton pozitën dhe vendin e kësaj vlere.

"Përvojat e grave dallojnë nga ato të burrave, janë ekzemplarë që shpesh përçmohen nga mendësia maskuliniste dhe mentaliteti paragjykues. Edhe më paragjykuese janë profesionet që kanë të bëjnë me artin, ku gruaja manifeston një sentiment tjetër, një liri tjetër shprehëse". Sipas saj, gratë si qenie njerëzore historikisht kanë bërë përpjekje të ndërtojnë individualitetin e tyre edhe në art, por iu është dashur të kalojnë plot hendeqe në udhëtimin e tyre jetësorë për të arritur ku duan.

"Edhe sot, pavarësisht një ecjeje emancipuese të shoqërisë, gruaja shikohet me një mosbesim dhe vlerat e saj krijuese, edhe po të jenë mbi të të gjithëve, është vështirë të promovohen si të tilla dhe ta marrin primatin. Këtu burrat nuk lëshojnë vend".

Ajo ka shtuar se shoqëria kosovare vazhdon të udhëhiqet nga logjika maskuliniste dhe paragjykimet seksiste.

"Sidoqoftë, gruaja krijuese te ne përgjithësisht respektohet dhe shpesh favorizohet, por kjo bëhet edhe shkaku i një prezantimi të domosdoshëm dhe rrallë duke çmuar e hetuar vlerat e tyre në mënyrë realiste. Shpresoj se pengesat e natyrës patriarkale janë në zhdukje. Tani na duhet vetëm përkrahja institucionale që fantazia femërore të jetë e dukshme në mozaikun e vlerave të arteve të ndryshme", ka thënë Demiri-Frangu, e cila është edhe profesoreshë në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës.

Ajo ka theksuar se në botë ka organizata të veçanta që merren me përkrahjen e grave krijuese, me inkurajimin e tyre, botimet dhe promovimet e punës së tyre, vetëm që ato të mos ndjehen inferiore.

"Kjo është edhe një mënyrë se si caktohet pozita, roli i gruas dhe ideve të saj në shoqëri. Unë do t'i kisha ftuar gratë për një ambicie më të madhe, për një guxim që të mos lejojnë të margjinalizohet puna e tyre. Impulsi femëror i duhet çdo shoqërie".

Edhe shoqërisë kosovare i duhet ky impuls.

Gazetare kontribuuese:
Elvira Berisha

Prijëset globale synojnë fuqizim të grave në të gjitha frontet

The Guardian

Më shumë se tridhjetë prijëse botërore, përfshirë edhe kryetare të tashme dhe të kaluara të shteteve, kanë bërë thirrje për të luftuar kundër shkatërrimit të të drejtave të grave. Një ish-ministre i ka cekur vendet që udhëhiqen nga "i forti i llojit macho" si pjesë e problemit.

Susana Malcorra, ish-Ministre e punëve të jashtme të Argjentinës, tha se në disa vende kërkesa për të drejta të grave shihej si diçka që i dëmtonte burrat, e jo si një mundësi për t'i ndryshuar pritjet gjinore në një mënyrë të tillë që iu ndihmon të gjithëve.

"Ekziston një ndjenjë se pushteti tashmë i vendosur është duke u kërcënuar nga gratë që fitojnë respekt".

Helen Clark, ish-Kryeministrja e Zelandës së Re, dhe Irina Bokova, politikanja bullgare dhe ish-Drejtoresha e UNESCO-s, i janë bashkuar Malcorra-s në nisjen e fushatës, e cila përfshin publikimin e një letre të hapur.

Letra bën thirrje për "nevojën për të arritur barazi të plotë gjinore dhe fuqizim të grave në të gjitha frontet", dhe është nënshkruar nga dhjetëra gra të mirënjohura, përfshirë edhe Christiana Figueres, ish-Sekretare ekzekutive e Konventës Kornizë të OKB-së për Ndryshime Klimatike, Presidentes së Etiopisë, Sahle-Work Zewde, si dhe ish-Presidentes irlandeze, Mary Robinson.

Malcorra tha se zmbrapsja kundër të drejtave të grave ishte "më se e qartë" në disa vende, në veçanti në ato vende ku populizmi ka sjellë ngritjen e udhëheqësit "të fortë të llojit macho", si Brazili, Filipinet, Italia dhe disa pjesë të Europës Lindore.

"Ekziston një ndjenjë se pushteti tashmë i vendosur është duke u kërcënuar nga gratë që fitojnë respekt. Është një pikëpamje, sipas të cilës, nëse burrat marrin pushim atëror nuk është se ata humbin diçka. Ata fitojnë duke marrë përgjegjësi për familje, përfitojnë duke pasur marrëdhënie më të ngushtë me fëmijët e tyre dhe llogaria nuk është zero, por është situatë që të gjithë fitojnë. Por, është e qartë se ka qarqe të pushtetit në botë që nuk e shohin këtë gjë në atë mënyrë".

Fushata u nis kur Malcorra, Clark dhe Bokova, u shtangën nga i njëjti shqetësim urgjent gjatë Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të mbajtur vitin e kaluar në Nju Jork. Ngritja e populizmit dhe rënia e multilateralizmit nënkuptonte se të arriturat e fituara me mund për të drejtat e grave po shkatërroheshin.

"Patëm ndjenjën se kjo ishte edhe një valë tjetër e zmbrapsjes ndaj barazisë gjinore dhe fuqizimit gjinor, si dhe politikave për cilat kemi punuar aq shumë për t'i përmbushur", tha Malcorra, e cila ka shërbyer si Ministre e punëve të jashtme gjatë periudhës 2015-2017.

"Duhet të jemi të gatshme për t'i ngritur shqetësimet tona, përndryshe do të gjendemi në situatë si bretkosa, e cila futet në ujë të ftohtë, fillon të ngrohet dalëngadalë dhe papritmas bëhet ujë i nxehtë. Duhet të jemi shumë të gatshme për të luftuar".

Malcorra shtoi se madje edhe në vendet pa udhëheqës të fortë gratë duhet të kujdesen e të mos mendojnë se të drejtat e tyre janë të sigurta. "Shqetësohemi se e kemi marrë për të gatshme atë çfarë kemi. Sipas nesh, kjo është dobësia jonë më e madhe".

"E para, nuk kemi arritur ku duhet të jemi: barazi në çdo fushë të mundshme. E dyta, gjërat që i kemi fituar, mendoj në çështjen e abortit në SHBA, janë proces i vazhdueshëm, i cili ka edhe zmbrapsje... Duhet ta mbrojmë atë që e kemi arritur më herët. Nuk mund të rrimë rehat dhe të mendojmë se çka është bërë - është bërë".

Përkthyer për QKSGJ

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Ky botim u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID.
Përmbajtja është përgjegjësi e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.
Qendra Kosovare për Studime Gjinore përkrahet nga Programi Angazhimi për Barazi – E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID dhe zbatuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC.

CyanMagentaYellowBlack